ACA
ALBANIAN CHAMBER OF ARBITRATION

KQZ
U PROTOKOLLUA
Nr. 5725 Prot.
Datë,më 28.07.2025

**Tiranë më 28.07.2025**

# ANKIM

**ANKUES:** **Andia Ulliri** e bija e Sulejman-it e lindur në datë **01.02.1999** dhe e identifikuar me NID: J95201008L kandidate e subjektit zgjedhor Partia Demokratike - Aleanca për Shqipërinë Madhështore në Qarkun Durrës e përfgaqësuar nga Av.Indrit Sefa me Nr.Liç 5460 dhe me NUIS: M21730026T anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe me adresë komunikimi në email: indrit.sefa@gmail.com dhe cel: 0694060752

**OBJEKTI:** Ndryshimin e vendimit të datës 28.07.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve *"PËR CAKTIMIN E KANDIDATEVE FITUES TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR KOALICIONI "PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE", NË ZONEN ZGJEDHORE QARKU DURRËS, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 M A J 2025"*.

**BAZA LIGJORE:** NENET 21, 29, 63, 65,163 DHE 164 TË KODIT ZGJEDHOR;

**DREJTUAR:** **KOMISIONIT TË ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE**

Të nderuar

Në mbledhjen e datës 28 korrik 2025, u mor në shqyrtim projekt vendimi "PËR CAKTIMIN E KANDIDATEVE FITUES TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR KOALICIONI "PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE", NË ZONEN ZGJEDHORE QARKU DURRËS, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 M A J 2025". Në këtë mbledhje ankuesja Andia Ulliri e cila u legjhitimuar rregullisht nga ana e KSHZ parashtroi argumentat ligjorë në lidhje me interpretimin e gabuar të neneve 4, 64,163 dhe 164 të Kodit Zgjedhor nga ana e administratës dhe Komisionerit. Këto argumenta nuk u morën parasysh nga Komisioneri i cili në përfundim vendosi miratimin e projekt vendimit sipas draftit të paraqitur.

Në pjesën arsytuese të këtij vendimit Komisioneri arsyeton se: ***Në mbeshtetje të nenit 19, pikat ,1 shkronja i, dhe 2, nenit 162 dhe nenit 163, te ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërise"', të ndryshuar,***

*Shpalljen e kandidatëve fitues për deputetë në listat shumemërore të miratuara nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, të subjektit zgjedhor Koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca per Shqipërine Madhështore" per Qarkun Durrës, si me poshte:si vijon:*

***1. Oerd Bylykbashi***
***2. Artan Luku***
***3. Manjola Luku***
***4. Gent Strazimiri***
***5. Igli Cara***
***6. Arian Ndoja***

Nga analiza e vendimit rezulton se nga ana e Komisionerit është bërë intepretimi i gabuar i dispozitave të Kodit Zgjedhor duke mos zbatuar parimet themelore të këtij ligji dhe duke cënuar rëndë dhe parimet e vendosura në disa palë zgjedhje për respektimin e kuotave gjinore si një parim kushtetues dhe ligjor i cili përcaktohet qartë në këtë kod.

Në mënyrë të pashpjegueshme nga ana KSHZ është anashkaluar në mënyrë të hapur përcaktimi ligjor i referuar në Kushtetutë dhe i sanksionuar në Kodin Zgjedhor ku dhe dispozitat e tij përcaktohet qartë që 1 në 3 deputetë do të duhet ti përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar. Në nenin 64 të Kushtetutës referohet se:

Neni 64
**(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, nr. 115/2020, datë 30.7.2020)**

1. *Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar.*
2. *Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar.*
3. *Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.*

Ndërsa kushtetuta kërkon domosdoshmërinë e përfaqësimit gjinor, kjo e fundit ja delegon këtë detyrë Kodit Zgjedhor i cili në nenin 67 të tij vendos dhe qartëson faktin që kemi të bëjmë me NJË LISTË unikale e cila përbëhet nga dy pjesë dhe më konkretisht neni 67 i referon këto rrethana.

Neni 67
Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive politike
*1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ për çdo zonë zgjedhore, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, listën që përbëhet nga:*
*a) lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe*
*b) lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.*

Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin një në çdo tre emra të kandidatëve të listës shumemërore me renditje të fiksuar i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës shumemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar.

Siç jeni në dijeni Kodi Zgjedhor i RSH është ndryshuar me anë të Ligjit Nr. 81/2024 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008, "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR. Këto ndryshime janë atakuar në Gjykatën Kushtetuese nga disa subjekte dhe kjo gjykatë me anë të Vendimit me Nr.85 datë 24.12.2024 ka

rrëzuar kërkesën por në këtë vendim janë dhënë disa referenca shumë të qarta për ndarjen e mandateve dhe për respektimin e kuotave gjinore si dhe të gjinisë më pak të përfaqësuar.

Në seancë plenare një grup deputetësh propozuan një amendament i cili zgjidhte problematikën që shkaktonte projekt ligji i propozuar për përfaqësimin e kuotave gjinore. Të gjithë dokumentat janë lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit të parlament.al dhe të cilat janë vënë në dispozicion KSHZ si dhe po jua vendos në dispozicion dhe KAS gjithashtu. Ky amendament është votuar dhe pranuar ashtu siç është propozuar dhe më konkretisht:

> VOTIM AMENDAMENTI I NJE GRUPI DEPUTETESH
> "Per nje shtese ne nenin 8, p'ika 2" . Ne nenin 8, pika 2 shtohet nje paragraf ("Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar")
>
> PERMBLEDHJA E REZULTATIT TE VOTIMIT
> Te pranishem: 138
> Pro: 103
> Kunder: 1
> Abstenim: 0
> Kane marre pjese ne votim: 104
> Te pranishem qe nuk kane votuar: 34

Siç është detyrimi ligjor çdo amendament që parashtrohet do të duhet të ketë dhe relacionin shpjegues dhe ky amendament nuk bën ndryshim ndaj dhe ky grup deputetesh kanë shpjeguar në relacionin bashkëlidhur këtij amendamenti se:

III. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në Kodin Zgjedhor i cili është aktualisht në fuqi, në Nenin 67 parashikohet një përfaqësim 1 në çdo 3 emra, në listat e kandidatëve të paraqitura nga subjektet zgjedhore. Projekligji "Për disa Shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, parashikon:

*"Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin një çdo tre emra të kandidatëve të listës së fiksuar i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës shumëemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar."*

*Duke qenë se me projektligjin e paraqitur, mënyra e zgjedhjes së kandidatëve dhe e shpërndarjes së mandateve të subjekteve zgjedhore, ka ndryshuar, në një listë të hapur në 2/3 dhe të mbyllur në 1/3 të përbërjes së saj, ky parashikim nuk garanton që mandatet e fituara përmes listës së hapur të përkthehen në përfaqësim real në Kuvend. Pra ky parashikim rrezikon një regres në përfaqësimin e grave dhe vajzave në Kuvendin e Shqipërisë. Për këtë arsye, bazuar në modelet e vendeve të ndryshme të botës, ndër të cilat edhe Kosova, propozohet që të rishikohet ky nen duke shtuar një mekanizëm i cili nuk garanton vetëm pjesëmarrjen në listat e kandidatëve, por edhe në Kuvend.*

*Neni 8, Pika 2 e projektligjit shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:*

*"Në rastet kur nga rirenditja nuk rezulton që duke filluar nga kreu i listës një në tre emra të saj t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar, atëherë kandidatja e tretë në këtë listë dhe në vijim një në çdo tre emra të saj i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar sipas numrit të votave që këto të fundit kanë marrë. Mbi bazën e këtij kriteri hartohet lista përfundimtare që i nënshtrohet votimit parapëlqyes e rirenditur, e cila përdoret për zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi."*

Siç referuam më sipër ky amendament është pranuar ashtu siç është propozuar që do të thotë që 1 në 3 emra që shpallen fitues do të duhet të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar dhe këtë llogjik e ka pranuar dhe vetë Kuvendi në mbrojtjen e kryer nga ana e tij në GJK duke e referuar që kemi të bëjmë vetem me një listë e përbërë nga dy pjesë dhe ky është dhe qëndrimi i GJK në arsyetimin e saj në vendimin me Nr.85 datë 24.12.2024.

Është totalisht e pashpjegueshme sesi nga ana KSHZ është intepretuar ligji thjeshtë me intutitën dhe pa u bazuar në asnjë dispozitë ligjore apo në ndonjë vendim të Komisionit Rregullator. Dispozita ligjore si dhe qëndrimet e institucioneve që kanë miratuar ligjin dhe ata që e kanë detyrim ligjor ta intepretojnë atë vlerësojnë që kemi të bëjmë vetëm me një listë unikale e cila përbëhet nga 2 pjesë ajo me rënditje të fiksuar dhe nga pjesa që i nënshtrohet votimit parapëlqyes. Në mënyrë të pashpjegueshme nga ana e KSHZ megjithëse kishte 2 muaj kohë që nga kërkesa fillestare e ankueses Andia Ulliri dhe përsëri nuk ka denjuar as që të pyeste njëher të vetme Kuvendin e RSH apo GJK në lidhje me intepretimin themelor nëse kemi të bëjmë me 1 listë të deputetëve apo me 2 lista. Qartësisht KSHZ në seancën publike ndërroj disa variante ku në pyetjen e drejtëpërdrejtë deklarojë që për KSHZ ekzistojnë 2 lista të deputetëve ndërsa gjatë vazhdimit të seancës deklarojë që është vetëm 1 listë.

Në parashtrimet e Kuvendit të RSH të cilat janë depozituar në GJK në datën 08.11.2024 të cilat ju vendoisen në dispozicion dhe KSHZ në paragrafin 66 dhe 67 referohet qartësisht që qëllimi i Kuvendit të RSH-së në miratimin e ligjit ka qënë dhe respektimi i përfaqësimit gjinor ku 1 në 3 fitues do të duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Më konkretisht po ju referoj dhe qëndrimin e Kuvendit si më poshtë dhe rastësisht ka marrë dhe rastin e Qarkut Durrës dhe më konkretisht ata shprehen:

> *65. Lista e kandidateve që nje subjekt zgiedhor (p.sh. parti politike) paraqet në një zonë zgjedhore (qark) sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor plotëson për pasoje kërkesat e Kushtetutes. P.sh. Qarku i Durrësit ka gjithsej 14 mandate për deputete.*
> *Sipas Kodit Zgjedhor ne fuqi, një subjekt zgjedhor (p.sh. parti politike) ka detyrimin të paraqesë një listë kandidatësh për deputete për kete qark, e cila perbëhet nga lista me renditje të fiksuar 14 / 3 = 4.66, pra 5 kandidate per deputete dhe një listë prej 14 kandidatësh per deputete qe i nënshtrohen votimit parapëlqyes.*
>
> *66. Në total, ka një listë të kandidatëve për deputetë që subjekti zgjedhor parti politike paraqet në Qarkun e Durrësit për votim dhe është 19 deputetë dhe për të cilën me shumë se 2/3 e saj i nënshtrohet votimit parapëlqyes në nivelin e zonës zgjedhore. Njëkohësisht kjo zgjedhje përmban edhe garancinë që në momentin e kandidimit, në momentin e zgjedhjes dhe pastaj në momentin e krijimit të vakancave të sigurohet përfaqësimi i gjinisë më pak të përfaqësuar.*

*67.Për zbatimin e përcaktimeve të një norme kushtetuese mund të ketë më shumë se një mënyrë dhe i tillë është rasti i nenit 64, pika 3, të Kushtetutës kur parashikohet shtrirja e shkallës së votimit parapëlqyes kur në tekstin e saj përdoret shprehja "jo më pak se". Në ushtrimin e diskrecionit legjislativ të Kuvendit së fundmi është bërë një rregullim i ndryshëm ligjor në Kodin Zgjedhor për sa i takon listës së kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes dhe tashmë pa mekanizmin e herësit. Është e drejtë kushtetuese e Kuvendit si pushtet legjislativ në vend të eksplorojë, të hartojë dhe të miratojë zgjidhje për formulime ligjore që mbështeten nga një shumicë e cilësuar e anëtarëve të tij, por në çdo rast duke respektuar parimet kushtetuese.*

Në këtë frymë dhe Gjykata Kushtetuese në Vendimin Nr.85 datë 24.12.2024 mbahet përsëri i njëjti qëndrim që kemi të bëjmë vetëm me NJË LISTË e cila përbëhet në dy pjesë dhe më në paragrafin 71 të këtij vendimi referohet se:

*71. Gjykata vëren se në kuptim të delegimit të nenit 64 të Kushtetutës, ligjvënësi ka parashikuar në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor detyrimin e subjekteve zgjedhore për të depozituar në KQZ për çdo zonë zgjedhore listën shumemërore. Ligjvënësi në titullin e tij, por edhe në përmbajtjen e paragrafit të parë të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, ka përdorur shprehjen "lista", duke nënkuptuar se bëhet fjalë për një listë të vetme, e cila përbëhet në vetvete nga dy komponentë, pjesa e listës me renditje të fiksuar të kandidatëve dhe pjesa tjetër me kandidatët që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Përdorimi i lidhëzës "dhe" nënkupton se partitë politike si subjekte zgjedhore kanë detyrimin të përmbushin kërkesat që disiplinojnë procesin zgjedhor, ndër të tjera, atë për të paraqitur listën shumemërore me dy komponentë (atë me renditje të fiksuar dhe atë që i nënshtrohet votimit parapëlqyes) që do t'i nënshtrohet procesit të votimit.*

Siç shihet të gjithë institucionet i referohen një liste të vetme dhe në asnjë rast nuk kem i të bëjmë me dy lista pasi nuk ka në asnjë rast një terminologji të till dhe intepretimi juaj në këtë frym cënon rënd Kodin Zgjedhor dhe Kushtetutën e RSH ku me veprimet tuaja të cilat nuk janë ende zyrtare por përbëjnë një indicje e vendimeve tuaja të ardhëshme të cilat siç mund të hamendësohen do të jenë në shkelje të ligjit.

Në nenin 4 të Kodit Zgjedhor përcaktohet qartësisht se është detyra juaj që të ndërrmerrni të gjithë hapat ligjor të nevojshëm për të respektuar kuotat gjinore jo vetëm në hartimin e listave por dhe përcaktimin e rregullave që të bëjnë të mundur përzgjedhjen e tyre. Më konkretisht po i referohemni dispozitës:

Neni 4
Ligji zgjedhor dhe barazia gjinore
( Ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020)
*1. Ky ligj garanton respektimin e parimit të barazisë gjinore, sipas përcaktimeve që i jep këtij parimi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike e gjinisë së nënpërfaqësuar përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik.* ***Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk mund të zbatohet ose interpretohet në kundërshtim ose në shkelje të këtij parimi.***

*2. Detyrimi për respektimin e parimit të barazisë gjinore u përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë mbi tagrat që subjektet zgjedhore kanë sipas këtij ligji, të kërkojë nga subjektet zgjedhore pushimin e cenimit të këtij parimi dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij.*
*3. Ligji zgjedhor nxit barazinë gjinore për organet e zgjedhura dhe administratën zgjedhore përmes:*

- ***a) vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të njësive bazë të qeverisjes vendore;***
- *b) vendosjes së kuotave gjinore për gjininë e nënpërfaqësuar në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së të gjitha niveleve të administratës zgjedhore;*
- *c) marrjes së masave në reduktimin dhe eliminimin e votimit për të tretët, votimit familjar, ruajtjen dhe garantimin e fshehtësisë së votimit;*
- *ç) hartimit dhe publikimit të statistikave operative për pjesëmarrjen e gjinisë së nënpërfaqësuar në ditën e zgjedhjeve, me qëllim sensibilizimin dhe marrjen e masave të duhura për të nxitur më tej këtë pjesëmarrje.*

Në nenin 163 dhe 64 të Kodit Zgjedhor përcaktohet qartësisht që vendimarrja juaj për shpërndarjen e mandateve do të duhet të respektojë përcaktimet e këtyre dispozitave ligjore dhe më konkretisht në këto dispozita referohet se:

Neni 163
Shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues të listës
*(Shfuqizuar pika 6 dhe ndryshuar pika 7 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020; ndryshuar me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020; shfuqizuar pika 3 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 30.6.2021;ndryshuar me ligjin nr. 81/2024, datë 26.7.2024)*

1. *Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt zgjedhor.*
2. *Kandidatët e listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes rirenditen në bazë të numrit më të lartë të votave parapëlqyese për secilin kandidat. Kur numri i votave është i barabartë, renditja përcaktohet me short. Rirenditja sipas kësaj pike përdoret në zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi. Në rastet kur nga rirenditja nuk rezulton që duke filluar nga kreu i kësaj liste, një në çdo tre emra i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, atëherë kandidati i tretë në këtë listë dhe në vijim një në çdo tre emra të saj i përket gjinisë më pak të përfaqësuar sipas numrit të votave që këto të fundit kanë marrë. Mbi bazën e këtij kriteri hartohet lista përfundimtare që i nënshtrohet votimit parapëlqyes e renditur, e cila përdoret për zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi.*
3. *Mandatet për kandidatët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidatëve në të dhe, në rast shterimi të saj, vijohet me kandidatët fitues*

*të rirenditur të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes sipas pikës 2 të këtij neni.*

4. *Përllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi miratohet për çdo zonë zgjedhore më vete. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS.*

Neni 164

Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës

*(Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.7.2012; shtuar togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 31/2015, datë 2.4.2015; ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020; shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020)*

1. *Mandati i deputetit, i fituar sipas neneve 162 dhe 163 të këtij ligji, ndërpritet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës. Nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të mandatit marrëveshjet apo deklaratat paraprake individuale apo kolektive për heqje dorë nga mandati. Në rastin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës.*
2. *Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar. Në këtë rast plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listë i gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk zbatohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.*
3. *KQZ-ja merr vendim për plotësimin e vakancës në Kuvend. Vendimi i njoftohet kandidatit dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në Kuvend brenda 30 ditëve nga njoftimi, pa shkaqe të përligjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës, sipas procedurës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni. E njëjta procedurë vazhdon deri në shterimin e listës së kandidatëve të së njëjtës parti politike.*
4. *KQZ-ja merr vendim për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë. Vendimi i njoftohet kandidatit. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në këshill brenda 30 ditëve nga njoftimi, pa shkaqe të përligjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës, sipas procedurës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni.*
5. *Shfuqizuar.*

Siç dhe shihet qartë nga ana e legjislatorit Kuvendit të RSH dhe GJK kuptohet qartë që kemi të bëjme vetëm më një listë dhe si e tillë nga ana juaj është detyrimi ligjor që të zbatohet përcaktimi kushtetuese për përfaqësimin gjinor si dhe zbatimin e Kodit Zgjedhor i cili e detyron komisionerin që 1 në 3 emra të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar, do të thotë që në listën e subjektit zgjedhor Partia Demokratike - Aleanca për Shqipërinë Madhështore në Qarkun e Durrësit do të duhet që nga ana juaj do të duhet që ky mandat do të duhet të merret nga më e votuara nga kandidatet e gjinisë më pak të përfaqësuar. Intepretimi që KSHZ i bërë këtyre dispozitave pasqyron qartë një regres në përfaqësimin gjinor fakt që bie ndesh dhe me frymën

e Kodit Zgjedhor dhe me atë të amendamentit të paraqitur nga ana e deputeteve në seancën plenare të datës 25.07.2024.

Për sa referuam më sipër do të kërkojmë nga ana KAS që të vlerësojë drejtë pretendimet e ngritura nga an jonë në këtë ankim dhe të administrojë të gjithë provat e referuara në këtë ankim. Të gjitha këto shkresa janë akte publike që gjenden lehtësisht në në institucionet publike dhe si të tilla një kopje të tyre i është dërguar dhe KSHZ në kërkesën e depozituar në datën 27.05.2025 për të cilën nuk morrëm kurrë përgjigje në kohën e duhur.

1. Bazuar në sa parashtruar dhe analizuar më lartë kërkojmë:

    - Ndryshimin e vendimit të datës 28.07.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "*PËR CAKTIMIN E KANDIDATEVE FITUES TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR KOALICIONI "PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE", NË ZONEN ZGJEDHORE QARKU DURRËS, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 M A J 2025*", duke përcaktuar si fituese kandidaten **ANDIA SULEJMAN ULLIRI.**

**ANKUESE**
Andia Ulliri
Përfaqësuar nga:
**Av.Indrit SEFA**

Av. Indrit Sefa

Mob: +355 69 406 0752
Email: info@albanianarbitration.com
Web: www.albanianarbitration.com

Address: Tirane, Rr. Kavajes,
Kompleksi Square 21,
Hyrja 2, Kt. 4, Ap. 11

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**

# LIGJ

**Nr. 81/2024**

**"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008, "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 24 riformulohet si më poshtë:

"Neni 24

**Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. KQZ-ja drejton, mbikëqyr dhe është përgjegjëse për procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave, që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin.
2. Të drejtën e votës nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë e ka çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën e zgjedhjeve.
3. Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij Kodi. Çdo organ shtetëror shqiptar dhe çdo ent tjetër shtetëror ose privat që përfshihet në këtë proces janë të detyruar të zbatojnë rregullat e përcaktuara në këtë Kod dhe në aktet nënligjore që miraton KQZ-ja në zbatim të tij.
4. Rregullatori duhet të marrë vendim me të paktën 4 vota "pro" për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit. Në zgjedhjet vijuese, votimi nga jashtë vendit bëhet automatikisht pjesë përbërëse e procedurave të votimit.
5. Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të Rregullatorit, me propozimin e Komisionerit, brenda 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

Neni 2

Neni 25 riformulohet si më poshtë:

"Neni 25

**Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptarë që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë vendit dhe që janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në territorin e zonës zgjedhore përkatëse.

3. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo palë zgjedhje për Kuvendin sipas kritereve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë Kod dhe aktet normative të KQZ-së të nxjerra në përputhje me të, dhe janë të vlefshme vetëm për zgjedhjet për të cilat ato janë hartuar. Në çdo rast, KQZ-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ruajnë bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo palë zgjedhje.

4. Regjistrimi i zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë realizohet nga KQZ-ja. Procesi i hartimit të listës së këtyre zgjedhësve fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 60 ditë para kësaj date. Hapja e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë njoftohet publikisht nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet.

5. Zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas hapjes së procesit të regjistrimit nga KQZ-ja aplikon në mënyrë individuale për regjistrim në listën e këtyre zgjedhësve. KQZ-ja krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zgjedhësi për regjistrim në listë paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përcaktohet me vendim të Rregullatorit.

6. Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbështetet në një nga dokumentet që paraqet në KQZ sipas pikës 5 të këtij neni. Të dhënat e identitetit të shtetasit kërkohen të verifikohen nga KQZ-ja në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe, nëse ato janë të njëjta, bëhet nga DPGJC-ja regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile i adresës së shtetasit që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një rubrikë të veçantë.

7. Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, 63 ditë përpara datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim që zgjedhësit brenda 48 orësh nga publikimi i saj të mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive të regjistrimit të tyre. Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, 60 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e zgjedhësve pas përfundimit të procesit nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në këtë pikë, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 8 të këtij neni.

8. Kur zgjedhësi që ka paraqitur kërkesë për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë, ose regjistrimi i tij ka pasaktësi, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore. Gjykata e shqyrton dhe vendos në lidhje me kërkesën, sipas kësaj pike, brenda

24 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës, por jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve. Emri dhe të dhënat e tjera të zgjedhësit, që i shtohet listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i bashkëngjitet vendimi i gjykatës.

9. Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij neni, çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit që shpallet sipas nenit 56 të këtij Kodi.

10. Në rastet e zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme sipas nenit 9, pika 5, pika 6, pika 7 ose pika 8 të këtij Kodi, Rregullatori përcakton me akt normativ afatet kohore për listën e zgjedhësve dhe votimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas të njëjtave kritere dhe procedura që zbatohen për zgjedhjet e zakonshme.

11. Auditët teknicienë, të miratuar sipas nenit 61 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kryejnë verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të auditëve teknicienë dhe bashkëpunim i tyre me KQZ dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile përcaktohet me vendim të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet.

12. Rregullatori, me propozimin e Komisionerit, miraton aktet e nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe afatet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.

13. Komisioneri dhe Ministri përgjegjës për gjendjen civile, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë me akt të përbashkët mënyrën e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për çregjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në listën e zgjedhësve brenda vendit."

Neni 3

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 25/1

**Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe rezultati zgjedhor**

1. Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë quhet i çelur nga dita që KQZ-ja nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit të votimit dhe dokumentacionit udhëzues në adresë të zgjedhësve nga jashtë vendit. Votimi nga jashtë vendit mbyllet në ditën e votimit, në orën e caktuar nga ky Kod për mbylljen e votimit në qendrat e votimit. Me mbylljen e votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe përfshijë në numërim asnjë fletë votimi të mbërritur pas këtij orari, me përjashtim të zarfeve me fletë votimi të cilat kanë vulën e hyrjes ose çdo shënim tjetër për këtë gjë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në orën e mbylljes së votimit brenda vendit, sipas këtij Kodi.

2. KQZ-ja dërgon nëpërmjet shërbimit postar fletët e votimit dhe çdo material tjetër zgjedhor dhe informativ në adresën e deklaruar të vendbanimit të zgjedhësit sipas listës së zgjedhësve për votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Fleta e votimit është e njëjtë, por me një element të veçantë dallues me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Fletët e votimit të plotësuara dhe të sekretuara dërgohen në adresën zyrtare të KQZ-së nëpërmjet shërbimit postar me shpenzimet e zgjedhësit. KQZ-ja fillimisht bën përpjekje të përzgjedhë ofrues ndërkombëtarë të shërbimit postar me jashtë vendit, që kanë eksperiencë dhe reputacion të mirë në shërbimin e postës së shpejtë, dhe zgjedhja e tij realizohet nëpërmjet procedurave më afatshkurtra që mundëson legjislacioni për prokurimin publik.

4. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të administruara numërohen në ambientet e KQZ-së. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në momentin e mbërritjes në KQZ regjistrohen në një regjistër

të posaçëm dhe ndahen sipas zonës zgjedhore të vendbanimit më të fundit të zgjedhësit para largimit nga Shqipëria. Procesi i numërimit të tyre fillon në të njëjtin moment që fillon numërimi i kutisë së parë me fletë votimi të zonës zgjedhore përkatëse, si dhe vlerësimi i tyre kryhet nga administrata e KQZ-së dhe tabelohen në tabelën e rezultateve të zonës zgjedhore përkatëse. Rregullatori, me propozimin e Komisionerit, përcakton me akt nënligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij dhe çdo aspekt tjetër për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimin, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor sipas këtij neni."

Neni 4

Në nenin 45 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, krahas përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve sipas pikës 1 te këtij neni, dërgon në KQZ edhe fotografinë e çdo zgjedhësi të depozituar gjatë aplikimit për letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike. Institucioni përgjegjës për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike, me kërkesë të DPGJC-së, i dërgon foton e fundit të përdorur për prodhimin e dokumenteve biometrike të secilit zgjedhës."

Neni 5

Neni 67 riformulohet si më poshtë:

"Neni 67

**Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive politike**

1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ për çdo zonë zgjedhore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, listën që përbëhet nga:

a) lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe

b) lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.

2. Emrat në listën shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati. Numri i përgjithshëm i kandidatëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjesëtuar për tre. Kur nga ky pjesëtim nuk rezulton numër i plotë mandatesh, atëherë në rast se presja dhjetore si pasojë e pjesëtimit është e barabartë ose më e madhe se 0,5 lista përmbyllet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e pjesëtimit rezulton presja dhjetore më e vogël se 0,5, lista shumemërore me renditje të fiksuar e kandidatëve mbyllet me numrin e plotë pararendës.

3. Lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhësit është e barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. Renditja e kandidatëve bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre.

4. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore, nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish.

5. Kandidati për deputet, i regjistruar në listën shumemërore me renditje të fiksuar të partisë politike apo koalicionit, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe në listën shumemërore të kandidatëve për deputetë që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.

6. Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin një në çdo tre emra të kandidatëve të listës shumemërore me renditje të fiksuar i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës shumemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar.

7. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kandidati për kryetar të bashkisë dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve. Kandidati për kryetar të bashkisë dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë depozitohet në KQZ në rastet kur territori i njësisë së qeverisjes vendore nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme.

8. Kandidati për kryetar bashkie apo për këshillin e bashkisë nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish.

9. Në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje të kandidatëve të subjekteve zgjedhore duhet t'i përkasë së njëjtës gjini.

10. Në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumemërore KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të këtij Kodi."

Neni 6

Në nenin 124 në fund të pikës 1 shtohen këto fjali: "Kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit sipas nenit 98 të këtij Kodi mund të bëhet ankim në KAS brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit. KAS shqyrton dhe vendos për ankimin e paraqitur brenda 48 orëve nga depozitimi i tij."

Neni 7

Në nenin 152 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje: "Kundër vendimit të KAS-it për përmbajtjen e fletës së votimit sipas nenit 124 të këtij Kodi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit. Kolegji Zgjedhor shqyrton dhe vendos për kërkesëpadinë e paraqitur brenda 3 ditëve nga depozitimi i saj."

Neni 8

Neni 162, pika 1, fjalia e dytë riformulohet si më poshtë:

"Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike ose koalicionet që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi."

Neni 9

Neni 163 riformulohet si më poshtë:

"Neni 163

**Shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues të listës**

1. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt zgjedhor.

2. Kandidatët e listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes rirenditen në bazë të numrit më të lartë të votave parapëlqyese për secilin kandidat. Kur numri i votave është i barabartë, renditja përcaktohet me short. Rirenditja sipas kësaj pike përdoret në zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi. Në rastet kur nga rirenditja nuk rezulton që duke filluar nga kreu i kësaj liste, një në çdo tre emra i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, atëherë kandidati i tretë në këtë listë dhe në vijim një në çdo tre emra të saj i përket gjinisë më pak të përfaqësuar sipas numrit të votave që këto të fundit kanë marrë. Mbi bazën e këtij kriteri hartohet lista përfundimtare që i nënshtrohet votimit parapëlqyes e renditur, e cila përdoret për zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi.

3. Mandatet për kandidatët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidatëve në të dhe, në rast shterimi të saj, vijohet me kandidatët fitues të rirenditur të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Përllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi miratohet për çdo zonë zgjedhore më vete. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS."

Neni 10

Neni 183 shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar në datën 26.7.2024

Pëmbledhje e rezultatit të votimit 26-Jul-24 21:51:49

Mënyra e votimit: I hapur

# Votim në parim projektligji

"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"

## PËRMBLEDHJA E REZULTATIT TË VOTIMIT

| | |
|---|---|
| Të pranishëm: | 138 |
| Pro: | 105 |
| Kundër: | 8 |
| Abstenim: | 0 |
| Kanë marrë pjesë ne votim: | 113 |
| Të pranishëm që nuk kanë votuar: | 25 |

REZULTATI I DETAJUAR I VOTIMIT

| ID | Deputeti | Grupi Parlamentar | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 001 | Mirela Pitushi | | Pro |
| 002 | Eduard Shalsi | | Pro |
| 003 | Bledar Çuçi | | Pro |
| 004 | Klodiana Spahiu | | Pro |
| 005 | Paulin Sterkaj | | Pro |
| 006 | Luan Duzha | | Pro |
| 007 | Etilda Gjonaj | | Pro |
| 008 | Edi Rama | | Nuk votoi |
| 009 | Erion Braçe | | Pro |
| 010 | Elisa Spiropali | | Pro |
| 011 | Olta Xhaçka | | Pro |
| 012 | Anila Denaj | | Pro |
| 013 | Agron Çela | | Pro |
| 014 | Belinda Balluku | | Pro |
| 015 | Ogerta Manastirliu | | Nuk votoi |
| 016 | Blendi Klosi | | Pro |
| 017 | Qani Xhafa | | Pro |
| 018 | Etjen Xhafaj | | Pro |
| 019 | Petrit Doda | | Nuk votoi |
| 020 | Pandeli Majko | | Pro |
| 021 | Erisa Xhixho | | Nuk votoi |
| 022 | Ferdinant Xhaferaj | | Pro |
| 023 | Agron Duka | | Kundër |
| 024 | Sali Berisha | | Jo i pranishëm |
| 025 | Oerd Bylykbashi | | Pro |
| 026 | Kastriot Piroli | | Pro |
| 027 | Lindita Buxheli | | Pro |
| 028 | Hatixhe Konomi | | Pro |
| 029 | Jurgis Çyrbja | | Pro |
| 030 | Petrit Vasili | | Pro |
| 031 | Tritan Shehu | | Pro |
| 032 | Ramadan Likaj | | Pro |
| 033 | Gazment Bardhi | | Pro |
| 034 | Bledjon Nallbati | | Pro |
| 035 | Agron Gjekmarkaj | | Pro |
| 036 | Meri Markiçi | | Pro |
| 037 | Elda Hoti | | Pro |
| 038 | Ulsi Manja | | Pro |
| 039 | Lulzim Basha | | Kundër |
| 040 | Fatmir Xhafaj | | Pro |
| 041 | Klotilda Bushka | | Pro |
| 042 | Xhelal Mziu | | Pro |
| 043 | Vullnet Sinaj | | Pro |
| 044 | Asllan Dogjani | | Nuk votoi |
| 045 | Sorina Koti | | Pro |
| 046 | Saimir Hasalla | | Pro |

REZULTATI I DETAJUAR I VOTIMIT

| ID | Deputeti | Grupi Parlamentar | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 047 | Merita Bakiu | | Kundër |
| 048 | Dasantila Tahiraj | | Pro |
| 049 | Edmond Spaho | | Pro |
| 050 | Emilja Koliqi | | Nuk votoi |
| 051 | Shkëlqim Bullari | | Pro |
| 052 | Aurora Mara | | Pro |
| 053 | Eduard Ndreca | | Pro |
| 054 | Bujar Leskaj | | Nuk votoi |
| 055 | Lindita Metaliaj | | Pro |
| 056 | Evis Kushi | | Pro |
| 057 | Plarent Ndreca | | Pro |
| 058 | Antoneta Dhima | | Pro |
| 059 | Edona Bilali | | Pro |
| 060 | Blerina Gjylameti | | Pro |
| 061 | Agron Shehaj | | Nuk votoi |
| 062 | Petro Koçi | | Pro |
| 063 | Ludovik Hasani | | Pro |
| 064 | Pranvera Resulaj | | Pro |
| 065 | Mesila Doda | | Nuk votoi |
| 066 | Monika Kryemadhi | | Nuk votoi |
| 067 | Niko Kuri | | Pro |
| 068 | Nasip Naço | | Pro |
| 069 | Luljeta Bozo | | Pro |
| 070 | Alban Xhelili | | Pro |
| 071 | Nusret Avdulla | | Nuk votoi |
| 072 | Shpresa Marnoj | | Pro |
| 073 | Saimir Korreshi | | Pro |
| 074 | Toni Gogu | | Pro |
| 075 | Taulant Balla | | Pro |
| 076 | Ornaldo Rakipi | | Pro |
| 077 | Mimi Kodheli | | Pro |
| 078 | Vangjel Dule | | Nuk votoi |
| 079 | Tomor Alizoti | | Nuk votoi |
| 080 | Ina Zhupa | | Jo i pranishëm |
| 081 | Kreshnik Çollaku | | Nuk votoi |
| 082 | Gëzim Ademaj | | Nuk votoi |
| 083 | Gledis Çeliku | | Pro |
| 084 | Bardhyl Kollçaku | | Pro |
| 085 | Albana Vokshi | | Pro |
| 086 | Frrok Gjini | | Pro |
| 087 | Ervin Salianji | | Pro |
| 088 | Eralda Bano | | Nuk votoi |
| 089 | Seladin Jakupllari | | Kundër |
| 090 | Shpëtim Idrizi | | Nuk votoi |
| 091 | Ermonela Valikaj | | Pro |
| 092 | Laert Duraj | | Pro |

REZULTATI I DETAJUAR I VOTIMIT

| ID | Deputeti | Grupi Parlamentar | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 093 | Xhemal Qefalia | | Pro |
| 094 | Kasëm Mahmutaj | | Pro |
| 095 | Isuf Çelaj | | Pro |
| 096 | Lavdrim Krrashi | | Pro |
| 097 | Flamur Noka | | Pro |
| 098 | Anduel Tahiraj | | Pro |
| 099 | Andia Ulliri | | Nuk votoi |
| 100 | Flamur Hoxha | | Pro |
| 101 | Flutura Açka | | Nuk votoi |
| 102 | Ilir Metaj | | Pro |
| 103 | Jorida Tabaku | | Pro |
| 104 | Lefter Gështenja | | Pro |
| 105 | Arbi Agalliu | | Nuk votoi |
| 106 | Fatmir Mediu | | Kundër |
| 107 | Gertjan Deda | | Pro |
| 108 | Niko Peleshi | | Pro |
| 109 | Helidon Bushati | | Pro |
| 110 | Luan Baçi | | Pro |
| 111 | Tatiana Piro | | Pro |
| 112 | Klevis Xhoxhi | | Pro |
| 113 | Gerta Duraku | | Pro |
| 114 | Arkend Balla | | Pro |
| 115 | Ilda Dhori | | Nuk votoi |
| 116 | Ilir Topi | | Pro |
| 117 | Enslemvera Zake | | Pro |
| 118 | Zheni Gjergji | | Nuk votoi |
| 119 | Orjola Pampuri | | Nuk votoi |
| 120 | Teuta Ramaj | | Pro |
| 121 | Baftjar Zeqaj | | Pro |
| 122 | Enkelejd Alibeaj | | Kundër |
| 123 | Orjela Nebijaj | | Nuk votoi |
| 124 | Milva Ekonomi | | Pro |
| 125 | Greta Bardeli | | Pro |
| 126 | Ilir Ndraxhi | | Pro |
| 127 | Lindita Nikolla | | Pro |
| 128 | Ismet Beqiraj | | Pro |
| 129 | Fadil Nasufi | | Pro |
| 130 | Dashamir Shehi | | Kundër |
| 131 | Edi Paloka | | Nuk votoi |
| 132 | Dhurata Tyli | | Pro |
| 133 | Dashnor Sula | | Kundër |
| 134 | Bujar Çela | | Pro |
| 135 | Arben Pëllumbi | | Pro |
| 136 | Damian Gjiknuri | | Pro |
| 137 | Mirela Furxhi | | Pro |
| 138 | Florenc Spaho | | Pro |

REZULTATI I DETAJUAR I VOTIMIT

| ID | Deputeti | Grupi Parlamentar | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 139 | Ilirian Pendavinji | | Pro |
| 140 | Denis Deliu | | Pro |

Përnbledhje e rezultatit të votimit 26-Jul-24 22:01:07

Mënyra e votimit: I hapur

# Votim amendamenti i Z.Mediu,Z.Duka dhe Z.Dule

"Për një shtesë në nenin 4, pika 1, germa "a"
("Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar")

## PËRMBLEDHJA E REZULTATIT TË VOTIMIT

| | |
|---|---|
| Të pranishëm: | 138 |
| Pro: | 14 |
| Kundër: | 75 |
| Abstenim: | 0 |
| Kanë marrë pjesë ne votim: | 89 |
| Të pranishëm që nuk kanë votuar: | 49 |

REZULTATI I DETAJUAR I VOTIMIT

| ID | Deputeti | Grupi Parlamentar | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 001 | Mirela Pitushi | | Kundër |
| 002 | Eduard Shalsi | | Kundër |
| 003 | Bledar Çuçi | | Kundër |
| 004 | Klodiana Spahiu | | Kundër |
| 005 | Paulin Sterkaj | | Pro |
| 006 | Luan Duzha | | Kundër |
| 007 | Etilda Gjonaj | | Kundër |
| 008 | Edi Rama | | Nuk votoi |
| 009 | Erion Braçe | | Kundër |
| 010 | Elisa Spiropali | | Kundër |
| 011 | Olta Xhaçka | | Kundër |
| 012 | Anila Denaj | | Kundër |
| 013 | Agron Çela | | Kundër |
| 014 | Belinda Balluku | | Kundër |
| 015 | Ogerta Manastirliu | | Nuk votoi |
| 016 | Blendi Klosi | | Kundër |
| 017 | Qani Xhafa | | Pro |
| 018 | Etjen Xhafaj | | Kundër |
| 019 | Petrit Doda | | Nuk votoi |
| 020 | Pandeli Majko | | Kundër |
| 021 | Erisa Xhixho | | Nuk votoi |
| 022 | Ferdinant Xhaferaj | | Nuk votoi |
| 023 | Agron Duka | | Pro |
| 024 | Sali Berisha | | Jo i pranishëm |
| 025 | Oerd Bylykbashi | | Nuk votoi |
| 026 | Kastriot Piroli | | Nuk votoi |
| 027 | Lindita Buxheli | | Kundër |
| 028 | Hatixhe Konomi | | Kundër |
| 029 | Jurgis Çyrbja | | Kundër |
| 030 | Petrit Vasili | | Pro |
| 031 | Tritan Shehu | | Nuk votoi |
| 032 | Ramadan Likaj | | Nuk votoi |
| 033 | Gazment Bardhi | | Nuk votoi |
| 034 | Bledjon Nallbati | | Nuk votoi |
| 035 | Agron Gjekmarkaj | | Nuk votoi |
| 036 | Meri Markiçi | | Kundër |
| 037 | Elda Hoti | | Nuk votoi |
| 038 | Ulsi Manja | | Kundër |
| 039 | Lulzim Basha | | Pro |
| 040 | Fatmir Xhafaj | | Kundër |
| 041 | Klotilda Bushka | | Kundër |
| 042 | Xhelal Mziu | | Nuk votoi |
| 043 | Vullnet Sinaj | | Kundër |
| 044 | Asllan Dogjani | | Nuk votoi |
| 045 | Sorina Koti | | Nuk votoi |
| 046 | Saimir Hasalla | | Kundër |

REZULTATI I DETAJUAR I VOTIMIT

| ID | Deputeti | Grupi Parlamentar | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 047 | Merita Bakiu | | Pro |
| 048 | Dasantila Tahiraj | | Kundër |
| 049 | Edmond Spaho | | Nuk votoi |
| 050 | Emilja Koliqi | | Nuk votoi |
| 051 | Shkëlqim Bullari | | Kundër |
| 052 | Aurora Mara | | Kundër |
| 053 | Eduard Ndreca | | Kundër |
| 045 | Sorina Koti | | Pro |
| 046 | Saimir Hasalla | | Pro |

REZULTATI I DETAJUAR I VOTIMIT

| ID | Deputeti | Grupi Parlamentar | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 047 | Merita Bakiu | | Nuk votoi |
| 048 | Dasantila Tahiraj | | Pro |
| 049 | Edmond Spaho | | Pro |
| 050 | Emilja Koliqi | | Nuk votoi |
| 051 | Shkëlqim Bullari | | Pro |
| 052 | Aurora Mara | | Pro |
| 053 | Eduard Ndreca | | Pro |
| 054 | Bujar Leskaj | | Nuk votoi |
| 055 | Lindita Metaliaj | | Pro |
| 056 | Evis Kushi | | Pro |
| 057 | Plarent Ndreca | | Pro |
| 058 | Antoneta Dhima | | Pro |
| 059 | Edona Bilali | | Pro |
| 060 | Blerina Gjylameti | | Pro |
| 061 | Agron Shehaj | | Nuk votoi |
| 062 | Petro Koçi | | Pro |
| 063 | Ludovik Hasani | | Pro |
| 064 | Pranvera Resulaj | | Pro |
| 065 | Mesila Doda | | Nuk votoi |
| 066 | Monika Kryemadhi | | Pro |
| 067 | Niko Kuri | | Pro |
| 068 | Nasip Naço | | Pro |
| 069 | Luljeta Bozo | | Pro |
| 070 | Alban Xhelili | | Pro |
| 071 | Nusret Avdulla | | Nuk votoi |
| 072 | Shpresa Marnoj | | Pro |
| 073 | Saimir Korreshi | | Pro |
| 074 | Toni Gogu | | Pro |
| 075 | Taulant Balla | | Pro |
| 076 | Ornaldo Rakipi | | Pro |
| 077 | Mimi Kodheli | | Pro |
| 078 | Vangjel Dule | | Nuk votoi |
| 079 | Tomor Alizoti | | Nuk votoi |
| 080 | Ina Zhupa | | Jo i pranishëm |
| 081 | Kreshnik Çollaku | | Nuk votoi |
| 082 | Gëzim Ademaj | | Nuk votoi |
| 083 | Gledis Çeliku | | Pro |
| 084 | Bardhyl Kollçaku | | Pro |
| 085 | Albana Vokshi | | Pro |
| 086 | Frrok Gjini | | Pro |
| 087 | Ervin Salianji | | Pro |
| 088 | Eralda Bano | | Nuk votoi |
| 089 | Seladin Jakupllari | | Nuk votoi |
| 090 | Shpëtim Idrizi | | Nuk votoi |
| 091 | Ermonela Valikaj | | Pro |
| 092 | Laert Duraj | | Pro |

1. Kalimi i kërkesave për shqyrtim në seancë plenare publike.
2. Shqyrtimi në seancë plenare publike i kërkesës për pezullim e paraqitur nga Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.
3. Pranimin e kërkesës për shpejtimin e gjykimit, si dhe reduktimin e afateve për parashtrimin e qëndrimeve.

Kuvendi pasi u vu në dijeni për përfshirjen e tij si palë e interesuar në shqyrtimin e kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, parashtron si më poshtë vijon:

*

* *

## 1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1.Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në seancën plenare të datës 26.07.2024, ka miratuar ligjin nr. 81/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.8.2012 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr.132 datë 31.07.2024.

2.Ligjvënësi në miratimin e ligjit nr. 81/2024 ka pasur si synim në radhë të parë reflektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, zbatimi i të cilave përbën një detyrim për Ligjvënësin. Kjo del qartë nga përmbajtja e dispozitave të ligjit. Në këtë mënyrë Kuvendi kryen detyrimin e vet kushtetues, zbaton vendimet e Gjykatës Kushtetuese në raport me legjislacionin zgjedhor dhe në kuptimin më të gjerë mundëson një produkt legjislativ që ka mbështetjen e një shumicë të gjerë politike në Kuvend që përbën një parakusht të rëndësishëm juridik të situatës parazgjedhore në vend.

3.Në zbatim të këtyre vendimeve të Gjykatës Kushtetuese u paraqiten për shqyrtim dhe për miratim dy nismat e fundit të datës 8.07.2024 dhe 18.07.2024 për disa ndryshime në Kodin Zgjedhor. Nismat e tjera legjislative e shtrinin propozimin ligjor përtej çështjes së adresimit të vetëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

4.Amendamentet e propozuara bëjnë riformulimin e nenit 67 dhe të nenit 163 në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 28/2021. Në këtë rast Kuvendit i propozohet një ndryshim tërësor legjislativ për listën e kandidateve dhe votimin parapëlqyes sipas nenit 64 të Kushtetutës. Formulimi i propozuar, duke respektuar hapësirën e vlerësimit të Kuvendit dhe diskrecionin legjislativ të tij për të rregulluar fushën përkatëse, paraqet një rregullim të ndryshëm normativ nga ai që ka ekzistuar deri më sot, por që respekton normën kushtetuese.

5.Rezulton se Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar si dhe Organizata Shqipëria "Bëhet", i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën, për shfuqizimin i nenit 67 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me nenin 5 të ligjit 81/2024 si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Njëkohësisht në kërkesat e tyre kërkojnë edhe pezullimi i zbatimit të germës "a" dhe "b" të pikës 1 dhe fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar, me nenin 5 të ligjit nr.81/2024.

6.Referuar përmbajtjes së kërkesës kërkuesit pretendojnë: ,

a. Neni 5 i ligjit 81/2024, me të cilin është ndryshuar neni 67 i Kodit Zgjedhor, i) cënon parimin e shtetit të së drejtës,ii) të barazisë së votës, të drejtën për të zgjedhur,iii) parimin e hierarkisë së normave juridike, rezervën ligjore dhe barazinë para ligjit. Sipas kërkuesve ky nen në pikat 1 dhe 2 të tij, është në kundërshtim me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike, barazisë para ligjit, kufizimit disproporcional të të drejtave të shtetasve dhe me vetë frymën e vendimit nr. 28/21 të Gjykatës Kushtetuese. .Se lidhëza "dhe" e përdorur ndërmjet shkronjës a) dhe shkronjës b) të pikës 1 të nenit 67 krijon detyrimin për të paraqitur në zgjedhje dy lista kandidatësh (listën e fiksuar dhe listën e votës parapëlqyese) duke sjellë si pasojë edhe zbatimin e detyrueshëm të nenit 163 i cili shpërndan fillimisht mandatet për kandidatët e listës së fiksuar dhe më pas për kandidatët e listës parapëlqyese.

b. Zbatimi i kombinuar i neneve 67 dhe 163 përbën një kufizim disproporcional të së drejtës së votës, e për pasojë edhe të së drejtës për të zgjedhur; përbën cënim të parimit të sigurisë juridike, sepse e drejta e votës parapëlqyese ka qenë e shtrirë tek të gjithë kandidatët pa përjashtim në sistemin e mëparshëm zgjedhor; përbën pabarazi në ligj (diskriminim) mes kandidatëve të listës së fiksuar krahasuar me kandidatët e listës me votë parapëlqyese; si dhe pabarazi në zgjedhje (diskriminim) midis partive politike. Në mungesë të detyrimit për paraqitjen e domosdoshme të të dy listave (detyrim i krijuar nga prania e lidhëzës "dhe") partitë politike do të mund të konkurronin në zgjedhje sipas interesit të tyre ose në variantin me dy lista, ose në variantin vetëm me listën që i nënshtrohet votës parapëlqyese, listë e cila përfshin numrin e plotë të kandidatëve të kërkuar nga ligji dhe shpërndarja e mandateve të fituara të bëhet vetëm sipas kësaj liste.

c. Në pikën 2 të neni 67, rrumbullakosja e numrit të mandateve që nuk i nënshtrohet votimit parapëlqyes sjell cënim të dispozitës kushtetuese e cila përcakton qartësisht kufirin minimal prej 2/3 e listës që do të duhet t'i nënshtrohet votimit parapëlqyes. Si i tillë ky rregullim ligjor është antikushtetues, argumentojnë kërkuesit.

d. Ligji 81/2024 është ligj i miratuar në kundërshtim me procedurën kushtetuese dhe si i tillë duhet të shpallet antikushtetues pasi është shqyrtuar dhe miratuar në kundërshtim me ndalimin kushtetuese të parashikuar në nenin 83 pika 2 dhe 3 të Kushtetutës. Në argument të këtij pretendimi, kërkuesit parashtrojnë se propozimi i nismës ligjore nga ana e deputetit Oerd Bylykbashi "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin .r 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor", është depozituar më datë 18.7.2024 në Kuvendin e Shqipërisë dhe është shqyrtuar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në mbledhjen e datës 24.7.2024. Sipas kërkuesve ky projektligj është shqyrtuar në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit e cila përcakton në nenin 69, pika 3 të saj se shqyrtimi i projektligjeve nuk mund të fillojë pa kaluar të paktën dy javë nga data e paraqitjes së saj.

7. Në konkluzion, kërkuesit kanë kërkuar nga Gjykata Kushtetuese shpalljen e ligjit 81/2024 si një ligj antikushtetues për shkak të shkeljes së procedurës kushtetuese të kërkuar për miratimin e tij, e nëse kjo nuk pranohet, shpalljen antikushtetuese të lidhëzës "dhe" të përdorur ndërmjet shkronjave a) dhe b) të pikës 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, ndryshuar me ligjin 81/2024; shpalljen

antikushtetuese të fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, ndryshuar me ligjin 81/2024 si dhe marrjen e masës së pezullimit të zbatimit të ligjit deri në shqyrtimin e tij nga kjo Gjykatë.

8.Në lidhje me sa më lart, Kuvendi i Shqipërisë, në cilësinë e palës së interesuar në këtë proces, çmon e vlerëson se kërkimet e kërkuesve Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar si dhe Organizata Shqipëria "Bëhet", janë të pabazuara ndaj duhet të rrëzohen.

*

* *

## *II. NË LIDHJE ME LEGJITIMITETIN E KËRKUESVE*

9. **Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar dhe Organizata Shqipëria "Bëhet"**, në kërkesat e tyre ka ngritur disa pretendime që në vija të përgjithshme kanë të bëjnë me cënimin e parimit të shtetit të së drejtës. Në tërësi ngrihen pretendime për anën procedurale të miratimit të ndryshimeve në Ligjin nr.81/2024, si edhe pretendime për përmbajtjen e këtyre dispozitave.

10. Megjithatë në vlerësimin e këtyre pretendimeve duhet të kemi në konsideratë se kërkuesit, janë një organizim vullnetar, të themeluara në formën e partisë politike. Për këtë arsye këto subjekte bien në fushëveprimin e nenit 134, pika 1, gërma "gj" dhe pika 2 të Kushtetutës, të cilat përcaktojnë se:

> *1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:*
> ...
> *gj) partive politike;*
> ...
> *2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët ... "gj" ..., të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.*

11. Nga sa më sipër, qartazi kërkuesit nuk klasifikohet nga subjektet të cilat janë mbartës të interesit publik dhe që gëzojnë legjitimitet të pakushtëzuar në vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Kjo qasje është pranuar dhe nga vetë Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr.4, datë 23.2.2011, ndër të tjera është shprehur se:

> *49. Gjykata çmon se, përderisa nuk vëren cenim të të drejtave të njeriut në kuptimin kushtetues, të pretenduara nga kërkuesi, nuk mund të vijojë më tej me analizën e vlerësimit të pretendimeve për cenimin e hierarkisë së akteve normative dhe të kërkesave të nenit 81 të Kushtetutës, nga ligji objekt shqyrtimi. Gjykata vëren se këto pretendime do të merreshin në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuesi kishte një interes real të cenuar nga ligji i kundërshtuar. Për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, për nenet 81 dhe 116 të Kushtetutës.*

12. Siç mund të konstatohet nga pazazhet e mësipërme, qartazi kërkuesit nuk gëzojnë legjitimitet për të kundërshtuar më vehte procedurën e miratimit të Ligjit nr.81/2024.

*

* *

## III. NË LIDHJE ME THEMELIN E KËRKESËS.

### A. Në lidhje me pretendimin për shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit

13. Kërkuesit në parashtrimet drejtuar Gjykatës Kushtetuese pretendon Ligji 81/2024 është ligj i miratuar në kundërshtim me procedurën kushtetuese dhe si i tillë duhet të shpallet antikushtetues pasi është shqyrtuar dhe miratuar në kundërshtim me ndalimin kushtetuese të parashikuar në nenin 83 pika 2 dhe 3 të Kushtetutës. Në argument të këtij pretendimi, kërkuesit parashtrojnë se propozimi i nismës ligjore nga ana e deputetit Oerd Bylykbashi "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin .r 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor", është depozituar më datë 18.7.2024 në Kuvendin e Shqipërisë dhe është shqyrtuar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në mbledhjen e datës 24.7.2024. Sipas kërkuesve ky projektligj është shqyrtuar në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit e cila përcakton në nenin 69, pika 3 të saj se shqyrtimi i projektligjeve nuk mund të fillojë pa kaluar të paktën dy javë nga data e paraqitjes së saj.

14.Po sipas kërkuesve, shqyrtimi i projektligjit në një hapësirë kohore prej më pak se dy javësh, kohë e kërkuar për shqyrtimin e projektligjit me procedurë të zakonshme, pas sjell faktin që projektligji është shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar, por nuk rezulton që nga seanca plenare e Kuvendit të jetë marrë një vendim lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar. Kjo sipas kërkuesve cenon parimin e shtetit të së drejtës.

15.Në lidhje me sa pretendon kërkuesit, Kuvendi parashtron si më poshtë vijon:

16. Nisma e datës 18.7.2024, e paraqitur nga 17 deputetë, por që kërkuesit në mënyrë jo të drejtë i referohen si nisma e deputetit Oerd Bylykbashi,[1] referuar përmbajtjes së projektligjit dhe relacionit shoqërues, përbëhej nga 4 nene me këtë përmbajtje:

- Neni 1, ndryshon nenin 24 të Kodit Zgjedhor, titulluar *"Kompetencat e KQZ-së në lidhur me votimin nga jashtë vendit"*.
- Neni 2, ndryshon nenin 25 të Kodit Zgjedhor, titulluar *"Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit"*.
- Neni 3, shton nenin 25/1 të Kodit Zgjedhur, titulluar *"Votimi nga jashtë vendit dhe rezultati zgjedhor"*.
- Neni 4, është dispozita e hyrjes në fuqi.

17. Nëse shikojmë përmbajtjen e kësaj nisme ligjore, kjo nuk ka lidhje me parashikimet e nenit 5 të Ligjit nr.81/2024, që ka ndryshuar nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe që është edhe objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor. Për këtë arsye, që në dukje, pretnedimet që kanë të bëjnë me zbatimin e rregullores së Kuvendit, nuk kanë lidhje me këtë nismë legjislative.

---

[1] Ky deputet, si i vetëm, ka nënshkruar shkresën përcjellëse të këtij propozimit, por nuk është propozues i vetëm i nismës ligjore të datës 18.7.2024.

18. Pavarësisht nga sa më sipër, e shohim të nevojshme që të shpjegojmë procedurën e ndjekur në këtë rast, sëbashku më pretendimet përkatëse.

19.Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 12, datë 10.2.2022, miratoi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore dhe me vendimin nr.48/2022 miratoi anëtarësinë e tij.

20.Komisioni i Posaçëm u ngrit mbi bazën e barazisë pozitë-opozitë dhe u drejtua nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

21.Objekti i punës së komisionit ishte hartimi i ndryshimeve legjislative për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimi i rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe për zgjedhjet e mëparshme të patrajtuara, i rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, i partive politike parlamentare dhe organizatave jofitimprurëse. Objekt i punës së Komisionit ishin edhe 3 vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat kishin shfuqizuar dispozita të Kodit Zgjedhor.

22.Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij Komisioni i Posaçëm ka zhvilluar disa seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile vendase, që kanë fushë të përgjegjësisë së tyre çështjet zgjedhore, të partive politike parlamentare dhe joparlamentare, të institucioneve shtetërore, me organizata të diasporës që kanë fushë të përgjegjësisë së tyre çështjet zgjedhore.

23.Edhe pse Komisioni ishte i mbledhur, deputetë, përfaqësues të grupeve parlamentare, si dhe zgjedhës kanë depozituar nisma ligjore në Kuvendin e Shqipërisë, të cilat u bënë pjesë e shqyrtimit nga Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore:

Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar. (22.699 zgjedhës, Kristaq Kume, 7.11.2022)
- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar. (Deputet Fatmir Mediu, 8.11.2022)
- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29. 12.2018, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar. (Deputet Enkelejd Alibeaj, 15.11.2023)
Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2018, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar. (Grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 11.12.2023).

24.Komisioni i Posaçëm i Reformës zgjedhore nuk arriti konsensusin për hartimin e një nisme ligjore ku të përfshiheshin çështjet sipas objektit të veprimtarisë së miratuar nga Kuvendi dhe pushoi së funksionuar për shkak të mbarimit të afatit të miratuar nga Kuvendi.

25.Meqenëse Komisioni i Posaçëm nuk arriti të hartonte nismën ligjore, grupet parlamentare propozuan në Konferencën e Kryetarëve miratimin e ngritjes së Grupit të Dialogut për të diskutuar në mënyrë konstruktive ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar. Konferenca e Kryetarëve në mbledhjen e datës 15.3.2024, në mbështetje të nenit 12 të Rregullores, miratoi vendimin nr. 5, datë 15.3.2024, për ngritjen e Grupit të Dialogut në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

26.Me ngritjen e Grupit të Dialogut u krijuan hapësira dhe kushtet e nevojshme nëpërmjet një mekanizmi të barabartë dialogu mes shumicës dhe pakicës parlamentare, që në mënyrë transparente trajton me qëllim gjetjen e konsensusit çështje që kërkojnë diskutim politik konstruktiv e gjithëpërfshirës, ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar dhe legjislacionin e nevojshëm për ecurinë e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

27.Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 15.3.2024 miratoi përbërjen e grupit të dialogut me 6 deputetë anëtarë të këtij komisioni (3 nga shumica dhe 3 nga pakica parlamentare) dhe përcaktoi se vendimmarrja duhet të ishte me konsensus, ndërkohë çdo deputet i Kuvendit që dëshironte të jepte kontribut kishte të drejtë të merrte pjesë. Aktet e konsensusit të grupit u nënshtrohen procedurave parlamentare sipas Rregullores së Kuvendit.

28.Objekt i punës së Grupit të Dialogut u caktua rishikimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor në frymën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Grupi u mbështet edhe nga ekspertë njohës të procesit zgjedhor dhe mori në shqyrtim zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

29.Grupit të dialogut dhe ekspertëve të caktuar me propozim të të gjithë spektrit politik në Kuvend iu vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i shqyrtuar nga Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore dhe tri vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

30.Edhe pse Grupi i Dialogut vazhdonte debatin në lidhje me propozimet e sjella për shtesa dhe ndryshime të disa dispozitave të Kodit Zgjedhor, por nuk po arrinte konsensusin, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe zgjedhës vazhdonin të depozitonin nisma për shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor, si:

- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar. (Deputet Agron Duka, 24.4.2024)
- Vendim nr. 62, datë 20.6.2024, "Për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". (Adriatik Lapaj, 1.7.2024)
- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2018, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar. (Grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, 8.7.2024)
- Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar. (Deputet Oerd Bylykbashi, 18.7.2024)

31.Pavarësisht nismave të depozituara, Grupi i Dialogut vazhdonte të mblidhej dhe të diskutonte në lidhje me gjetjen e dakordësisë për të reflektuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor.

32.Në kushtet e mungesës së dakordësisë në lidhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor që do të rishikoheshin, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores, vendosi të marrë në shqyrtim nismën e depozituar nga deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, depozituar në Kuvend në datën 8.7.2024, si dhe të thërriste për të dëgjuar edhe të gjithë nismëtarët e nismave të depozituara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nga deputetë apo zgjedhës në të cilat propozoheshin shtesa apo ndryshime në Kodin Zgjedhor.

33.Referuar procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, rezulton se në mbledhjen e datës 24.7.2024 Komisioni thërriti dhe dëgjoi të gjithë propozuesit e nismave ligjore para se të vendoste nëse ato do të bashkoheshin dhe të shqyrtoheshin me nismën e depozituar nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste në datën 8.7.2024.

34.Kjo del qartë në paragrafët 2 dhe 3 të faqes 3 të procesverbalit të Komisionit, ku kryetarja e Komisionit deklaron se "*.... Kolegë, në këtë seancë të gjitha nismat lidhen me ndryshime në Kodin Zgjedhor, të cilat janë depozituar në bazë të kuadrit ligjor për iniciativën ligjvënëse të shtetasve, si dhe nga kolegët deputetë. Në kuadër të procedurës së parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, do të shqyrtohen së bashku.*
*Ne do të nisim me shqyrtimin e të gjitha nismave, duke iu referuar rendit kronologjik. Nisma e depozituar më herët do të prezantohet e para. Sipas radhës që unë kam këtu dhe njoftimeve që janë bërë, të gjithë ata që janë përfaqësues të nismëtarëve, qofshin nga zgjedhësit, nga kolegët deputetë apo nga grupet parlamentare, kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe janë të pranishëm.*"

35.Ndryshe nga sa parashtron kërkuesi, nisma e deputetit Oerd Bylykbashi u lejua t'i prezantohej Komisionit, por objekti i mbledhjes nuk ka ndryshuar, pjesë e procesit të shqyrtimit ishte nisma e depozituar në datën 8.7.2024, e cila pas shumë diskutimesh dhe amendamentesh të propozuara nga deputetët anëtarë të Komisionit iu nënshtrua procesit të shqyrtimit në parim, nen për nen dhe në tërësi.

36.Gjatë diskutimit deputetët e maxhorancës mbështetën amendamentet e bëra nga deputetët Oerd Bylykbashi, Gazmend Bardhi dhe deputetë të tjerë të pakicës parlamentare në lidhje me votimin nga jashtë vendit. Ekspertët së bashku me deputetët e Komisionit (pozitë- opozitë) kanë punuar për të përmirësuar nismën me qëllim për t'u bërë e përshtatshme për të arritur konsensusin dhe për ta bërë të tillë i janë referuar ndër të tjera edhe propozimit të deputetit Bylykbashi si anëtar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe si anëtar i Grupit të Dialogut. Në përfundim deputetët nismëtarë të shumicës parlamentare pranuan që Komisioni të shqyrtonte projektligjin e dakordësuar me amendamentet e propozuara nga deputetë anëtarë të Komisionit të shumicës, si dhe të pakicës parlamentare.

37.Kjo del qartë në pasazhin e paragrafit 6 në faqen 32 të procesverbalit të Komisionit, ku relatori Damian Gjiknuri propozon: "*Unë propozoj që këto amendime që kemi bërë në kolonën e tretë, që i kanë paraqitur ekspertët, të miratohen, pastaj mund të kalojmë në diskutimin nen për nen, nëse ka ndonjë detaj, por Kodi Zgjedhor është njëlloj romani, që është i shkruar si prozë, është aq i detajuar, sa nganjëherë nuk lë shumë vend për rregulla të tjera, pasi gjërat janë shumë të qarta.*"

38.Pra, nisma e Oerd Bylykbashit nuk është shqyrtuar si nismë, por thjesht është referuar dhe ka shërbyer për ekspertët dhe me pas për Komisionin si amendamente të opozitës, një pjesë e të cilave janë përfshirë më pas në draftin e dakordësuar.

39.Kuvendi në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të ligjit nr. 81/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2018, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,"" i ndryshuar, ka respektuar dispozitat e Rregullores së Kuvendit, konkretisht nenin 69, pika 3, të tij, në të cilën parashikohet se "*Shqyrtimi i projektligjeve nuk mund të fillojë pa kaluar dy javë nga data e paraqitjes së tyre, me përjashtim të rasteve kur në Rregullore parashikohet ndryshe*".

40.Nëse i referohemi procedurës së ndjekur nga Kuvendi, konstatojmë se nuk jemi para procedurës së përshpejtuar, Kuvendi nuk ka shqyrtuar një nismë specifike të deputetit Oerd Bylykbashi, por është shqyrtuar nisma e depozituar në datën 8.7.2024 në zbatim të nenit 69, pika 3, të Rregullores, e cila është plotësuar sipas përcaktimeve në nenin 71 të Rregullores, bazuar edhe në mendimet e ekspertëve, të cilët i janë referuar edhe amendimeve të deputetëve.

41.Projektligji i depozituar në datën 8.7.2024, pas amendimeve të bëra nga ekspertët dhe anëtarët e Komisionit, kënaqte ndër të tjera edhe qëndrimin opozitar të shprehur në propozimin e datës 18.7.2024, dhe për këtë arsye është dakordësuar nga Grupi i Dialogut dhe nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që e ka shqyrtuar.

42.Procedura e ndjekur nga Kuvendi për miratimin e ligjit nr. 81/2024 është në respektim të dispozitave kushtetuese të parashikuara nga neni 81, pikat 1 dhe 2, dhe neni 83, pika 1, të Kushtetutës.Kjo del qartë dhe nga diskutimet në mbledhjen e Komisionit të datës 24.7.2024, ku në paragrafin 2 të faqes 37 të procesverbalit kryetarja e Komisionit ka sqaruar:

"*...Pse bëni tani sikur po diskutoni për herë të parë projektligje. Nisma e zotit Gjikmuri, si përfaqësues i një grupi deputetësh të Partisë Socialiste, shqyrtohet në të njëjtën ditë me të gjitha nismat e tjera për Kodin Zgjedhor. Është depozituar më datën 8 korrik, pra ka bërë kohën e mjaftueshme, sipas nenit 69 të Rregullores, që të futet në shqyrtim. Siç e dini dhe siç ndodh gjithmonë sipas procedurave parlamentare relatori, këtu janë dy relatorë, bashkërelatorë, të cilët marrin nismat, shohin amendamentet që kanë vetë relatorët, caktojnë darkodësinë me njëri-tjetrin ose propozimet që bën relatori, bëjnë tabelën, ia dërgojnë komisionit dhe në fund dalin me një version. Nuk është e thënë që ne të vijmë me versionin e depozituar, ka edhe amendamente. Kjo është një praktikë që ju, zoti Alibeaj, si të gjithë deputetët e tjerë të Kuvendit, nuk jeni deputet i ri, e dini që kështu ndodh. Sot ju ka ardhur me e-mail një dokument zyrtar publik, që ju thotë se ky është versioni i depozituar, sugjerimet e relatorëve, ato do të diskutohen. Kaq! Nuk ka lidhje me draft të ri apo draft të vjetër. Çdo deputet ka të drejtën e tij edhe të mos e paraqesë fare para se të jetë çështja në shqyrtim, por, duke u bërë diskutimi, të bëjë amendamente....*"

43.Nuk kemi një nismë të re, por kemi të njëjtën nismë, e cila ka pësuar ndryshime nga Komisioni përgjatë shqyrtimit të tij sipas procedurës parlamentare, nenit 71 të Rregullores se Kuvendit **Ritheksojmë se nisma e zotit Bylykbashi nuk është shqyrtuar nga Komisioni për shkak se amendamentet e bëra tashmë reflektonin edhe qëllimin e vetë nismës së tij.**

44.Ndryshe nga sa parashtron kërkuesi, këto amendamente janë pranuar nga propozuesit dhe janë në përputhje me qëllimin e hartuesve të projektligjit të depozituar në datën 8.7.2024, dhe kanë si synim të riformulojnë dispozita të caktuara të Kodit Zgjedhor edhe sipas këndvështrimit të opozitës.

45.Praktika parlamentare ka shumë raste kur projektligji i depozituar ( pavarësisht nga nismëtari) ka pësuar ndryshime thelbësore në më shumë se 50% të tij, heqje apo shtim kapituj, dhe nuk kondicionohet amendamenti nga numri i dispozitave për të cilën është depozituar nisma apo dhe nga qëllimi fillestar i nismës. Nëpërmjet amendamenteve shtohet kuadri i çështjeve që kërkohet të zgjidhen etj.

46.Edhe gjatë shqyrtimit në seancë plenare deputetët kanë paraqitur amendamente, ku një pjesë e tyre janë miratuar gjatë shqyrtimit nen për nen të ligjit dhe janë bërë pjesë integrale e tij.

Nga sa parashtruan Kuvendi vlerëson se pretendimet e ngritura nga kërkuesi janë të pabazuara në procedurën e ndjekur nga Kuvendi në shqyrtimin dhe miratimin e ligjit nr. 81/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar.

47.Kjo procedurë është në përputhje me Rregulloren, praktikën parlamentare dhe nuk vjen ndesh me asnjë dispozitë të Kushtetutës që lidhet me procesin ligjvënës

48. Theksojmë se Kushtetuta në nenin 81, pika 1, parashikon se:

> *1. Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.*

49. Pra, Siç mund të konstatohet me lehtësi, një nga subjektet që ka të drejtë të ndërmarrë nisma ligjvënëse janë edhe deputetët. Përdorimi i përemërit të pacaktuar "çdo" përpara fjalës "deputet", tregon qartësisht se edhe një deputet i vetëm, ka të drejtën që të ndërrmarrë nisma legjislative.

50. Ky koncept është në përputhje edhe me parashikimet e dispozitave të tjera kushtetuese, ku mund të përmendim fillimisht nenin 2, pika 2 të Kushtetutës, e cila përcakton se:

> *2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.*

51. Pra, duke qenë se Shqipëria është përcaktuar si një republikë parlamentare (neni 1, pika 1 e Kushtetutës), nga vetë ligji themelor është përcaktuar se sovraniteti popullor ushtrohet si rregull nëpërmjet përfaqësuesve të tij (deputetët) dhe përjashtimisht drejtëpërdrejtë nga populli nëpërmjet referendumeve të ndryshme, të njohura nga Kushtetuta. Kjo qasje bazohet në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr.25, datë 24.7.2009, ndër të tjera është shprehur se:

> *13. ... Paragrafi në vijim i të njëjtit nen deklaron, se "populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt". Nga interpretimi literal dhe historik i këtij paragrafi Gjykata çmon, se* ***kushtetutëbërësi ka shprehur një preferencë të qartë në favor të demokracisë përfaqësuese.***

52. Një tjetër dispozitë kushtetuese, e cila shërben në zgjidhjen e kësaj çështjeje është edhe nenin 70, pika 1 e Kushtetutës, sipas të cilit:

> *1. Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.*

53. Për këtë parashikim kushtetues, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.44, datë 7.10.2011, ndër të tjera ka mbajtur qendrimin se:

> *17. Doktrina mbizotëruese e përkufizon mandatin parlamentar si një akt të kalimit të sovranitetit nga populli tek përfaqësuesit e tij. Përfaqësimi, në kontekstin e mandatit parlamentar, nënkupton delegimin e të drejtës nga shumë persona tek një person i vetëm për të vendosur mbi çështje që lidhen*

*me qeverisjen e vendit. Çdo qytetar konsiderohet si mbajtës i një copëze të barabartë të sovranitetit, i cili, i marrë në shumën totale të tij, bën të mundur marrjen e vendimeve nga mbajtësi i sovranitetit që është populli, nëpërmjet përfaqësimit të tij nga deputeti.*

*18. ... Mandati parlamentar, në parim, është i përgjithshëm, domethënë parlamentarët përfaqësojnë kombin si të tërë dhe jo një grup votuesish, gjithashtu ai është dhe përfaqësues, që do të thotë se deputetët nuk janë të lidhur pas ndonjë urdhri apo dëshire që vjen nga elektorati. Parlamentarët gëzojnë pavarësi të plotë përballë elektoratit por edhe ndaj grupimit politik ku ata bëjnë pjesë. Ata mund të largohen apo bashkohen sipas dëshirës dhe vullnetit të tyre. Për këtë arsye, pranohet se mandati parlamentar në një demokraci është i parevokueshëm.*

*...*

*23. Gjykata thekson se neni 70/1 i Kushtetutës parashikon shprehimisht se deputeti gëzon mandat të lirë. Kjo mbrojtje kushtetuese shtrihet natyrshëm edhe ndaj ushtrimit faktik të tij. Deputeti ushtron mandatin e tij të lirë nga çdo lloj ndërhyrje, në pavarësi të plotë, dhe pa iu nënshtruar urdhërave apo kërkesave të ndryshme, por vetëm bindjes dhe ndërgjegjes së tij. Pavarësia e mandatit të deputetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, i shërben forcimit të statusit përfaqësues parlamentar duke garantuar edhe të drejtat e pakicës parlamentare brenda sistemit të vendimmarrjes me shumicë. Deputeti është i lirë të ushtrojë funksionin e tij në mënyrën më të mirë të mundshme të zgjedhur prej tij. Nga tërësia e karakteristikave që mbart në vetvete mandati parlamentar, është e qartë se deputeti gjatë ushtrimit të detyrës së tij nuk i nënshtrohet urdhërave, ndryshe nga pjesa tjetër e punonjësve ose nëpunësve të shërbimit civil. Ai pranon në mënyrë krejtësisht të lirë mandatin e tij dhe vendos me përgjegjësinë e tij të plotë mbi mënyrën e ushtrimit të mandatit. Veprimtaria e tij si deputet duhet të përshkohet gjatë gjithë kohës që ai ushtron këtë funksion nga përgjegjshmëria, ndershmëria dhe korrektesa. Ky detyrim për deputetin fillon që në momentin e fillimit të mandatit parlamentar.*

54. Bazuar në këto parashikime kushtetuese që tregojnë për statusin dhe të drejtat e deputetit, Rregullorja e Kuvendit, në nenin 71 të saj parashikon se:

*1. Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të propozojë amendament/te gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës. Amendamenti paraqitet me shkrim dhe i arsyetuar.*

*2. Amendamenti i propozuar nga Këshilli i Ministrave shoqërohet nga vlerësimi i përputhshmërisë së tij me legjislacionin e Bashkimit Europian.*

*3. Komisioni përgjegjës merr në shqyrtim amendamentin e propozuar nga deputeti ose Këshilli i Ministrave dhe jep shpjegime të arsyetuara për miratimin ose rrëzimin e tij në raportin që harton për seancën plenare.*

55. Referuar kësaj dispozite, rezulton se propozimi për amendime, **mund të vijë nga çdo deputet.** Detyrimi që buron mbi komisionin parlamentar përgjegjës është që të japë *shpjegime të arsyetuara për miratimin ose rrëzimin e tij në raportin që harton për seancën plenare*, kusht ky që rezulton

të jetë plotësuar në këtë rast. Mënyra se si është shkruar dispozita e mësipërme nuk tregon të jetë kufizuese për llojin dhe natyrën e amendameteve që mund të propozohen në këtë fazë të procesit legjislativ.

56. Përkundrazi në ato raste kur është dashur që procesi i porpozimit të amendameteve të jetë e kufizuar, kjo është bërë e qartë në dispozita të tjera të rregullores së Kuvendit. Më konkretisht, kur trajtohen çështjet e propozimit të amendamenteve në fazën e shqyrtimit të projektligjeve në seancë plenare, Rregullorja e Kuvendit, në nenin 75, pika 3, ndër të tjera shprehet se:

> *3. Gjatë shqyrtimit nen për nen mund të paraqiten amendamente të bëra me shkrim. Çdo amendament duhet t'i referohet përmbajtjes së një neni të vetëm.*

57. Pra, në këtë rast ka një kufizim të së drejtës së deputetëve në propozimin e amendamentëve në një projektligj e cila *duhet t'i referohet përmbajtjes së një neni të vetëm*. Siç e theksuam këtë kufizim nuk e gjejmë në fazën e shqyrtimit të projektligjit në komisionet përgjegjëse.

58. Nga sa më sipër, nisur edhe nga të drejtat kushtetuese që deputetët gëzojnë, ku më kryesorja është ajo për nismë legjislative, propozimi i ardhur nga deputeti Oerd Bylykbashi është trajtuar si amendime/propozime për ndryshime të nismës së depozituar më herët dhe për rrjedhojë është shqyrtuar edhe si e tillë, duke mos pasur asnjë kufizim nga ana e rregullores.

***B. Lidhur me Cënimin e parimit të barazisë së votës, të drejtën për të zgjedhur,iii) parimin e hierarkisë së normave juridike,***

59.Kërkuesit bë parashtrimet e tyre pretendojnë se neni 5 i ligjit 81/2024, me të cilin është ndryshuar neni 67 i Kodit Zgjedhor, i) cënon parimin e shtetit të së drejtës,ii) të barazisë së votës, të drejtën për të zgjedhur,iii) parimin e hierarkisë së normave juridike, rezervën ligjore dhe barazinë para ligjit. Sipas kërkuesve ky nen në pikat 1 dhe 2 të tij, është në kundërshtim me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike, barazisë para ligjit, kufizimit disproporcional të të drejtave të shtetasve dhe me vetë frymën e vendimit nr. 28/21 të Gjykatës Kushtetuese. .Se lidhëza "dhe" e përdorur ndërmjet shkronjës a) dhe shkronjës b) të pikës 1 të nenit 67 krijon detyrimin për të paraqitur në zgjedhje dy lista kandidatësh (listën e fiksuar dhe listën e votës parapëlqyese) duke sjellë si pasojë edhe zbatimin e detyrueshëm të nenit 163 i cili shpërndan fillimisht mandatet për kandidatët e listës së fiksuar dhe më pas për kandidatët e listës parapëlqyese.

60.Për kërkuesit ,zbatimi i kombinuar i neneve 67 dhe 163 përbën një kufizim disproporcional të së drejtës së votës, e për pasojë edhe të së drejtës për të zgjedhur; përbën cënim të parimit të sigurisë juridike, sepse e drejta e votës parapëlqyese ka qenë e shtrirë tek të gjithë kandidatët pa përjashtim në sistemin e mëparshëm zgjedhor; përbën pabarazi në ligj (diskriminim) mes kandidatëve të listës së fiksuar krahasuar me kandidatët e listës me votë parapëlqyese; si dhe pabarazi në zgjedhje (diskriminim) midis partive politike. Në mungesë të detyrimit për paraqitjen e domosdoshme të të dy listave (detyrim i krijuar nga prania e lidhëzës "dhe") partitë politike do të mund të konkurronin në zgjedhje sipas interesit të tyre ose në variantin me dy lista, ose në variantin vetëm me listën që i nënshtrohet votës parapëlqyese, listë e cila përfshin numrin e plotë të kandidatëve të kërkuar nga ligji dhe shpërndarja e mandateve të fituara të bëhet vetëm sipas kësaj liste.

61.Në pikën 2 të neni 67, rrumbullakosja e numrit të mandateve që nuk i nënshtrohet votimit parapëlqyes sjell cënim të dispozitës kushtetuese e cila përcakton qartësisht kufirin minimal prej 2/3 e listës që do të duhet t'i nënshtrohet votimit parapëlqyes. Si i tillë ky rregullim ligjor është antikushtetues, argumentojnë kërkuesit.

62.Në lidhje me këto pretendime Kuvendi duke ju referuar dispozitave të Kodit zgjedhor i ndryshuar sqaron si me poshte vijon :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ne nenin 64 të saj përcakton:

*"Neni 64*

*1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar.*
*2. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar.*
*3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.*

Ligji nr. 81/2024, datë 26.7.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar, parashikon:

***"Neni 67***
***Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive politike***

*1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ për çdo zonë zgjedhore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, listën që përbëhet nga:*
*a) lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe*
*b) lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.*
*2. Emrat në listën shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati. Numri i përgjithshëm i kandidatëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjesëtuar për tre. Kur nga ky pjesëtim nuk rezulton numër i plotë mandatesh, atëherë në rast se presja dhjetore si pasojë e pjesëtimit është e barabartë ose më e madhe se 0,5 lista përmbyllet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e pjesëtimit rezulton presja dhjetore më e vogël se 0,5, lista shumemërore me renditje të fiksuar e kandidatëve mbyllet me numrin e plotë pararendës.*

*3. Lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhësit është e barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. Renditja e kandidatëve bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre.*
*4. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore, nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish.*
*5. Kandidati për deputet, i regjistruar në listën shumemërore me renditje të fiksuar të partisë politike apo koalicionit, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe në listën shumemërore të kandidatëve për deputetë që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.*
*6. Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin një në çdo tre emra të kandidatëve të listës shumemërore me renditje të fiksuar i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës shumemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar....*
*10. Në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumemërore KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të këtij Kodi.*

***Neni 163***
***Shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues të listës***

*1. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt zgjedhor.*
*2. Kandidatët e listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes rirenditen në bazë të numrit më të lartë të votave parapëlqyese për secilin kandidat. Kur numri i votave është i barabartë, renditja përcaktohet me short. Rirenditja sipas kësaj pike përdoret në zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi. Në rastet kur nga rirenditja nuk rezulton që duke filluar nga kreu i kësaj liste, një në çdo tre emra i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, atëherë kandidati i tretë në këtë listë dhe në vijim një në çdo tre emra të saj i përket gjinisë më pak të përfaqësuar sipas numrit të votave që këto të fundit kanë marrë. Mbi bazën e këtij kriteri 87 hartohet lista përfundimtare që i nënshtrohet votimit parapëlqyes e renditur, e cila përdoret për zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi.*
*3. Mandatet për kandidatët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidatëve në të dhe, në rast shterimi të saj, vijohet me kandidatët fitues të rirenditur të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes sipas pikës 2 të këtij neni.*
*4. Përllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi miratohet për çdo zonë zgjedhore më vete. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS."*

63.Mbi bazën e autorizimit kushtetues të parashikuar në nenin 64, pika 3, të Kushtetutës, Kuvendi ka miratuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor nëpërmjet ligjit nr. 81/2024 në bazë të të cilit garantohet që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore të kandidatëve për deputetë në një zonë zgjedhore dhe njëkohësisht të sigurojë përfaqësim gjinor në përbërjen e Kuvendit.

64.Në çdo këndvështrim Kuvendi nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka zbatuar përcaktimet e bëra në nenin 64 dhe ka miratuar zgjidhje ligjore që u përmbahen kërkesave të Kushtetutës.

65.Lista e kandidatëve që një subjekt zgjedhor (p.sh. parti politike) paraqet në një zonë zgjedhore (qark) sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor plotëson për pasojë kërkesat e Kushtetutës. P.sh. Qarku i Durrësit ka gjithsej 14 mandate për deputetë.
Sipas Kodit Zgjedhor në fuqi, një subjekt zgjedhor (p.sh. parti politike) ka detyrimin të paraqesë një listë kandidatësh për deputetë për këtë qark, e cila përbëhet nga lista me renditje të fiksuar 14 3 = 4.66, pra 5 kandidatë për deputetë dhe një listë prej 14 kandidatësh për deputetë që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.

66.Në total, ka një listë të kandidatëve për deputetë që subjekti zgjedhor parti politike paraqet në Qarkun e Durrësit për votim dhe është 19 deputetë dhe për të cilën me shumë se 2/3 e saj i nënshtrohet votimit parapëlqyes në nivelin e zonës zgjedhore. Njëkohësisht kjo zgjedhje përmban edhe garancinë që në momentin e kandidimit, në momentin e zgjedhjes dhe pastaj në momentin e krijimit të vakancave të sigurohet përfaqësimi i gjinisë më pak të përfaqësuar.

67.Për zbatimin e përcaktimeve të një norme kushtetuese mund të ketë më shumë se një mënyrë dhe i tillë është rasti i nenit 64, pika 3, të Kushtetutës kur parashikohet shtrirja e shkallës së votimit parapëlqyes kur në tekstin e saj përdoret shprehja "jo më pak se". Në ushtrimin e diskrecionit legjislativ të Kuvendit së fundmi është bërë një rregullim i ndryshëm ligjor në Kodin Zgjedhor për sa i takon listës së kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes dhe tashmë pa mekanizmin e herësit. Është e drejtë kushtetuese e Kuvendit si pushtet legjislativ në vend të eksplorojë, të hartojë dhe të miratojë zgjidhje për formulime ligjore që mbështeten nga një shumicë e cilësuar e anëtarëve të tij, por në çdo rast duke respektuar parimet kushtetuese.

68.Kuvendi vlerëson se paraqitjet e kërkuesve në thelb kërkojnë "të shpallin antikushtetuese formulimin e nenit 63, paragrafi i tretë" i Kushtetutës kur kjo është e pamundur. Argumentet e paraqitura janë të vlefshme për diskutimin përpara dhe gjatë formulimit aktual në fuqi të nenit 64, paragrafi i tretë. Për sa kohë ky debat është zhvilluar kohë më parë dhe Kuvendi ka miratuar ndryshimet kushtetuese me formulime konkrete të bëra në nenin 64, paragrafi 3, goditja e këtyre formulimeve në Gjykatën Kushtetuese është e pavend. Kuvendi vetëm ka zbatuar me miratimin e ligjit zgjedhor përcaktimin e bërë në normën kushtetuese, nenin 64, pika 3. Çështja nëse e gjithë lista e kandidatëve për deputetë në një zonë zgjedhore duhet t'i nënshtrohet votimit parapëlqyes nuk ka bazë kushtetuese për sa kohë neni 64/3 përcakton kufirin minimal të listës që i nënshtrohet votimit parapëlqyes dhe që duhet ta vendosë Kuvendi.

69.Kuvendi e ka bërë me ligjin që miratohet me tre të pestat e të gjithë anëtarë të tij përcaktimin e këtij kufiri dhe respektimi i këtij formulimi kushtetues përbën një detyrim të Kuvendit brenda diskrecionit dhe hapësirës së vlerësimit që i ka dhënë Kushtetuta Kuvendit. Nuk është rastësore që kjo hapësirë vlerësimi kërkon domosdoshmërish një shumicë të cilësuar prej 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

70. Gjithashtu dëshirojmë të sjellim në vëmëndje se, votimi në lista të mbyllura, nuk cënon parimet kushtetutese të lirisë së votës dhe kjo është një çështje që është shqyrtuar edhe më parë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin e saj nr. 11 datë 13.03.2015, ndër të tjera është shprehur se:

*15. Nisur nga fakti se argumenti kryesor i kërkuesit në mbështetje të këtij pretendimi lidhet me cenimin e lirisë së votës, Gjykata përpara se të vlerësojë respektimin e këtij aspekti kushtetues nga ligjvënësi, çmon të ndalet paraprakisht në sqarimin e konceptit "votim i lirë". Duke iu referuar Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, kuptimi i votimit të lirë përfshin dy aspekte të ndryshme, formimi i lirë i vullnetit te zgjedhësit dhe liria e shprehjes së këtij vullneti, domethënë liria e procedurës së votimit dhe vlerësimi i saktë i rezultatit. Liria e zgjedhësve për të formuar vullnetin e tyre është e ndërthurur pjesërisht me parimin e shanseve të barabarta. Ky aspekt, kërkon që shteti dhe autoritetet publike, në përgjithësi, të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme, veçanërisht për sa i përket përdorimit të mediave, vendosjes së afisheve zgjedhore, të drejtës për të demonstruar në sheshe publike dhe financimit të partive dhe kandidatëve. Liria e zgjedhësve për të shprehur vullnetin e tyre kërkon, para së gjithash, zbatimin rigoroz të procedurës së votimit. Në praktikë, zgjedhësit duhet të kenë mundësi të votojnë për listat e regjistruara ose për kandidatët, gjë që do të thotë se atyre duhet t'u vihen në dispozicion fletët e votimit me emrat e kandidatëve dhe t'u krijohet mundësia të hedhin fletët e votimit në kutitë e votimit. Shteti duhet të sigurojë mjediset e duhura për kryerjen e veprimeve zgjedhore.*

*16. Gjykata vëren se lidhur me aspektin e parë të "votimit të lirë", e që lidhet me formimin e lirë të vullnetit të zgjedhësve,* ***kërkuesi nuk ka argumentuar në nivel kushtetues se në ç'mënyrë është cenuar ky aspekt nga hartimi i listave të mbyllura apo përmbajtja e fletës së votimit.*** *Për më tepër, ky aspekt i ushtrimit të lirë të votës konsiston më së shumti në përgjegjësi tekniko - organizative që u atashohen autoriteteve shtetërore, se sa në elementet substanciale të procesit të depozitimit të kandidaturave. Ndërsa, lidhur me aspektin e dytë që lidhet me lirinë e shprehjes së këtij vullneti (liria e procedurës së votimit), duke analizuar në tërësi përmbajtjen e Kodit Zgjedhor, Gjykata vëren se* ***ligji parashikon një sistem bazë të publikimit të listave zgjedhore me emrat e kandidatëve dhe për rrjedhojë votuesit paraprakisht mund të njihen me to.*** *Sipas nenit 73/3 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja e publikon listën e plotë të kandidatëve në media dhe në faqen zyrtare të saj në internet. Një kopje e listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet prefektit, këshillit të qarkut dhe KZAZ-ve, të cilat e publikojnë atë në mediat vendore dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre, sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.*

*17. Duke konsideruar sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se argumentet e paraqitura nga kërkuesi për të mbështetur cenimin e lirisë së votës janë të pabazuara, si rrjedhim ky pretendim i kërkuesit nuk qëndron.*

71. Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese e ka përcaktuar qartë tashmë se votimi dhe në lista të mbylluara nuk përbën cënim të parimit të barazisë së votës. Për këtë arsye, ky pretendim, jo vetëm është i pabazuar, por edhe nuk mundet që të merret në shqyrtim nga ana e Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 *"Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese"*, i ndryshuar, në nenin 31/a, pika 2, gërma "dh", ndër të tjera parashikon se:

*2. Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur:*

...

*dh) kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ...;*

72. Nga sa më sipër, edhe për këtë shkak, pretnedimet që ngrihen në lidhje me listat e mbyllura, janë haptazi të pabazuara dhe nuk mundet që të merren në shqyrtim nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

73. Përsa i përket rastit, ku nga pjesëtimi nuk rezulton një numër i plotë mandatësh, këto janë rregullime të vogla që vijnë si rezultat i rregullave matematikore. Numri i deputetëve që dalin për çdo qark, përcaktohen në bazë të numrit të popullsisë që ka ai qark në priudhën e votimit. Ky numër jo domosdoshmërisht, mund të plotëpjestohet me tre. Për Këtë arsye, u parashikua në Kodin Zgjedhor, neni 67, pika 2, fjalia e katërt, rregulli se

> *Kur nga ky pjesëtim nuk rezulton numër i plotë mandatesh, atëherë në rast se presja dhjetore si pasojë e pjesëtimit është e barabartë ose më e madhe se 0,5 lista përmbyllet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e pjesëtimit rezulton presja dhjetore më e vogël se 0,5, lista shumemërore me renditje të fiksuar e kandidatëve mbyllet me numrin e plotë pararendës.*

74. Theksojmë se kjo qasje e ligjvënësit është bazuar në një zgjidhje analoge që ka dhënë Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj, me vendimin nr.40, datë 17.5.2001, ndër të tjera është shprehur se:

> *Përderisa vetë Kushtetuta njeh ndarjen e zonave me numër të përafërt zgjedhësish, ajo nënkupton se **barazitizmi ndërmjet tyre bëhet objektivisht i pamundur**, si dhe **diferencimi në numër të pranueshëm zgjedhësish që mund të krijohet ndërmjet zonave në raport me numurin mesatar të zgjedhësve, është i lejueshëm** dhe nuk mund të përbëjë shkak për antikushtetutshmëri. Kjo përafërsi në numër, sigurisht që duhet të përmbushet nga organi përkatës, por nëse nuk ka mundësi realizimi në praktikë, atëhere detyrimisht janë kriteret e tjera, të cilat jo vetëm që nuk duhet të cënohen, por duhet të ndërthuren njëkohësisht me njëri-tjetrin për aq sa është e mundur për të patur një ndarje të drejtë të zonave zgjedhore. Ky koncept kushtetues që duhet respektuar nga ligjvënësi në ndarjen e zonave zgjedhore, i analizuar nga ky këndvështrim, merr një kuptim edhe më të gjerë. **Të kuptuarit e këtij koncepti kushtetues vetëm si kriter aritmetik si dhe zbatimi i tij në mënyrën strikte numerike në ndarjen e zonave zgjedhore, sigurisht që mund të sjell edhe cënimin e parimeve apo vlerave të tjera kushtetuese.***

75. Duke e parë legjislaiconin edhe në këndvështrimin e kësaj jurisprudence, rregullimi që ka dashur të bëjë ligjvënësi, kur numri i deputetëve për atë qark (që është një zonë zgjedhore) në nenin 67, pika 2, fjalia e katërt e Kodit Zgjedhor, nuk passjell antikushtetutshmëri të kësaj norme, pasi është e kuptueshme vetvetiu që ndarja e zonave zgjedhore nuk sjell një barazi strikte, siç pretendojnë kërkuesit.

*

* *

## III. NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR PEZULLIM

76.Kërkuesi, Partia 'Lëvizhja për Zhvilim Kombëtar" në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkon pezullimi i zbatimit të gërmës "a" dhe "b" të pikës 1 dhe fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar, me nenin 5 të ligjit nr.81/2024.

77. Ligji nr. 8577/2000 në nenin 45 parashikon:

> *"1. Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.*
> *2. Vendimi për masën e pezullimit i njoftohet organit përkatës që ka nxjerrë ligjin ose aktin, si dhe bëhet publikimi i tij.*
> *3.Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, me vendim në seancën plenare, mund të heqë masën e pezullimit.*
> *4. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit.*
> *5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në çdo rast jepet i arsyetuar dhe publikohet menjëherë.*

78.Pra, neni 45 i ligjit nr. 8577 parashikon mundësinë për të pezulluar zbatimin e një akti normativ, ligjor apo nënligjor në rast se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve.

79.Lidhur me këtë nevojitet të sqarohet fillimisht kuptimi i *"pasojës"* që parashikon dispozita. Me këtë term *gjykata* ka kuptuar gjithmonë *"pasoja të rënda dhe të pariparueshme" e rregulluar nga ligjvënësi* në nenin 45, pika 1, të ligjit. Kjo pikë është thelbësore, pasi, nëse fjala "pasoja" nuk do të shoqërohej me epitetet "të rënda dhe të pariparueshme", atëherë praktikisht Gjykata do të duhej të pranonte absolutisht të gjitha kërkesat për vendosjen e masave të pezullimit, të cilat do t'i paraqiteshin nga subjektet e interesuara. Në këtë kuptim vlerësimi i Gjykatës për të vendosur pezullimin ka të bëjë ekskluzivisht me rëndësinë (seriozitetin) dhe pariparueshmërinë e pasojave që vendimi i kundërshtuar mund të prodhojë, para se Gjykata të shprehet në mënyrë përfundimtare mbi themelin e kërkesës.[2]

80.Në rastin konkret pretendimet e ngritura nga kërkuesi për pezullimin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 dhe fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" për Kuvendin është i pabazuar

81.Kuvendi arsyeton se nuk jemi në kushtet e zbatimit të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, që Gjykata të mund të vendosë pezullimin e këtyre dispozita të kërkuara nga kërkuesi Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar

---

[2] Vendimi nr.19, datë 25.4.2013, i Gjykatës Kushtetuese, parag.10.

82.Në parashtrimet e kërkuesit për pezullim nuk ka analizuar pasojën e rëndë që do t'i sillte partisë politike apo zgjedhësve për të cilën Gjykata duhet të vendoste pezullimi i menjëhershëm i pikës 1, shkronjat "a" dhe "b", të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, deri sa të shprehet në mënyrë përfundimtare mbi themelin e kërkesës. Pasojat e pretenduara janë hipotetike dhe dispozita për të cilën kërkohet pezullimi nuk ka dhënë asnjë efekt mbi kërkuesit.
Për këtë po i referohen përmbajtes së nenit 67 për të cilën kërkuesi kërkon pezullimin e tij deri sa Gjykata të shpallë vendimin përfundimtar.

83.Nëse i referohemi përmbajtjes së pikës 1, shkronjat "a" dhe "b", të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, në të cilën thuhet:

> *"1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ për çdo zone zgjedhore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, listën që përbëhet nga:*
> *a) lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe*
> *b) lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyer",*

rezulton se efektet e nenit 67, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, i shtrin 50 ditë para zgjedhjeve.

84. Neni 8 i Kodit Zgjedhor parashikon:

> *"Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 prilli deri në 15 maj ose nga 15 tetori deri në 15 nëntor. Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet e parashikuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8 të nenit 9 të këtij ligji."*

85.Referuar kësaj dispozite, nëse Presidenti dekreton zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin, periudha zgjedhore do të jetë ajo midis 15 prillit deri më 15 maj. Neni 67 i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, parashikon afatin e paraqitjes së listës shumemërore të kandidatëve, që do të ishte midis datës 23 shkurt apo 25 mars 2025 , kohë në të cilën shqyrtimi i kësaj kërkese në Gjykatën Kushtetuese, nisur edhe nga vendimi i saj në mbledhjen e gjyqtarëve të datës 21.10.2024, për të shpejtuar afatet, do të ketë përfunduar.

86. Për sa analizuar më lart, gjykojmë se pretendimi për pezullimin e zbatimit të pikës 1, shkronjat "a' dhe "b", të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577/2000 dhe kërkesa duhet rrëzuar si e pabazuar.

**Në përfundim**

Kuvendi i kërkon Gjykatës Kushtetuese ta rrëzojë kërkesën si të pabazuar në ligj dhe Kushtetutë.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Genci GJONÇAJ**

**Vendim nr. 85 datë 24.12.2024**

**(V-85\24)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari , Sonila Bejtja , Sandër Beci , Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Enina Kotoni, në datën 04.12.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 18 (P) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **PARTIA "LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR"**, përfaqësuar nga kryetar Dashamir Shehi dhe avokat Rezart Kthupi, me autorizim.

**PARTIA "NISMA THURJE"**, përfaqësuar nga kryetar Endri Shabani.

**ORGANIZATA "SHQIPËRIA BËHET"**, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv Adriatik Lapaj, me autorizim.

**PARTIA "ALEANCA DEMOKRACIA E RE", PARTIA "LËVIZJA DEMOKRATIKE PËR NDRYSHIM", PARTIA "KOMBËTARE KONSERVATORE ALBANIA", PARTIA "BASHKIMI DEMOKRISTIAN SHQIPTAR", PARTIA "ORA E SHQIPËRISË", LULZIM BASHA, ORJOLA PAMPURI, MERITA BAKIU, GËZIM ADEMAJ**, përfaqësuar nga avokat Jordan Daci, me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Viktor Gumi, me autorizim.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i neneve 67 dhe 163, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të**

**ndryshuar me nenet 5 dhe 9 të ligjit nr. 81/2024, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**Pezullimi i zbatimit të neneve 67 dhe 163 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar me nenet 5 dhe 9 të ligjit nr. 81/2024.**

**Interpretimi përfundimtar i nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimi i tij.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 7, 9, 15, pika 1, 17, 18, 22, 45, 64, 70, 83, 116, 122, 123, 124, 131, pika 1, shkronja "a", 134, pikat 1, shkronjat "gj", "h", "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30, 45, pika 1, 47, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesve, partive "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", "Nisma Thurje", "Aleanca Demokracia e Re", "Lëvizja Demokratike për Ndryshim", "Kombëtare Konservatore Albania", "Bashkimi Demokristian Shqiptar" dhe "Ora e Shqipërisë", organizatës "Shqipëria bëhet", deputetëve Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Bakiu dhe Gëzim Ademaj, që kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), që kërkoi rrëzimin e kërkesës, mendimin me shkrim të Avokatit të Popullit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 115/2020, datë 30.07.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar". Ky ligj ka ndryshuar nenet 64 dhe 68, pika 1, të Kushtetutës.

2. Konkretisht, përmbajtja e nenit 64 të Kushtetutës ka ndryshuar, si vijon: "*1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar. 2. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar. 3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes, përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.*". Ndërsa përmbajtja e nenit 68, pika 1, të Kushtetutës ka ndryshuar si vijon: "*Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.*".

3. Pas ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 118/2020, datë 05.10.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", i cili, ndër të tjera, ka ndryshuar edhe përmbajtjen e neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor që lidhen me listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive politike, si dhe shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues të listës. Ndërkohë, përmbajtja e nenit 163 të Kodit Zgjedhor (të ndryshuar) i është nënshtruar kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 28, datë 30.06.2021, ka vendosur shfuqizimin e pikës 3 të nenit 163 të atij kodi, që parashikonte aplikimin e herësit në shpërndarjen e mandateve të kandidatëve fitues, si të papajtueshme me Kushtetutën.

4. Në datën 26.07.2024 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 81/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të

ndryshuar", i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 26.7.2024 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij. Përveç parashikimeve ligjore për votimin nga jashtë territorit të Shqipërisë, ky ligj ka riformuluar tërësisht nenet 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor.

5. Kështu, neni 67 i këtij kodi përcakton mënyrën e paraqitjes së listave të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend dhe ka këtë përmbajtje: "*1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ për çdo zonë zgjedhore, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, listën që përbëhet nga: a) lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe b) lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. 2. Emrat në listën shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati. Numri i përgjithshëm i kandidatëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjesëtuar për tre. Kur nga ky pjesëtim nuk rezulton numër i plotë mandatesh, atëherë në rast se presja dhjetore si pasojë e pjesëtimit është e barabartë ose më e madhe se 0,5 lista përmbyllet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e pjesëtimit rezulton presja dhjetore më e vogël se 0,5, lista shumemërore me renditje të fiksuar e kandidatëve mbyllet me numrin e plotë pararendës. 3. Lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhësit është e barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. Renditja e kandidatëve bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre. 4. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore, nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. 5. Kandidati për deputet, i regjistruar në listën shumemërore me renditje të fiksuar të partisë politike apo koalicionit, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe në listën shumemërore të kandidatëve për deputetë që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. 6. Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin një në çdo tre emra të kandidatëve të listës shumemërore me renditje të fiksuar i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe një në çdo tre emra të listës shumemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar. 7. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kandidati*

*për kryetar të bashkisë dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve. Kandidati për kryetar të bashkisë dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë depozitohet në KQZ në rastet kur territori i njësisë së qeverisjes vendore nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme. 8. Kandidati për kryetar bashkie apo për këshillin e bashkisë nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. 9. Në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje të kandidatëve të subjekteve zgjedhore duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. 10. Në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumemërore, KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të këtij Kodi.".*

6. Neni 163 parashikon shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues të listës dhe në pikat 2 dhe 3 ka këtë përmbajtje: "2. *Kandidatët e listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes rirenditen në bazë të numrit më të lartë të votave parapëlqyese për secilin kandidat. Kur numri i votave është i barabartë, renditja përcaktohet me short. Rirenditja sipas kësaj pike përdoret në zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi. Në rastet kur nga rirenditja nuk rezulton që duke filluar nga kreu i kësaj liste një në çdo tre emra i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, atëherë kandidati i tretë në këtë listë dhe në vijim një në çdo tre emra të saj i përket gjinisë më pak të përfaqësuar sipas numrit të votave që këto të fundit kanë marrë. Mbi bazën e këtij kriteri hartohet lista përfundimtare që i nënshtrohet votimit parapëlqyes e renditur, e cila përdoret për zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi. 3. Mandatet për kandidatët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidatëve në të dhe, në rast shterimi të saj, vijohet me kandidatët fitues të rirenditur të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes sipas pikës 2 të këtij neni.".*

7. Në datën 29.08.2024 partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar" (*kërkuesja*) i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e pikës 1, shkronjat "a" dhe "b" dhe fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar. Kjo kërkesë, pasi është plotësuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.08.2024. Në vijim, në datën

16.09.2024 kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Me vendimin e datës 30.09.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike, kurse Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 02.10.2024 ka vendosur shqyrtimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të dispozitave të kundërshtuara në seancë plenare publike dhe pranimin e kërkesës për përshpejtim.[1]

8. Gjithashtu, në datën 16.09.2024 organizata "Shqipëria bëhet" i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e pikave 1 deri në 5 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Me vendimin e datës 30.09.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 02.10.2024, ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë plenare publike dhe bashkimin me çështjen e paraqitur më herët nga partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar" në një të vetme.

9. Po kështu, në datën 09.10.2024 partia "Nisma Thurje" i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e nenit 67 të Kodit Zgjedhor, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.10.2024. Me vendimin e datës 28.10.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Me vendimin e kësaj date, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur bashkimin e çështjeve të paraqitura nga të tria subjektet e lartpërmendura në një të vetme.

10. Në datën 29.10.2024 është regjistruar edhe kërkesa me kërkues Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Bakiu, Gëzim Ademaj dhe partitë "Aleanca Demokracia e Re", "Lëvizja Demokratike për Ndryshim", "Kombëtare Konservatore Albania", "Bashkimi Demokristian Shqiptar" dhe "Ora e Shqipërisë" (5 parti dhe 4 individë/deputetë), me objekt shfuqizimin e pikave 1, shkronjat "a" dhe "b", 2, shprehjes "në listën shumemërore me renditje të fiksuar" në pikat 5 dhe 6 të nenit 67, si dhe pikat 2 dhe 3, të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, pezullimin e zbatimit të tyre, si dhe interpretimin përfundimtar të nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimin e tij. Me vendimin e datës 05.11.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 06.11.2024 ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare publike,

[1] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 dhe fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, si dhe për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e gjykimit të çështjes.

bashkimin e kësaj kërkese me tri çështjet e paraqitura më parë, si dhe shqyrtimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të dispozitave të kundërshtuara në seancë plenare publike.[2]

11. Për sa i takon objektit të këtij gjykimi kushtetues, në kushtet që kërkesat e paraqitura nga: *partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar"* për shfuqizimin e pikës 1, shkronja "a" dhe "b" dhe fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar; *organizata "Shqipëria bëhet"* për shfuqizimin e pikave 1 deri në 5 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor; *partia "Nisma Thurje"* për shfuqizimin e neneve 67 dhe 163, pika 1, të Kodit Zgjedhor, por në përmbajtje të kërkesës pretendimet lidhen edhe me nenin 163; *deputetët Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Bakiu, Gëzim Ademaj dhe partitë "Aleanca Demokracia e Re", "Lëvizja Demokratike për Ndryshim", "Kombëtare Konservatore Albania", "Bashkimi Demokristian Shqiptar" dhe "Ora e Shqipërisë"* për shfuqizimin e pikave 1, shkronjat "a" dhe "b", 2, shprehjeve në pikat 5 dhe 6 të nenit 67, pikat 2 dhe 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si dhe interpretimin përfundimtar të nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimin e tij, janë bashkuar në një çështje të vetme, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se objekt i kontrollit kushtetues do të jetë: "*Shfuqizimi i neneve 67 dhe 163, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar me nenet 5 dhe 9 të ligjit nr. 81/2024, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i zbatimit të neneve 67 dhe 163 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar me nenet 5 dhe 9 të ligjit nr. 81/2024. Interpretimi përfundimtar i nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimi i tij.*".

## II
## Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesit****, partitë politike dhe individët,* në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar:

*A. Për pezullimin e zbatimit të neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor:*

12.1. Pezullimi mbron interesat individualë të shtetasve në raport me të drejtën e tyre për të zgjedhur, interesat shoqërorë, si dhe interesin e shtetit për krijimin e institucioneve

[2] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 dhe fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 67 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me nenin 5 të ligjit nr. 81/2024".

demokratike. Ky nen sjell dy pasoja: *së pari*, për partitë politike të cilat në fushatën e ardhshme zgjedhore do të ndërtojnë strategjitë e tyre dhe, *së dyti*, për zgjedhësit të cilët kanë pritshmëri për "listat e hapura". Mospezullimi i normës ligjore do të krijojë pritshmëri të caktuara nga kandidatët potencialë, marrëdhënie të kushtëzuara ndërmjet tyre dhe votuesve, si dhe ndërmjet tyre dhe partive politike. Kërkesa për kundërshtimin e ligjit është depozituar përpara shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, për të shmangur cenimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve dhe siguruar zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me Kushtetutën.

*B. Për themelin e çështjes*:

*Kërkueset, partitë politike,* në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar, si vijon:

*B.1. Nenet 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor cenojnë*:

12.2. *Parimin e shtetit të së drejtës* në dy drejtime. *Së pari*, dispozita është miratuar me procedurë të përshpejtuar brenda 8 ditëve në kundërshtim me nenin 83, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës dhe në shkelje të parashikimeve ligjore të nenit 28 të Rregullores së Kuvendit. Nuk rezulton që nga seanca plenare e Kuvendit të jetë marrë një vendim lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar, duke përcaktuar datën e mbledhjes së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, kohën për paraqitjen e amendamenteve dhe datën e shqyrtimit në seancë plenare. Amendamentet e paraqitura në seancën e komisionit në të vërtetë përbëjnë një nismë të re ligjore, pasi propozimi fillestar dhe relacioni shoqërues përmbanin vetëm rregullimin e votimit për shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit, por jo ndryshimin e dispozitave ligjore që rregullojnë listat shumemërore të kandidatëve, shtrirjen e votës parapëlqyese dhe mënyrën e shpërndarjes së mandateve. *Së dyti*, pika 2 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor bie në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës, e cila ka parashikuar se votimi parapëlqyes i garantohet jo më pak se dy të tretave të listës shumemërore. Rrumbullakosja e numrit pjesor në këtë dispozitë cenon këtë parashikim kushtetues.

12.3. *Parimin e barazisë përpara ligjit (barazisë midis kandidatëve)*, pasi pika 1 e nenit 67

të Kodit Zgjedhor krijon detyrimin e partive politike për të depozituar dy lista shumemërore, me renditje të fiksuar dhe atë me kandidatët që i nënshtrohen votimit parapëlqyes, duke sjellë si pasojë zbatimin e detyrueshëm të nenit 163. Sipas pikës 3 të këtij neni, mandatet shpërndahen sipas listës së parë dhe në rast shterimi vijohet me listën e dytë. Në këtë mënyrë partive u hiqet mundësia të konkurrojnë vetëm me listën që i nënshtrohet votës parapëlqyese. Sipas këtyre dy dispozitave krijohen dy kategori, kandidatë të listave të fiksuara, të cilët kanë mundësinë të zgjidhen deputetë dhe kandidatë të listave të hapura, të cilët edhe pse mund të marrin votë parapëlqyese individuale mund të mos jenë deputetë, sepse mandatin e tyre ligji ia jep ndonjërit prej kandidatëve të listës së fiksuar. Në këtë mënyrë privilegjohen padrejtësisht kandidatët e listave të fiksuara, ndërsa penalizohen në ekstrem kandidatët e listave të hapura, duke pasur pabarazi në mundësinë për t'u zgjedhur. Diferencimi në trajtim që krijohet midis këtyre dy kategorive nuk është objektivisht i justifikuar, pra nuk ndjek një qëllim të ligjshëm dhe nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit. Një tjetër diferencim shfaqet edhe midis kandidateve gra dhe kandidatëve burra, brenda "listës së fiksuar", të cilët duhet të jenë në raportin dy të tretat për kategorinë e dytë. Edhe ky diskriminim nuk përmbush ndonjë qëllim legjitim.

12.4. *Parimin e zgjedhjeve të barabarta (barazisë së partive politike)*, pasi sistemi i parashikuar në këtë dispozitë krijon formalisht barazi në zgjedhje vetëm për 2 parti, por ai u mohon me ligj partive të tjera mundësinë teorike që ndonjë kandidat i listës së hapur të tyre të marrë mandat deputeti. Ky sistem ligjor funksionon me numër të kufizuar partish politike, si i tillë, bie ndesh me parimin e pluralizmit politik dhe të barazisë në zgjedhje. Në këtë mënyrë mekanizmi i listës së votës parapëlqyese të çdo partie tjetër nuk mund të vendoset në funksionim efektiv në asnjë rast teorik. Partitë e treta penalizohen nga mosshpërndarja e mandateve te lista e kandidatëve me votë parapëlqyese, por edhe nga mospërdorimi i të gjithë mekanizimit të listës së hapur, ndërsa dy partitë kryesore gëzojnë mbështetje financiare ose mediatike. Edhe për sa i përket pabarazisë midis partive politike kufizimi i këtij parimi nuk ka një qëllim të

ligjshëm dhe është joproporcional. Detyrimi i partive politike që përveç listës së kandidatëve me votë parapëlqyese të depozitojnë edhe listën e fiksuar, që passjell edhe shpërndarjen e mandateve fillimisht te këta të fundit, krijon pabarazi midis partive, pasi vetëm partitë e mëdha që kanë mundësi për të fituar më shumë se një të tretën e mandateve do të mund të përfitojnë nga shpërndarja e mandateve për kandidatët e listës së hapur. Kështu krijohet një garë e pabarabartë për partitë e vogla, të cilat nuk mund të përdorin efektivisht mekanizmin e votës parapëlqyese.

12.5. *Të drejtën e votës (të drejtën për të zgjedhur) të lidhur me parimin e proporcionalitetit*, pasi kufizimet e vendosura ndaj kësaj të drejte nuk plotësojnë kushtet e vendosura në nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk janë vendosur për një qëllim të ligjshëm, për sa kohë nuk ka pasur nevojë për të rritur rolin ndikues të partive politike dhe kufizuar votën parapëlqyese. Po kështu, nuk përmbushet as kriteri i proporcionalitetit, pasi e drejta për të zgjedhur me votë parapëlqyese asgjësohet totalisht; vota parapëlqyese nuk shtrihet në një të tretën e listës së kandidatëve, një kandidat i listës së hapur sado vota parapëlqyese të marrë, nuk do të arrinte të merrte me zëvendësim mandatin e kandidatit të fundit në listën e fiksuar. Parashikimi ligjor i kundërshtuar cenon të drejtën për të zgjedhur më tepër se sa "herësi" i shfuqizuar më parë nga Gjykata, duke mohuar tërësisht votën parapëlqyese. Gjithashtu, nuk përmbushet kriteri i proporcionalitetit *stricto sensu*, pasi sistemi aktual do të prodhojë një numër më të madh mandatesh të fituara nga "lista e fiksuar" dhe një numër më të vogël nga vota parapëlqyese, duke kufizuar të drejtën për t'u zgjedhur. Neni 67 i ndërlidhur me nenin 163 të Kodit Zgjedhor kufizon në mënyrë joproporcionale këtë të drejtë, pasi nëse nuk do të parashikohej lidhëza "dhe" në nenin 67, pika 1, partitë politike do të kishin mundësi të zgjidhnin mes konkurrimit me dy lista ose vetëm me listën që i nënshtrohet votës parapëlqyese, e cila përfshin të gjithë kandidatët e kërkuar nga ligji dhe shpërndarja e mandateve do të bëhej vetëm bazuar në këtë listë. Ligji u ka mohuar votuesve të drejtën për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë në zgjedhjen e kandidatëve nga lista e fiksuar, duke krijuar pabarazi midis ndikimit të votave të

hedhura për kategori të ndryshme kandidatësh.

12.6. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi e drejta e votës parapëlqyese për të gjithë listën e kandidatëve, e parashikuar në nenin 64 të Kushtetutës, është ushtruar në zgjedhjet e mëparshme. Rikthimi i listave të fiksuara përbën kufizimin me ligj të një të drejte të fituar dhe të ushtruar nga zgjedhësit. Në rastin objekt shqyrtimi nuk kemi një shkak publik me të cilin ligjvënësi të ketë deklaruar se cili ka qenë qëllimi ose objektivi i tij apo shkaku për ndryshimin regresiv të një dispozite ligjore, duke cenuar një të drejtë të fituar. Paqartësia në shpërndarjen e mandateve midis dy listave krijon pasiguri si për kandidatët garues në zgjedhje, ashtu edhe për votuesit, duke cenuar edhe parimin e shtetit të së drejtës.

*Kërkuesja, organizata "Shqipëria bëhet"*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se nenet 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor cenojnë:

12.7. *Të drejtën për të zgjedhur të lidhur me parimin e proporcionalitetit,* pasi mekanizmi i parashikuar në këtë nen e ka kthyer votën parapëlqyese një të drejtë iluzore, duke pamundësuar *de facto* konkurrueshmërinë dhe paracaktuar kandidatët fitues. Për shumicën e partive numri i kandidatëve që i përkasin "listës së fiksuar" është në shumicën e zonave zgjedhore më i madh se numri i mandateve të fituara. Ky parashikim bie në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 64, pika 3, të Kushtetutës, i cili parashikon se votimi parapëlqyes duhet të jetë jo më pak se për dy të tretat e listës shumemërore, si dhe me nenin 17 të Kushtetutës. Mbyllja e listës së kandidatëve duhet të ishte parashikuar si një mundësi dhe jo si një detyrim. Edhe pika 2 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor cenon nenin 64, pika 3, të Kushtetutës, pasi përllogaritja e numrit të mandateve të "listës së fiksuar" në varësi të presjes dhjetore më të vogël ose më të madhe se 0,5 shkon në favor të kësaj liste dhe jo të votës parapëlqyese.

12.8. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi ky nen vendos në kushte të pabarabarta subjektet zgjedhore mes njëra-tjetrës, duke cenuar mundësinë objektive të kandidatëve në partitë e vogla për të përmbushur kushtet e nenit 64, pika 3, të Kushtetutës. Ndarja në dy kategori brenda një liste i heq mundësinë kandidatëve të vlerësohen me votë nga

qytetarët.

*Kërkuesit, individët,* kanë parashtruar se cenohet:

12.9. *E drejta e votës e lidhur me parimet e barazisë përpara ligjit dhe sigurisë juridike*, pasi Kuvendi ka shkelur detyrimin kushtetues për garantimin e votimit parapëlqyes për dy të tretat e listës shumemërore. Pika 2 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor, që parashikon detyrimin për paraqitjen e dy listave, me renditje të fiksuar dhe atë që i nënshtrohet votimit parapëlqyes, nënkupton praktikisht që për kandidatët në listën e fiksuar nuk do të bëhet asnjë votim, ndërsa për ata të listës së votimit parapëlqyes do të duhet të bëhet votim. Kjo mënyrë ligjëron diskriminimin midis kandidatëve të dy listave. Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur bëhet iluzor në kushtet kur për kandidatët në listën e fiksuar zgjedhësi nuk ka asnjë mundësi ndikimi real në zgjedhjen e tyre, duke e shndërruar këtë në votë pa peshë të njëjtë me atë të listës tjetër, e parë kjo e ndërlidhur me nenet 162 dhe 163 të këtij kodi. Ky sistem nuk garanton krijimin e një sistemi demokratik efektiv qeverisjeje, por konsiderohet një kthim mbrapa në standardet demokratike që lidhen me sistemin zgjedhor dhe përfaqësimin gjinor. Dispozitat e kundërshtuara nuk garantojnë pluralizmin politik, sepse pamundësojnë garën e partive të vogla dhe kandidatëve të pavarur. Nga analiza aritmetike e shpërndarjes së mandateve, bazuar në të dhënat e zgjedhjeve të fundit, ky sistem do të ishte funksional vetëm për pjesëmarrjen e jo më shumë se 3 partive.

12.10. Po në këtë drejtim, kufizimi në lirinë e vullnetit politik si pasojë e ekzistencës së dy listave, pamundësisë së kandidatëve të pavarur, përparësisë në ndarjen e mandateve për kandidatët e listës së fiksuar është joproporcional dhe jo i nevojshëm për një shoqëri demokratike si dhe cenon thelbin e së drejtës së votës. Ky kufizim nuk justifikohet me nevojat e interesit të përgjithshëm. Ligjvënësi ka mundësi të tjera të cilat nuk cenojnë në thelb të drejtën e votës, si, për shembull, parashikimi i një liste të vetme shumemërore. Shfuqizimi i dispozitave të kundërshtuara duhet të bëhet edhe për shkak të shkeljeve të rënda të Rregullores së Kuvendit gjatë procesit të miratimit të tyre. Sipas këtyre parashikimeve ligjore do të zhbëhet në thelb mundësia që çdo

votues të shikonte që vota e tij do të ndikonte në përbërjen e pushtetit qendror.

*Pesë partitë: "Aleanca Demokracia e Re", "Lëvizja Demokratike për Ndryshim", "Kombëtare Konservatore Albania", "Bashkimi Demokristian Shqiptar", "Ora e Shqipërisë" dhe individët kanë pretenduar, gjithashtu:*

*B.2. Interpretimin e nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimin e tij*

12.11. Formulimi i nenit 64 të Kushtetutës, i ndërvarur me nenet 67, 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, nuk lejon pjesëmarrje efektive dhe të barabartë në zgjedhjen e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, duke cenuar parimet e parashikuara në nenet 1, 2, 4 dhe 9 të Kushtetutës (garantimi i sistemit të zgjedhjeve të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike; ushtrimi i sovranitetit të popullit; parimi i shtetit të së drejtës dhe krijimi i lirë dhe në përputhje me parimet demokratike të partive politike), si dhe nenin 17 (parimi i proporcionalitetit), nenin 45 (e drejta e votës) dhe nenin 22 të Kushtetutës (liria e shprehjes). Gjykata mund të refuzojë zbatimin e nenit 64 të Kushtetutës, pasi ai bie ndesh me normat e tjera më të rëndësishme dhe parimet kushtetuese kur përjashton ose nuk lejon kandidimin efektiv dhe të barabartë të kandidatëve nga zgjedhësit në raport me kandidatët e caktuar nga partitë politike ose koalicionet. Në pamundësi të një interpretimi pajtues përfundimtar të këtij neni me parimet themelore, Gjykata duhet të shfuqizojë ose konstatojë papajtueshmërinë e këtij neni me këto parime.

13. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** në mënyrë të përmbledhur, në prapësimet e tij ka parashtruar si vijon:

*A. Për juridiksionin e Gjykatës*

13.1. Gjykata nuk ka juridiksion për shfuqizimin e nenit 64 të Kushtetutës, pasi, bazuar në nenin 131 të saj, ajo nuk mund të vendosë për kushtetutshmërinë e normave të Kushtetutës. Edhe për sa i përket interpretimit të këtij neni, Gjykata këtë kompetencë e ushtron vetëm duke zgjidhur një çështje konkrete, pasi kompetenca e saj interpretuese nuk nënkupton formulimin e interpretimeve abstrakte të normës. Në rastin konkret, nuk ka asnjë konflikt kompetencash mes organeve kushtetuese.

*B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të dispozitave të kundërshtuara*

13.2. Pretendimet e ngritura për pezullimin e dispozitave janë të pabazuara, pasi nuk plotësohen kriteret e nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000 për sa u përket "pasojave të rënda dhe të pariparueshme" që mund të vijnë nga zbatimi i tyre. Kërkuesit nuk kanë analizuar pasojën e rëndë që do të vinte nga zbatimi i dispozitave, duke u mbështetur në pretendime hipotetike, për sa kohë dispozitat nuk kanë dhënë asnjë efekt për ta. Nisur nga fakti se Presidenti i Republikës dekreton zgjedhjet në periudhën 15 prill – 15 maj, neni 67 i Kodit Zgjedhor do të kishte efekt për periudhën 23 shkurt – 25 mars 2025, pra pas vendimmarrjes së Gjykatës për çështjen konkrete.

*C. Për legjitimimin e partive dhe katër individëve/deputetëve*

13.3. Kërkuesja, *partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar"*, nuk legjitimohet në kërkimin e saj për anën procedurale të miratimit të ligjit me procedurë të përshpejtuar, pasi vetëm subjektet e pakushtëzuara mund të ngrenë pretendime të tilla, ndërsa ajo rezulton të jetë subjekt i kushtëzuar. Kërkuesit (pesë parti politike dhe katër deputetë) nuk legjitimohen në kërkimet e tyre për interpretimin e nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimin e tij. Katër deputetët nuk legjitimohen, pasi nuk kanë provuar se janë viktima të një shkeljeje dhe preken nga kufizimi i pretenduar i Kodit Zgjedhor. Ata janë kërkues me statusin e deputetit dhe jo të një subjekti zgjedhor në zgjedhjet për vitin 2025, për pasojë nuk cenohen nga dispozitat e kundërshtuara. Për më tepër, marrëdhënia e deputetëve me Gjykatën është në një raport specifik ku ata paraqiten si subjekt i pakushtëzuar, dhe, për rrjedhojë, deputeti nuk mund të paraqesë kërkesë në cilësi individuale.

*Ç. Për themelin e kërkesës*

13.4. Pretendimi *për miratimin e ligjit me procedurë të përshpejtuar* është i pabazuar, pasi nisma ligjore e datës 18.07.2024 është paraqitur nga 17 deputetë dhe sipas projektligjit ajo përmbante vetëm propozimin për ndryshimin e dispozitave ligjore që lidheshin me votimin nga jashtë vendit, por jo me dispozitat objekt gjykimi kushtetues. Procesi i konsultimeve për ndryshimet në Kodin Zgjedhor ka nisur që në datën 10.02.2022, për

të vijuar në datën 15.03.2024 me ngritjen e grupit të dialogut në Komisionin e Ligjeve. Përpara nismës së këtij grupi janë depozituar disa nisma të tjera për ndryshime në datat 24.04.2024, 01.07.2024, 08.07.2024 dhe 18.07.2024. Në rastin konkret nuk është zbatuar procedura e përshpejtuar, pasi Kuvendi nuk ka shqyrtuar nismën specifike të datës 18.07.2024, por atë të depozituar në datën 08.07.2024. Për rrjedhojë, procedura e ndjekur është në përputhje me nenet 81, pikat 1 dhe 2 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Ajo nuk përbën një nismë të re, por të njëjtën nismë, e cila ka pësuar ndryshime përgjatë shqyrtimit të saj sipas nenit 71 të Rregullores së Kuvendit dhe ajo nuk është shqyrtuar nga komisioni, pasi amendamentet reflektonin edhe qëllimin e vetë nismës. Propozimi i datës 18.07.2024 është trajtuar si amendim/propozim për ndryshime të nismës së depozituar më herët dhe është shqyrtuar si i tillë.

13.5. Pretendimi i parashtruar nga të gjithë kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi neni 64 i Kushtetutës ka përcaktuar kufirin minimal të listës që i nënshtrohet votimit parapëlqyes dhe nuk mund të pretendohet që e gjithë lista t'i nënshtrohet këtij votimi. Për më tepër, vetë Gjykata është shprehur se votimi me lista të mbyllura nuk përbën cenim të parimit të barazisë së votës, për rrjedhojë pretendimet e kërkuesve në këtë drejtim nuk mund të merren në shqyrtim nga ajo.

13.6. Pretendimi për cenimin e së *drejtës së votës* nuk është i bazuar, pasi Kuvendi ka zbatuar nenin 64 të Kushtetutës dhe lista e kandidatëve që një subjekt zgjedhor paraqet në një zonë zgjedhore plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Për sa kohë kushtetutëbërësi ka përcaktuar shprehjen "jo më pak se" për votimin parapëlqyes, është në diskrecion të ligjvënësit për të bërë një rregullim ligjor në Kodin Zgjedhor për sa i përket listës së kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes dhe tashmë pa mekanizmin e herësit. Në thelb, argumentet e kërkuesve paraqiten në drejtim të antikushtetutshmërisë së nenit 64, pika 3, të Kushtetutës, pretendim i cili nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata. Për sa i përket rastit kur nga pjesëtimi nuk rezulton një numër i plotë mandatesh, këto janë rregullime që vijnë si rezultat i rregullave matematikore, një qëndrim i pranuar edhe nga Gjykata në jurisprudencën e saj. Ky parashikim nuk është antikushtetues, pasi

ndarja e zonave zgjedhore nuk sjell një barazi strikte. Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi se neni 64 i Kushtetutës parashikon vetëm një listë, ndërkohë neni 67 i Kodit Zgjedhor dy lista, pasi Kushtetuta ka përcaktuar se rregullimet specifike të sistemit zgjedhor bëhen me ligjin për zgjedhjet.

13.7. Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi Kodi Zgjedhor nuk sjell risi për kandidatët e përzgjedhur nga partitë politike, për sa kohë mundësia e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit rregullohet nga nenet 69 dhe 162 të Kodit Zgjedhor, të cilat nuk kanë pësuar ndryshime. Kërkuesit nuk e kanë argumentuar pretendimin e tyre se sistemi zgjedhor ka pësuar regres, por e lidhin vetëm me faktin se jo të gjithë deputetët do t'i nënshtrohen votimit parapëlqyes.

## III
## Procesi në gjykimin kushtetues

*A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të dispozitave të kundërshtuara*

14. Kërkuesja, partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", ka pretenduar se pezullimi i nenit 67 të Kodit Zgjedhor mbron interesat individualë të shtetasve në raport me të drejtën e tyre për të zgjedhur, interesat shoqërorë, si dhe interesin e shtetit për krijimin e institucioneve demokratike. Sipas saj, ky nen sjell dy pasoja: së pari, për partitë politike, të cilat në fushatën e ardhshme zgjedhore do të ndërtojnë strategjitë e tyre dhe, së dyti, për zgjedhësit, të cilët kanë pritshmëri për "listat e hapura". Mospezullimi i normës ligjore do të krijojë pritshmëri të caktuara nga kandidatët potencialë, marrëdhënie të kushtëzuara ndërmjet tyre dhe votuesve, si dhe ndërmjet tyre dhe partive politike. Kërkesa për kundërshtimin e ligjit është depozituar përpara shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, për të shmangur cenimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve dhe siguruar zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me Kushtetutën.

15. Ndërsa kërkuesit Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Bakiu, Gëzim Ademaj dhe partitë "Aleanca Demokracia e Re", "Lëvizja Demokratike për Ndryshim", "Kombëtare

Konservatore Albania", "Bashkimi Demokristian Shqiptar" dhe "Ora e Shqipërisë", përveç pezullimit të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, kanë kërkuar edhe pezullimin e nenit 163 të këtij kodi.

16. Në seancën plenare të datës 04.12.2024 kërkuesja, partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", hoqi dorë nga kërkesa për pezullimin e dispozitës, me argumentin se në kushtet kur gjykimi po shqyrtohet nga Gjykata, nevoja për marrjen e një mase pezullimi nuk është më ajo që ishte në momentin e kërkimit të saj. Ndërsa kërkuesit e tjerë kërkuan që kërkesa për pezullimin të merret në shqyrtim dhe të pranohet.

17. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se pretendimet e ngritura për pezullimin e dispozitave janë të pabazuara, pasi nuk përmbushen kriteret e nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, për sa u përket "pasojave të rënda dhe të pariparueshme" që mund të vijnë nga zbatimi i tyre. Sipas tij, kërkuesit nuk kanë analizuar pasojën e rëndë që do të vinte nga zbatimi i dispozitave, por janë mbështetur në pretendime hipotetike, për sa kohë dispozitat nuk kanë dhënë ende asnjë efekt për ta (kërkuesit). Po kështu, nisur nga fakti se Presidenti i Republikës dekreton zgjedhjet në periudhën 15 prill – 15 maj, duke qenë se periudha zgjedhore zgjat 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve, neni 67 i Kodit Zgjedhor do të kishte efekt për periudhën 23 shkurt – 25 mars 2025, pra tashmë pas vendimmarrjes së Gjykatës për çështjen konkrete.

18. Sipas nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e tij. Sipas kësaj dispozite, *së pari*, subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë prekjen e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sjellë zbatimi i aktit; *së dyti*, shqyrtimi i kërkesës mund të bëhet nga Gjykata përpara ose në seancë plenare.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj, në lidhje me rastet kur është urdhëruar pezullimi i zbatimit të ligjit (*shih vendimet nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 24, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*), ka pranuar se në kushtet kur pezullimi është një masë e jashtëzakonshme, marrja e kësaj mase lidhet me vlerësimin e pasojave ose efekteve të zbatimit të ligjit/aktit. Këto pasoja jo vetëm duhet të jenë reale, pra në realizim e sipër, por edhe të rënda, në

atë masë që shkojnë tej masës normale të kufizimit, në veçanti në pikëpamje të urgjencës (*shih vendimin nr. 30, datë 05.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se dy kërkesat përmbajnë në objektin e tyre pezullimin e zbatimit të neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, të cilat parashikojnë mënyrën e regjistrimit të kandidatëve në zgjedhje nga partitë politike, konkretisht detyrimin që u lind atyre për depozitimin e listave të kandidatëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (*KQZ*), jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve, si dhe shpërndarjen e mandateve për çdo kandidat. Ndërkohë, referuar nenit 9, pika 4, të këtij kodi, Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 9 muaj përpara mbarimit të mandatit të Kuvendit.

21. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata, pasi dëgjoi pretendimet e kërkuesve dhe prapësimet e subjektit të interesuar në seancën plenare të datës 04.12.2024, vlerëson se nuk ekzistojnë shkaqet e parashikuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577/2000 për pezullimin e zbatimit të dispozitave të kundërshtuara. Ajo çmon se në drejtim të pariparueshmërisë së pasojave në të drejtat kushtetuese ose interesat e ligjshëm, ashtu edhe të urgjencës së ndërhyrjes, kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë pasojat e rënda dhe reale të ardhura nga zbatimi i ligjit objekt kërkese, për sa kohë që dispozitat në lidhje me procesin zgjedhor ende nuk kanë filluar të zbatohen. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim si të pabazuar.

## IV

## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*B. Për juridiksionin e Gjykatës*

22. Gjykata vëren se kërkuesit e kanë vënë në lëvizje atë për dy kërkime: (a) kushtetutshmërinë e neneve 67 dhe 163, pikat 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor; (b) interpretimin përfundimtar të nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimin e tij.

23. Gjykata vëren se, për sa i takon kërkimit të parë, kërkuesit kanë parashtruar se dispozitat e Kodit Zgjedhor bien ndesh me disa të drejta e parime kushtetuese, ndër të tjera, edhe me përmbajtjen e nenit 64 të Kushtetutës. Ndërsa për kërkimin e dytë kërkuesit (pesë parti politike dhe katër deputetë) kanë pretenduar: (i) interpretimin përfundimtar të nenit 64 të Kushtetutës me

parimet themelore kushtetuese të parashikuara në nenet 1, 3, 4 dhe 5 të saj lidhur me garantimin e pluralizmit politik, të ushtrimit të sovranitetit të popullit, të një sistemi zgjedhjesh të lira dhe të barabarta, si dhe barazisë së të drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur, për sa i përket kandidimit dhe mundësisë së zgjedhjes së kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit; ose nëse interpretimi përfundimtar i nenit 64 nuk mund të bëhet pa cenuar pozitën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese (ii) shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me parimet themelore kushtetuese të Kushtetutës.

24. Në lidhje me kërkimin e parë, për kushtetutshmërinë e neneve 67 dhe 163, pikat 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor, subjekti i interesuar nuk ka paraqitur prapësime, ndërsa për kërkimin e dytë ka prapësuar se Gjykata nuk ka juridiksion për shfuqizimin e nenit 64 të Kushtetutës, pasi bazuar në nenin 131 të saj, ajo nuk mund të vendosë për kushtetutshmërinë e normave të Kushtetutës. Edhe për sa i përket interpretimit të këtij neni, sipas Kuvendit, Gjykata këtë kompetencë e ushtron vetëm duke zgjidhur një çështje konkrete, pasi kompetenca e saj interpretuese nuk nënkupton formulimin e interpretimeve abstrakte të normës. Në rastin konkret nuk ka asnjë konflikt kompetencash mes organeve kushtetuese.

25. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit: "*1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.*". Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes. Në këtë kuptim, koncepti "mosmarrëveshje kushtetuese" në nenin 124 të Kushtetutës e merr përmbajtjen e tij dhe përfshin çështjet kushtetuese që janë të parashikuara jo vetëm nga neni 131 i Kushtetutës, por edhe nga çdo dispozitë tjetër kushtetuese, mbi bazën e të cilave Gjykata ushtron kompetencat e saj (*shih vendimet nr. 48, datë 19.06.2024; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është funksioni më i rëndësishëm i Gjykatës, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e

parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim. Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por synon t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre *(shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim, nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës që parashikon se Gjykata vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, përpara saj është shtruar një mosmarrëveshje kushtetuese që ka të bëjë me kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, kërkimi i parë i kërkuesve bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

28. Për sa i përket kërkimit të dytë, atij të interpretimit përfundimtar të nenit 64 të Kushtetutës, në referim të standardeve të jurisprudencës së Gjykatës, interpretimi i dispozitave të Kushtetutës nuk përbën *per se* mosmarrëveshje kushtetuese. Gjithsesi, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar në thelb se nenet 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor bien ndesh me nenin 64 të Kushtetutës. Thënë kjo, mosmarrëveshja kushtetuese konkrete, sikurse u theksua në paragrafin e mësipërm, ka të bëjë pikërisht me vlerësimin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së këtyre dy dispozitave ligjore në raport me parashikimet kushtetuese. Nisur nga kjo, për sa kohë Gjykata do të shprehet për kushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara të Kodit Zgjedhor, e cila nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të nenit 64 të Kushtetutës, pikërisht në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes kushtetuese, ajo (Gjykata) do të interpretojë edhe këtë normë kushtetuese. Për rrjedhojë, ky interpretim i nenit 64 të Kushtetutës do të analizohet i ndërlidhur me themelin e pretendimeve të kërkuesve.[3]

29. Për sa i takon alternativës së kërkimit të dytë, asaj për shfuqizimin e nenit 64 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se një kërkim i tillë nuk mund të merret në shqyrtim, pasi del jashtë

---

[3] Gjyqtarja Sonila Bejtja vlerësoi se, në parim, Gjykata ka juridiksion për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, si një kompetencë e veçantë e saj. Megjithatë, në kushtet kur ky kërkim është ngritur nga subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre, ai duhej të rrëzohej nga Gjykata.

juridiksionit kushtetues të parashikuar në nenin 131 të Kushtetutës, për sa kohë Gjykata nuk kontrollon kushtetutshmërinë e vetë normave kushtetuese, por vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta në rast të shqyrtimit të një ligji rishikues të saj. Në këto kushte, përderisa Gjykata nuk ndodhet përpara këtij rasti, ky kërkim nuk hyn në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

*C. Për legjitimimin e kërkuesve*

30. Çështja e legjitimimit të kërkuesve *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Kushtetuta në nenin 134, pika 1, të saj ka përcaktuar rrethin e subjekteve kushtetuese që legjitimohen për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, duke specifikuar në pikën 2 të këtij neni subjektet të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

31. Gjykata vëren se bazuar në nenin 134, pika 1, shkronjat "gj", "h" dhe "i", të Kushtetutës, si dhe nenin 49, pika 3, shkronjat "d" dhe "e", të ligjit nr. 8577/2000, të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën për pajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe partitë politike, organizatat dhe individët. Nisur nga fakti se ajo është vënë në lëvizje nga 12 subjekte, nga të cilat 7 parti politike, 1 organizatë dhe 4 individë (deputetë), të cilët kanë ngritur pretendime për cenimin e së drejtës së votës si në aspektin e së drejtës për t'u zgjedhur, ashtu edhe për të zgjedhur, në vijim Gjykata do të analizojë kriteret e legjitimimit veçmas për secilën kategori të subjekteve.

*B.1. Për legjitimimin e partive politike*

32. Për sa i përket legjitimimit të partive politike, bazuar në nenin 134, pikat 1, shkronja "gj" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pikat 3, shkronja "d" dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, ato mund t'i drejtohen Gjykatës atëherë kur kundërshtojnë dispozitat e akteve normative, të cilat cenojnë statusin e tyre kushtetues dhe bashkë me të edhe pjesëmarrjen në ushtrimin e vullnetit shtetëror. Partia politike legjitimohet në kërkimet e saj nëse bëhet fjalë për respektimin nga ana e një organi kushtetues të statusit të saj që rrjedh nga Kushtetuta, gjatë procesit zgjedhor, pra për

akte përmbajtja e të cilave sjell pasoja negative për veprimtarinë e saj kushtetuese në kuadër të formimit të vullnetit politik (*shih vendimet nr. 28, datë 09.05.2012; nr.15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata vëren se kërkueset, partitë politike, janë regjistruar sipas ligjit në gjykatë dhe në përputhje me statutet dhe aktet e themelimit, kryetarët e tyre kanë autorizuar përfaqësuesit ligjorë për t'iu drejtuar Gjykatës me kërkesën objekt të gjykimit kushtetues. Po kështu, dispozitat e kundërshtuara të Kodit Zgjedhor rregullojnë mënyrën e regjistrimit të kandidatëve në zgjedhje nga partitë politike, pjesën e listave që i nënshtrohet votimit parapëlqyes, efektin e këtij të fundit në rezultatin e zgjedhjeve, kategorizimin e kandidatëve, si dhe shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues. Për këtë shkak, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e saj se neni 45 i Kushtetutës ka sanksionuar të drejtën e votës, e cila përbëhet nga dy komponentë, e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur (*shih vendimet nr. 28, datë 30.06.2021; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe nisur nga pretendimi thelbësor i kërkueseve se dispozitat e kundërshtuara të Kodit Zgjedhor bien ndesh me detyrimin kushtetues për garantimin e votimit parapëlqyes për dy të tretat e listës shumemërore, vlerëson se ato (dispozitat e kundërshtuara) prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë e partive politike, në kuptim të së drejtës për t'u zgjedhur, duke ndikuar në këtë mënyrë në pjesëmarrjen e tyre në formimin e vullnetit politik. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se 7 partitë politike legjitimohen *ratione personae* si në aspektin formal, ashtu edhe substancial, pasi provojnë interesin për çështjen kushtetuese të ngritur prej tyre, në kuptim të nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

34. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis,* sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Ligji nr. 81/2024 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132, datë 26.07.2024 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të saj (11.08.2024), ndërsa kërkesat në Gjykatë janë paraqitur në datat 29.08.2024 (partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar"), 09.10.2024 (partia "Nisma Thurje") dhe 29.10.2024 pesë partitë e tjera ("Aleanca Demokracia e Re", "Lëvizja Demokratike për Ndryshim", "Kombëtare Konservatore Albania", "Bashkimi

Demokristian Shqiptar" dhe "Ora e Shqipërisë"). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ato legjitimohen edhe *ratione temporis*.

35. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkueset (partitë politike) kanë pretenduar se nenet 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor cenojnë parimet e shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit midis kandidatëve dhe midis partive, të drejtën e votës (të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur) të lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe parimin e sigurisë juridike. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, kërkuesja, partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", ka ngritur dy shkaqe: *së pari,* dispozita e kundërshtuar është miratuar me procedurë të përshpejtuar në kundërshtim me nenin 83 të Kushtetutës dhe, *së dyti*, ajo është në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës, i cili garanton votimin parapëlqyes.

36. Në lidhje me pretendimin për miratimin e dispozitave me procedurë të përshpejtuar, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se partia "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar" nuk legjitimohet në kërkimin e saj për anën procedurale të miratimit të ligjit, pasi nuk është subjekt që gëzon legjitimitet të pakushtëzuar për vënien në lëvizje të Gjykatës.

37. Për sa i përket shkakut të parë, sipas të cilit dispozitat e kundërshtuara janë miratuar me procedurë të përshpejtuar, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

38. Kështu, sipas njërit qëndrim u vlerësua se subjektet e kushtëzuara legjitimohen për të kundërshtuar procedurën për miratimin e ligjit vetëm nëse dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë ndonjë të drejtë themelore të garantuar nga Kushtetuta.[4] Sipas qëndrimit tjetër u vlerësua se Gjykata vlerëson edhe pretendimet me natyrë procedurale, pra procedurën për miratimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 8577/2000, pavarësisht cenimit të ndonjë të drejte kushtetuese.[5] Ndërsa sipas qëndrimit të tretë, u vlerësua se pretendimet me natyrë procedurale të ngritura nga subjektet e kushtëzuara nuk mund

[4] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marjana Semini.
[5] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja.

t'i nënshtrohen juridiksionit kushtetues.[6] Në këtë situatë të ndarjes së votave, pretendimi për cenimin e shtetit të së drejtës për këtë shkak konsiderohet i rrëzuar, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

39. Ndërsa për sa i përket shkakut të dytë, sipas të cilit dispozita e kundërshtuar vjen në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se, në thelb, ai lidhet me pretendimin kryesor për cenimin e së drejtës së votës, e cila sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin 33 të vendimit*) në rastin e subjekteve (partive politike) do të analizohet në drejtim të së drejtës për t'u zgjedhur.

40. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuesit kanë argumentuar, ndër të tjera, se sipas neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor krijohen dy kategori: kandidatët e listës së fiksuara, të cilët kanë mundësinë të zgjidhen deputetë dhe kandidatët e listës së hapur, të cilët edhe pse mund të marrin votë parapëlqyese individuale, mund të mos jenë deputetë, sepse shpërndarja e mandateve fillon nga kandidatët në listën e fiksuar, duke privilegjuar padrejtësisht në këtë mënyrë kandidatët e listave të fiksuara. Gjykata vëren se në zbatim të nenit 68 të Kushtetutës, sipas të cilit kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike, neni 67 i Kodit Zgjedhor parashikon se kandidatët në listën shumemërore përcaktohen nga partia politike. Kjo do të thotë se të gjithë kandidatët e listës shumemërore në të dy komponentët e saj (me renditje të fiksuar dhe ajo që i nënshtrohet votimit parapëlqyes) përcaktohen nga partitë politike. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se, në thelb, subjekti që konkurron në zgjedhjet parlamentare është partia politike, e cila përcakton në listën shumemërore kandidatët e saj, përfshirë edhe ata që do t'i nënshtrohen votimit parapëlqyes, të cilët që të gjithë janë kandidatë të partisë politike. Prandaj pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit ndërmjet kandidatëve nga parashikimi i lidhëzës "dhe" në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të lidhur me nenin 163 të tij, që përcakton mënyrën e shpërndarjes së mandateve, nuk mbështetet në argumente kushtetuese, për sa kohë që kandidatët në listën shumemërore janë kandidatë të partisë politike, ndërsa është kjo e fundit ajo që konkurron si subjekt zgjedhor. Pra hartimi i të dy komponentëve të listës shumemërore është e drejtë e secilës parti politike dhe i

[6] Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Ilir Toska e Genti Ibrahimi.

takon asaj të caktojë emrin e secilit kandidat në komponentin përkatës të listës shumemërore. Prandaj nisur nga kjo, kërkueset nuk kanë parashtruar argumente se si ky parashikim ligjor i cenon ato në të drejtën për t'u zgjedhur dhe, për rrjedhojë partitë politike nuk legjitimohen *ratione materiae* në lidhje me këtë pretendim. Ndërsa për pretendimet e kërkueseve për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit midis vetë partive, ato legjitimohen *ratione materiae* dhe do të analizohen në vijim.

41. Nisur nga sa më lart, si dhe bazuar në argumentet e kërkueseve (partitë politike), Gjykata do të analizojë pretendimet për antikushtetutshmërinë e neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor në drejtim të së drejtës për t'u zgjedhur të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit.

*B.2. Për legjitimimin e organizatës*

42. Ndërsa në lidhje me legjitimimin e organizatave, Gjykata është shprehur se sipas neneve 131, pika 1, shkronja "c" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja "d", të ligjit nr. 8577/2000, ato kanë të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën për pajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare dhe si subjekte të kushtëzuara duhet të justifikojnë interesin e tyre për çështjen e parashtruar.

43. Vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Subjekti i kushtëzuar që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së tij dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorikë për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 3, datë 30.01.2024; nr. 37, datë 01.12.2022; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

44. Për sa i përket kërkueses, organizatës "Shqipëria bëhet", Gjykata vëren se ajo është regjistruar si shoqatë në regjistrin e organizatave jofitimprurëse sipas vendimit nr. 7173, datë 06.09.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në drejtim të legjitimimit formal ajo i është drejtuar Gjykatës nëpërmjet kërkesës së nënshkruar nga drejtori ekzekutiv i saj, i cili, sipas nenit 17 të statutit, kujdeset për interesat e shoqatës, i mbron ato, si dhe përfaqëson shoqatën në marrëdhënie me të tretë. Sipas përmbajtjes së nenit 7 të statutit, shoqata ka si qëllim, ndër të tjera, të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, të iniciojë dhe marrë pjesë në gjykime në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe Gjykatën që lidhen me të drejtat e njeriut, proceset zgjedhore, votën e lirë dhe të barabartë, modelin e sistemit zgjedhor që aplikohet në Republikën e Shqipërisë, referendumet, të drejtën e votës së emigrantëve shqiptarë jashtë vendit etj. Anëtarë themelues të saj janë 5 shtetas shqiptarë me banim në shtetin shqiptar.

45. Duke iu referuar përmbajtjes së kërkesës, Gjykata evidenton se organizata ka ngritur dy pretendime kryesore, për sa i përket kontrollit të pajtueshmërisë së pikave 1 deri në 5 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor: *së pari*, cenimin e së drejtës për të zgjedhur të lidhur me parimin e proporcionalitetit, pasi mekanizmi i parashikuar në këtë nen e ka kthyer votën parapëlqyese një të drejtë iluzore, duke pamundësuar *de facto* konkurrueshmërinë dhe paracaktuar kandidatët fitues, në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës; *së dyti*, cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi ky nen vendos në kushte të pabarabarta subjektet zgjedhore mes njëra-tjetrës, duke cenuar mundësinë objektive të kandidatëve në partitë e vogla për të përmbushur kushtet e nenit 64, pika 3, të Kushtetutës.

46. Në lidhje me pretendimin e parë për cenimin e së drejtës së votës, Gjykata vëren se anëtarët e shoqatës janë shtetas shqiptarë që mbartin të drejtën e votës, çka, për më tepër, përputhet me një nga qëllimet e shoqatës. Për këtë shkak, Gjykata, nisur nga pretendimi thelbësor i organizatës se dispozitat e kundërshtuara bien ndesh me detyrimin kushtetues për garantimin e votimit parapëlqyes për dy të tretat e listës shumemërore, si dhe duke mbajtur në konsideratë komponentët e së drejtës së votës (*shih paragrafin 33 të vendimit*), vlerëson se ekziston lidhja e domosdoshme midis qëllimit të veprimtarisë së kërkueses dhe normës së kundërshtuar, por edhe se dispozitat janë drejtpërdrejt të zbatueshme edhe ndaj anëtarëve të saj, në drejtim të së drejtës

për të zgjedhur, prandaj ajo legjitimohet *ratione personae* në paraqitjen e kërkesës përpara Gjykatës.[7] Ky vlerësim i Gjykatës mban në konsideratë qëndrimin e shprehur më herët prej saj në vitin 2022, në të cilin ajo bazuar në nenin 46 dhe 134 pika 2 të Kushtetutës ka pranuar se organizatat legjitimohen *ratione personae* për të mbrojtur të drejtën kushtetuese për të votuar, duke mbajtur në konsideratë qëllimin e veprimtarisë, anëtarësinë e tyre dhe natyrën e pretendimeve, edhe nëse organizatat nuk janë regjistruar në gjykatat shqiptare. Sipas Gjykatës, një interpretim i kundërt, do të binte ndesh me vetë frymën e Kushtetutës, e cila mbron lirinë e organizimit për qëllime të ligjshme, si dhe njeh të drejtën e aksesit në gjykimin kushtetues të organizatave që provojnë se çështja lidhet me interesat e tyre (*shih vendimin nr. 38 datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Për sa i përket pretendimit të dytë, cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit, pasi neni 67 i Kodit Zgjedhor vendos në kushte të pabarabarta subjektet zgjedhore mes njëra-tjetrës, Gjykata vëren se organizata nuk bën pjesë në rrethin e subjekteve zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje, prandaj ajo nuk ka arritur të parashtrojë asnjë argument për të provuar interesin e saj të drejtpërdrejtë dhe pasojat negative të ardhura ose të pritshme që i vijnë asaj nga zbatimi i nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Ky nen u drejtohet partive politike për sa i përket detyrimit të tyre për depozitimin e listave të kandidatëve, pasi ato regjistrohen si subjekte zgjedhore në KQZ, ndërkohë që kërkuesja nuk rezulton t'i gëzojë këto cilësi. Prandaj ajo nuk legjitimohet *ratione personae* për këtë pretendim.

48. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis,* Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur në datën 16.09.2024, pra brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 81/2024, pra ajo e përmbush edhe këtë kriter të legjitimimit.

49. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim pretendimin kryesor të kërkueses – organizatës, që lidhet me cenimin e së drejtës kushtetuese për të zgjedhur.

[7] Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Sonila Bejtja e Genti Ibrahimi votuan kundër legjitimimit *ratione personae* të kërkueses, organizata "Shqipëria bëhet", pasi nuk u arrit të provohej nga subjekti kërkues (shoqata) se në ç'mënyrë anëtarëve të saj iu është cenuar kjo e drejtë e pretenduar nga dispozitat e kundërshtuara, të cilat ende nuk ishin testuar në procesin zgjedhor.

*B.3. Për legjitimimin e individëve*

50. Ndërsa në lidhje me individin që i drejtohet Gjykatës për kontrollin e ligjeve ose akteve normative, Gjykata ka pranuar se ai legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur *(shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

51. Për qëllime të legjitimimit të kërkuesve si individë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, në rastin e pretendimeve për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, ata duhet të provojnë se janë viktima të shkeljes dhe se zbatimi i dispozitave të ligjit të kundërshtuar cenon interesat e tyre, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale. Ankime *in abstracto* për shkelje të pretenduara të KEDNJ-së nuk janë lejuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*). Megjithatë, në situata të veçanta ajo ka pranuar se individi mund të jetë një viktimë potenciale. Në këtë rast ai duhet të paraqesë prova të arsyeshme dhe bindëse të faktit se shkelja që do të prekë atë personalisht do të ndodhë, pasi thjesht mundësia që ajo të ndodhë nuk është e mjaftueshme (*shih vendimin e GJEDNJ-së për pranueshmërinë në çështjen Senator Lines GmbH kundër 15 shteteve anëtarë të Bashkimit Evropian, 10.03. 2004*).

52. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se kërkuesit, katër deputetë, nuk legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi nuk kanë provuar se janë viktima të një shkeljeje dhe

preken nga kufizimi i pretenduar i Kodit Zgjedhor. Ata janë kërkues me statusin e deputetit dhe jo të një subjekti zgjedhor në zgjedhjet për vitin 2025, për pasojë nuk cenohen nga dispozitat e kundërshtuara. Për më tepër, marrëdhënia e deputetëve me Gjykatën është në një raport specifik, si subjekt i pakushtëzuar dhe ata nuk mund të paraqesin kërkesë në cilësi individuale.

53. Në rastin në shqyrtim, sikurse u përmend më lart (*shih paragrafin 4 të vendimit*), Gjykata vëren se dispozitat objekt kundërshtimi parashikojnë mënyrën e paraqitjes së listave të kandidatëve të partive ose koalicioneve të partive politike, pas regjistrimit të tyre në KQZ, si subjekte zgjedhore dhe përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve për kandidatët fitues në zgjedhje. Kërkuesit kanë paraqitur kërkesë së bashku me partitë politike (*shih paragrafin 10 të vendimit*) dhe kanë parashtruar pretendime të njëjta me to, duke pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese të votës të lidhur me parimet e barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike. Në kushtet kur kërkuesit janë shtetas të cilët gëzojnë të drejtën për të zgjedhur (dhe ajo nuk i është kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë), në kuptim të nenit 45 të Kushtetutës, Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të saj, si edhe nenet 71 dhe 49, pika 3, shkronja "e", të ligjit nr. 8577/2000, çmon se vetëm për këtë të drejtë (për të zgjedhur) ata legjitimohen *ratione personae* si individë dhe jo në cilësinë e deputetit.[8] Në këtë kuptim, prapësimi i subjektit të interesuar, Kuvendit, se kërkuesit si deputetë nuk mund t'i drejtohen Gjykatës, nuk është i bazuar. Ndërsa për sa u takon pretendimeve për të drejtën për t'u zgjedhur, kërkuesit nuk kanë arritur të parashtrojnë asnjë argument për të provuar interesin e tyre të drejtpërdrejtë dhe pasojat negative të ardhura ose të pritshme që u vijnë atyre nga zbatimi i neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, prandaj nuk legjitimohen në këtë drejtim.

54. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata vëren se individi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së

[8] Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Sonila Bejtja e Genti Ibrahimi votuan kundër legjitimimit *ratione personae* të kërkuesve Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Bakiu dhe Gëzim Ademaj, pasi ata nuk arritën të provonin përpara Gjykatës, se në ç'mënyrë atyre iu është cenuar kjo e drejtë e pretenduar nga dispozitat e kundërshtuara, të cilat ende nuk ishin testuar në procesin zgjedhor.

pari, t'i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike efektive ose ato janë joefektive).

55. Në rastin konkret, nenet 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tyre, por janë drejtpërdrejt të zbatueshme në momentin e zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme. Pra, këto dispozita nuk parashikojnë zhvillimin e procedurave të tjera të mundshme dhe efektive, të cilat mund të shfrytëzohen nga individët përpara se t'i drejtohen Gjykatës. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesit Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Bakiu dhe Gëzim Ademaj nuk kanë mjete të tjera efektive në dispozicion përveç paraqitjes të kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave objekt kundërshtimi, ndaj ata e kanë përmbushur edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

56. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis,* bazuar në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit duhet të paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastin në shqyrtim ligji i kundërshtuar ka hyrë në fuqi në datën 10.08.2024, ndërsa kërkesa në Gjykatë është paraqitur në datën 29.10.2024, prandaj për sa kohë kërkesa është paraqitur brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, Gjykata nuk do të ndalet të verifikojë momentin e konstatimit të cenimit dhe vlerëson se kërkuesit – 4 individë legjitimohen edhe *ratione temporis*.

57. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, të kërkuesve individë, Gjykata vlerëson të analizojë pretendimin kryesor të tyre që lidhet me cenimin e së drejtës kushtetuese për të zgjedhur të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit.

*C. Për themelin e pretendimeve*

*C.1. Për cenimin e së drejtës së votës (së drejtës për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur) të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit*

*C.1.1. Për partitë politike në lidhje me të drejtën për t'u zgjedhur*

58. Kërkueset, *partitë politike*, kanë pretenduar se pika 1 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor krijon detyrimin e partive politike për të depozituar dy lista shumemërore, me renditje të fiksuar dhe atë me kandidatët që i nënshtrohen votimit parapëlqyes, duke sjellë si pasojë zbatimin e detyrueshëm të nenit 163 të këtij kodi. Sipas pikës 3 të këtij neni, mandatet shpërndahen sipas listës së parë dhe në rast shterimi vijohet me listën e dytë. Në këtë mënyrë partive u hiqet mundësia të konkurrojnë vetëm me listën që i nënshtrohet votës parapëlqyese. Nisur nga kjo, sipas kërkueseve, sistemi i parashikuar në këtë dispozitë krijon formalisht barazi në zgjedhje vetëm për 2 parti dhe iu mohon me ligj partive të tjera mundësinë reale që ndonjë kandidat i listës së hapur të tyre të marrë mandat deputeti. Ky sistem ligjor funksionon me numër të kufizuar partish politike dhe, si i tillë, bie ndesh me parimin e pluralizmit politik dhe të barazisë në zgjedhje. Në këtë mënyrë, mekanizmi i listës së votës parapëlqyese të çdo partie tjetër nuk mund të bëhet efektiv në asnjë rast praktik. Partitë e treta penalizohen nga mosshpërndarja e mandateve te lista e kandidatëve me votë parapëlqyese, por edhe nga mospërdorimi i të gjithë mekanizimit të listës së hapur, ndërsa dy partitë kryesore gëzojnë mbështetje financiare ose mediatike. Pabarazia midis partive politike nuk ka një qëllim të ligjshëm dhe është joproporcionale, ndonëse ajo përbën një të drejtë të fituar. Detyrimi i partive politike që përveç listës së kandidatëve me votë parapëlqyese, të depozitojnë edhe listën e fiksuar, e cila passjell edhe shpërndarjen e mandateve fillimisht te këta të fundit, krijon pabarazi midis partive, pasi vetëm partitë e mëdha që kanë mundësi për të fituar më shumë se një të tretën e mandateve do të mund të përfitojnë nga shpërndarja e mandateve për kandidatët e listës së hapur. Kështu krijohet një garë e pabarabartë për partitë e vogla, të cilat nuk mund të përdorin efektivisht mekanizmin e votës parapëlqyese. Parashikimi ligjor i kundërshtuar cenon të drejtën për të zgjedhur më tepër se sa "herësi" i shfuqizuar më parë nga Gjykata, duke mohuar tërësisht votën parapëlqyese. Gjithashtu, nuk përmbushet kriteri i proporcionalitetit *stricto sensu*, pasi sistemi aktual do të prodhojë një numër më të madh mandatesh të fituara nga "lista e fiksuar" dhe një numër më të vogël nga vota parapëlqyese, duke kufizuar të drejtën për t'u zgjedhur. Edhe rrumbullakosja e numrit pjesor në këtë dispozitë cenon parashikimet kushtetuese.

59. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se pretendimet për cenimin e së *drejtës së*

*votës të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit* nuk janë të bazuara, pasi Kuvendi ka zbatuar nenin 64 të Kushtetutës dhe lista e kandidatëve që një subjekt zgjedhor paraqet në një zonë zgjedhore plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Për sa kohë kushtetutëbërësi ka përcaktuar shprehjen "jo më pak se" për votimin parapëlqyes, është në diskrecion të ligjvënësit për të bërë një rregullim ligjor në Kodin Zgjedhor për sa i përket listës së kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes dhe tashmë pa mekanizmin e herësit. Në thelb, argumentet e kërkuesve paraqiten në drejtim të antikushtetutshmërisë së nenit 64, paragrafi 3, të Kushtetutës, pretendim i cili nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata. Kjo dispozitë përcakton kufirin minimal të listës që i nënshtrohet votimit parapëlqyes dhe nuk mund të pretendohet që e gjithë lista t'i nënshtrohet këtij votimi. Për më tepër, vetë Gjykata është shprehur se votimi në lista të mbyllura nuk përbën cenim të parimit të barazisë së votës, për rrjedhojë pretendimet e kërkuesve në këtë drejtim nuk mund të merren në shqyrtim. Për sa i përket rastit kur nga pjesëtimi nuk rezulton një numër i plotë mandatesh, këto janë rregullime që vijnë si rezultat i rregullave matematikore, një qëndrim i pranuar edhe nga vetë Gjykata. Pretendimi se ekziston pamundësia e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit është i pabazuar, pasi kjo e fundit rregullohet nga nenet 69 dhe 162 të Kodit Zgjedhor të cilat nuk kanë pësuar ndryshime. Kodi Zgjedhor nuk sjell risi për kandidatët e përzgjedhur nga partitë politike. Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi se neni 64 i Kushtetutës parashikon vetëm një listë, ndërkohë neni 67 i Kodit Zgjedhor dy lista, pasi Kushtetuta ka përcaktuar se rregullimet specifike të sistemit zgjedhor bëhen me ligjin për zgjedhjet.

60. Në mendimin me shkrim Avokati i Popullit është shprehur se zbatimi i nenit 67, pika 2, të Kodit Zgjedhor duhet të respektojë kriterin kushtetues të garantimit të votës parapëlqyese për "jo më pak se dy të tretat" në të gjitha qarqet. Po kështu, sipas tij, nëse qëllimi i lidhëzës "dhe" është për të kufizuar pjesëmarrjen e partive politike, kjo passjell kufizim joproporcional të vendosur me ligj. Sipas këtij mendimi, nëse me ligj cenohet substancialisht vota e barabartë, cenohet edhe parimi i barazisë përpara ligjit, pasi vota është një e drejtë themelore substanciale. Parashikimi i nenit 67 të Kodit Zgjedhor në dukje krijon pabarazi ndërmjet kandidatëve të dy listave. Gjithashtu, mosrespektimi i *parimit të sigurisë juridike* në realizimin e një procesi zgjedhor sjell konfuzion dhe paqartësi për të gjitha palët. Po sipas Avokatit të Popullit, kufizimi i së drejtës

së votës nuk duhet të jetë arbitrar ose joproporcional.

61. Neni 45, pika 1, i Kushtetutës ka parashikuar se çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Parimi i barazisë së votës, që përfshin komponentin e tij aktiv (e drejta për të votuar) dhe atë pasiv (e drejta për t'u votuar/zgjedhur), ndalon diskriminimin ose privilegjimin nga shteti të kandidatëve të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në garën për të tërhequr votën e zgjedhësit. Barazia në zgjedhje përfshin shumë aspekte dhe parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë barazia në votën numerike, në fuqinë zgjedhore dhe në mundësi dhe kjo e fundit kërkon që midis partive të krijohen shanse të barabarta dhe shteti të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë (*shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 28, datë 09.05.2012; nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Gjykata ka pohuar se konkurrimi i lirë është shprehje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të një shoqërie demokratike dhe bazohet edhe në faktin që për të gjitha subjektet të zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara më parë. Këto rregulla bazohen në parimin e mosdiskriminimit, të mostrajtimit preferencial, por edhe të dhënies së mundësive të njëjta në konkurrimin politik. Çdo kufizim në barazinë e palëve në konkurrimin elektoral nuk mund të arrijë deri aty sa të bëjë të pamundur edhe vetë pjesëmarrjen e tyre në konkurrim (*shih vendimet nr. 31, datë 04.10.2021; nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 28, datë 09.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

63. Duke iu referuar praktikës së GJEDNJ-së për nenin 1 të Protokollit nr.3 të KEDNJ-së, evidentohet se shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi për organizimin e sistemeve të tyre zgjedhore, veçanërisht për sa i përket aspektit pasiv (së drejtës për t'u zgjedhur) (*shih Etxeberria dhe të tjerë kundër Spanjës, 2009, § 50; Davydov dhe të tjerë kundër Rusisë, 2017, § 286*). Edhe Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, i miratuar nga Komisioni i Venecias, parashikon se partive duhet t'u garantohen shanse të barabarta (pika 2) (*shih përmbledhjen e opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias për sistemet zgjedhore, datë 18.03.2019).*

64. Bazuar në standardet e mësipërme dhe nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkueseve, Gjykata do të analizojë në vijim kushtetutshmërinë e parashikimit të lidhëzës "dhe" në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të ndërlidhur me nenin 163 të këtij kodi, nëse bie ndesh me të drejtën

për t'u zgjedhur të parashikuar në nenet 45 dhe 64 të Kushtetutës të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i saj. Gjithashtu, ajo do të analizojë nëse vendosja e presjes dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor bie ndesh me parashikimin e nenit 64 të Kushtetutës.

*a. Për parashikimin e lidhëzës "dhe" në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të lidhur me nenin 163 të tij*

65. Nisur nga thelbi i pretendimit kryesor të kërkueseve (partive politike) se nenet 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor bien ndesh me nenin 64 të Kushtetutës, Gjykata, fillimisht, çmon të ndalet në interpretimin e nenit 64 të Kushtetutës, pasi sikurse u përmend edhe më lart (*shih paragrafin 28),* analiza e kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të dispozitës kushtetuese.

66. Gjykata vëren se Kushtetuta në nenin 64, pika 3, të saj, ndër të tjera, ka parashikuar se kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet (*fjalia e dytë*). Gjithashtu, ajo përcakton detyrimin që ligji për zgjedhjet të garantojë që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurohet përfaqësimi gjinor (*fjalia e tretë*).

67. Nga interpretimi literal i pikës 3 të nenit 64 të Kushtetutës, Gjykata vëren se kushtetutëbërësi, në fjalinë e dytë të kësaj pike, i ka deleguar ligjvënësit, ndër të tjera, edhe përcaktimin e kritereve dhe rregullave për shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes. Ndërsa në fjalinë e tretë të saj ka garantuar në nivel kushtetues se votimit parapëlqyes i nënshtrohen dy të tretat e listës shumemërore. Pra, këto dy fjali të pikës 3 të nenit 64 të Kushtetutës bëjnë dallimin midis këtyre proceseve të veçanta pjesë të procesit zgjedhor në tërësi, atij të *"votimit"*, përfshirë edhe atë *"parapëlqyes"*, sikundër edhe atij të *"shpërndarjes së mandateve"*, përfshirë edhe të *"masës së shtrirjes së votimit parapëlqyes"* në këtë proces (shpërndarjen e mandateve). Me fjalë të tjera, neni 64 i Kushtetutës ka parashikuar se për sa i përket votimit të zgjedhësve, "votimit parapëlqyes" të tyre i nënshtrohen dy të tretat e listës

shumemërore, duke garantuar kështu në nivel kushtetues vetëm të drejtën e zgjedhësve për të shprehur, përmes votimit, preferencën e tyre për jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore. Ndërkohë kjo normë kushtetuese nuk e ka parashikuar të njëjtën garanci për sa i përket "shpërndarjes së mandateve", e cila në aspektin praktik nënkupton përcaktimin e kandidatëve fitues nga lista shumemërore, duke u bazuar në rezultatin e votimit për mandatet e fituara nga subjekti zgjedhor përkatës, kriteret dhe rregullat për disiplinimin e të cilit, kushtetutëbërësi ia ka deleguar ligjbërësit, si shprehje e hapësirës së gjerë të vlerësimit që shteti ka në përcaktimin e rregullave që lidhen me rezultatet e votimit. Në këtë kuptim, këto rregulla janë lënë në diskrecion të ligjvënësit, i cili i ka përcaktuar dhe detajuar në Kodin Zgjedhor.

68. Për të arritur në këtë përfundim, Gjykata mori në konsideratë edhe fjalinë e parë të pikës 3 të nenit 64 të Kushtetutës, sipas së cilës zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kjo fjali edhe pse nuk u drejtohet drejtpërdrejt partive politike, por zgjedhësve, shërben për të theksuar se edhe në këtë rast togfjalëshi *"për të dhënë votë parapëlqyese"* nënkupton se në nivel kushtetues është garantuar vetëm e drejta për të ushtruar votën parapëlqyese dhe jo shkalla e ndikimit në shpërndarjen e mandateve, çka qartësisht i është deleguar ligjvënësit.

69. Nën dritën e këtij interpretimi, Gjykata çmon se neni 64 i Kushtetutës garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, pra të drejtën e zgjedhësve për të dhënë votë parapëlqyese për jo më pak se dy të tretat e kandidatëve, ndërsa shpërndarja e mandateve dhe masa e shtrirjes së votimit parapëlqyes në këtë proces, pra shkalla e ndikimit të votimit parapëlqyes në shpërndarjen e mandateve nuk garantohet nga dispozitat kushtetuese, por është lënë në diskrecion të ligjvënësit nëpërmjet delegimit. Kuptimi i kësaj norme kushtetuese rezulton qartë nga interpretimi literal i saj, duke mos qenë në këtë rast përpara një formulimi të papërcaktuar të normës apo të tillë që të lejojë hapësira të caktuara interpretimi.

70. Bazuar në këtë interpretim, si dhe nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkueseve, Gjykata do të analizojë në vijim nëse parashikimi i lidhëzës *"dhe"* në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit *"partia politike ose koalicioni zgjedhor ... që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ për çdo zonë zgjedhore, ... listën që*

*përbëhet nga: a) lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe b) lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqye"* të lexuar së bashku me nenin 163 të tij, sipas të cilit *"mandatet për kandidatët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidatëve në të dhe, në rast shterimi të saj, vijohet me kandidatët fitues të rirenditur të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes"* bie ndesh me nenin 64 të Kushtetutës dhe nëse midis partive krijohet pabarazi në atë masë sa të bëjë të pamundur pjesëmarrjen e tyre në konkurrim.

71. Gjykata vëren se në kuptim të delegimit të nenit 64 të Kushtetutës, ligjvënësi ka parashikuar në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor detyrimin e subjekteve zgjedhore për të depozituar në KQZ për çdo zonë zgjedhore listën shumemërore. Ligjvënësi në titullin e tij, por edhe në përmbajtjen e paragrafit të parë të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, ka përdorur shprehjen "lista", duke nënkuptuar se bëhet fjalë për një listë të vetme, e cila përbëhet në vetvete nga dy komponentë, pjesa e listës me renditje të fiksuar të kandidatëve dhe pjesa tjetër me kandidatët që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Përdorimi i lidhëzës "dhe" nënkupton se partitë politike si subjekte zgjedhore kanë detyrimin të përmbushin kërkesat që disiplinojnë procesin zgjedhor, ndër të tjera, atë për të paraqitur listën shumemërore me dy komponentë (atë me renditje të fiksuar dhe atë që i nënshtrohet votimit parapëlqyes) që do t'i nënshtrohet procesit të votimit.

72. Nga ana tjetër, sikurse u përmend më sipër (*shih paragrafin 40 të vendimit*), Gjykata vlerëson se të gjithë kandidatët e listës shumemërore në të dy komponentët e saj (me renditje të fiksuar dhe ajo që i nënshtrohet votimit parapëlqyes), përcaktohen nga partitë politike. Në këtë kuptim, në thelb ajo që konkurron është partia politike, pavarësisht se votimit përveç partisë i nënshtrohen edhe kandidatët e saj në të dy komponentët e listës shumemërore. Partitë politike, ashtu sikurse ka theksuar Gjykata në jurisprudencën e saj, luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin demokratik pluralist, pasi kontribuojnë në shfaqjen dhe përfaqësimin e vullnetit politik të popullit përmes pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ndihmojnë në realizimin e sovranitetit të tij *(shih vendimet nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 11, datë 13.03.2015; nr. 1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*.

73. Për sa më lart, lidhur me pretendimin e kërkueseve – partive politike se ligjvënësi ka

shkelur detyrimin kushtetues për garantimin e votimit parapëlqyes për dy të tretat e listës shumemërore, të garantuar nga neni 64 i Kushtetutës, për shkak të lidhëzës *"dhe"* në përmbajtje të nenit 67, pika 1, të Kodit Zgjedhor, Gjykata evidenton se ndonëse këto subjekte kanë detyrimin për të paraqitur listën shumemërore të përbërë nga dy komponentë, vendosja e kandidatëve nga ana e partisë në komponentin me renditje të fiksuar ose në atë që i nënshtrohet votimit parapëlqyes nuk cenon në thelb të drejtën për t'u zgjedhur të kërkueseve dhe as pjesëmarrjen e tyre në procesin e formimit të vullnetit politik. Sikurse u theksua më sipër, neni 64 i Kushtetutës garanton në nivel kushtetues votimin parapëlqyes për jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, por jo shkallën e ndikimit të tij në shpërndarjen e mandateve. Gjithashtu, duke qenë se të gjithë kandidatët në të dy komponentët e listës shumemërore përcaktohen nga vetë partia, Gjykata vlerëson se dispozitat e kundërshtuara nuk bien ndesh me nenin 64 të Kushtetutës.

74. Po në këtë kuptim, edhe pretendimi tjetër për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit ndërmjet partive politike (atyre të vogla/të reja ndaj atyre të mëdha/të vjetra) nuk është i bazuar, pasi parashikimet ligjore të neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk kanë përcaktuar kritere, të cilat konsiderohen kufizuese për partitë e reja ose ato me elektorat më të vogël se partitë e tjera, por ato u nënshtrohen të njëjtave rregullave për kandidim të lidhur me përcaktimin e numrit të kandidatëve që paraqesin në KQZ.

75. Për sa më lart, por nisur edhe nga fakti se pretendimet e kërkueseve janë të bazuara në rezultatin e zgjedhjeve të përgjithshme të kaluara, çka passjell se ato janë hipotetike dhe jo të vërtetuara në praktikë, për sa kohë ato ndikohen nga një sërë faktorësh, Gjykata vlerëson se janë të pabazuara.

*b. Për parashikimin e presjes dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor*

76. Gjykata vëren se pika 2 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor, ndër të tjera, ka parashikuar se numri i përgjithshëm i kandidatëve në komponentin e listës me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjesëtuar për tre. Kur nga ky pjesëtim nuk rezulton numër i plotë mandatesh, atëherë në rast se presja dhjetore si pasojë e pjesëtimit është e barabartë ose më e madhe se 0,5, lista përmbyllet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e

pjesëtimit rezulton presja dhjetore më e vogël se 0,5, lista shumemërore me renditje të fiksuar e kandidatëve mbyllet me numrin e plotë pararendës.

77. Për sa i përket pretendimit të kërkueseve – *partive politike*, se edhe parashikimi i presjes dhjetore ka shkelur detyrimin kushtetues për garantimin e votimit parapëlqyes për dy të tretat e listës shumemërore, të garantuar nga neni 64 i Kushtetutës, Gjykata, nisur nga fakti se kjo dispozitë kushtetuese garanton të drejtën e zgjedhësve për të shprehur, përmes votimit, preferencën e tyre për jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, por jo shkallën e ndikimit në shpërndarjen e mandateve ose, thënë ndryshe, në rezultatin e tij (*shih paragrafin 67 të vendimit*), vlerëson se kërkueset pretendimet e tyre i lidhin në fakt me shpërndarjen e mandateve sipas rezultatit të votimit, gjë që Kushtetuta ia ka deleguar ligjvënësit. Për më tepër, Gjykata çmon se numri i kandidatëve të komponentit të listës që i nënshtrohet votimit parapëlqyes është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, çka tejkalon parashikimin kushtetues prej dy të tretave të kandidatëve që marrin pjesë në votim. Në këtë kuptim, kjo përllogaritje nuk cenon standartin kushtetues të "jo më pak se dy të tretat e numrin e kandidatëve të listës shumemërore" që i nënshtrohet votimit parapëlqyes, duke përmbushur kështu detyrimin e parashikuar në nenin 64 të Kushtetutës.

*C.1.2. Për organizatën dhe individët në lidhje me të drejtën për të zgjedhur*

78. Kërkuesja, *organizata "Shqipëria bëhet"*, ka pretenduar se neni 67 i Kodit Zgjedhor bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 64, pika 3, të Kushtetutës, i cili parashikon se votimi parapëlqyes duhet të jetë jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, si dhe të nenit 17 të Kushtetutës. Sipas kërkueses, lista e mbyllur e kandidatëve duhet të ishte parashikuar si një mundësi dhe jo si detyrim. Gjithashtu, edhe pika 2 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor cenon nenin 64, pika 3, të Kushtetutës, pasi përllogaritja e numrit të mandateve të "listës së fiksuar" në varësi të presjes dhjetore më të vogël ose më të madhe se 0,5 shkon në favor të kësaj liste dhe jo të votës parapëlqyese.

79. Kërkuesit, *individët*, kanë pretenduar se Kuvendi ka shkelur detyrimin kushtetues për garantimin e votimit parapëlqyes për dy të tretat e listës shumemërore. Detyrimi për paraqitjen e

dy listave, me renditje të fiksuar dhe atë që i nënshtrohet votimit parapëlqyes, nënkupton praktikisht që për kandidatët në listën me renditje të fiksuar nuk do të bëhet asnjë votim, ndërsa për ata të listës që i nënshtrohen votimit parapëlqyes do të duhet të bëhet votim. Sipas tyre, ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur bëhet iluzor dhe konsiderohet një kthim mbrapa. Gjithashtu, ata kanë pretenduar se ky sistem do të ishte funksional vetëm për pjesëmarrjen e jo më shumë se 3 partive dhe ekzistenca e dy listave përbën një kufizim joproporcional, i cili nuk është i nevojshëm në një shoqëri demokratike, nuk justifikon interesin e përgjithshëm dhe cenon thelbin e së drejtës së votës.

80. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj rëndësinë e së drejtës së votës si një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa dallime mbi bazë shtrese ose përkatësie në grupe të caktuara shoqërore, ose mbi baza të tjera që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike *(shih vendimet nr. 28, datë 13.07.2021; nr. 40, datë 16.11.2007; nr. 1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese).* Po kështu, Gjykata ka theksuar se e drejta e votës ushtrohet përmes një sistemi zgjedhor që u garanton shtetasve qenien e tyre politikisht aktivë, duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik *(shih vendimet nr. 40, datë 16.11.2007; nr. 1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese).*

81. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Në këtë këndvështrim, për vetë rëndësinë që merr kjo e drejtë në një shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues. E rëndësishme është që kufizimet të mos jenë të tilla që ta bëjnë joefektiv ushtrimin e kësaj të drejte ose ta cenojnë atë në thelbin e saj, pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror ua njeh shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Duke ushtruar të drejtën e votës zgjedhësve iu krijohet mundësia të ndikojnë në mënyrën dhe cilësinë e funksionimit të rendit juridik, duke e bërë shtetasin më të përgjegjshëm për rolin që ai ka në drejtimin e jetës së vendit. Ky është në fakt edhe thelbi i demokracisë *(shih vendimet nr. 28, datë 30.06.2021; nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese).*

82. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se çdo votë ka të njëjtën vlerë dhe të njëjtën mundësi ligjore suksesi dhe çdo votues duhet të ndikojë në mënyrë të barabartë në rezultatet e zgjedhjeve. Sistemi proporcional synon që të gjitha palët të përfaqësohen në përqindje që është sa më pranë numrit të votave dhe formalizimi i barazisë së votës shkon më tej, që do të thotë jo vetëm vlerë numerike e njëjtë, por edhe vlerë e njëjtë suksesi ose ndikim i njëjtë në rezultat (*shih vendimin nr. 1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

83. Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj për të drejtën e votës ka theksuar se neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përfshin parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve në ushtrimin e së drejtës së tyre për të votuar, por nuk nënkupton se të gjitha votat duhet të kenë domosdoshmërisht peshë të barabartë për sa i përket rezultatit të zgjedhjeve. Pra, asnjë sistem zgjedhor nuk mund të shmangë që disa vota "të shkojnë dëm" (*shih Partija "Jaunie Demokrāti" dhe Partija "Mūsu Zeme" kundër Letonisë, 29.11.2007*).

84. Ndërsa referuar Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, të miratuar nga Komisioni i Venecias, votimi i barabartë përfshin dy aspekte, të drejtën për votim të barabartë, sipas të cilit çdo votues ka, në parim, një votë dhe fuqia e barabartë e votës, pra mandatet duhet të ndahen në mënyrë të barabartë midis zonave zgjedhore (*shih përmbledhjen e opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias për sistemet zgjedhore, datë 18.03.2019*).

85. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata do të analizojë kushtetutshmërinë e parashikimit të lidhëzës "dhe" në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të ndërlidhur me nenin 163 të tij, pra nëse bie ndesh me të drejtën për të zgjedhur të organizatës dhe individëve, pra në kuptim të ndikimit të tyre në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike. Vetëm për kërkuesit individë Gjykata do ta shqyrtojë të drejtën për të zgjedhur të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit. Gjithashtu, do të analizohet nëse parashikimi i presjes dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor bie ndesh me nenin 64 të Kushtetutës.

*a. Për parashikimin e lidhëzës "dhe" në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të lidhur me nenin 163 të tij*

86. Gjykata, sikurse u theksua më sipër (*shih paragrafin 68 të vendimit*), vëren se e vetmja

garanci e përcaktuar edhe nga neni 64, pika 3, fjalia e parë e Kushtetutës është se zgjedhësit, në ushtrim të së drejtës për të zgjedhur, gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Pra, në nivel kushtetues edhe në lidhje me zgjedhësit është garantuar e drejta për të ushtruar votën parapëlqyese. Prandaj, duke marrë në konsideratë se lidhëza *"dhe"* nuk cenon detyrimin e nenit 64 të Kushtetutës për garantimin e së drejtës së zgjedhësve për të shprehur, përmes votimit, preferencën e tyre për jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore (*shih paragrafin 67 të vendimit*), Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve – organizata dhe individët - për cenimin e së drejtës për të zgjedhur është i pabazuar. Paraqitja në KQZ e dy komponentëve të listës shumemërore nuk kufizon të drejtën e shtetasve për të votuar, në aspektin e së drejtës për të zgjedhur, pasi ata mund ta ushtrojnë lirisht këtë të drejtë edhe për secilin nga kandidatët që ata preferojnë. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se e drejta e zgjedhësve për të shprehur opinionin e tyre nuk kufizohet nga ky parashikim ligjor, për sa kohë legjislacioni nuk ka vendosur asnjë ndalim dhe nuk ka përcaktuar kritere, të cilat duhet të përmbushen nga individët për të ushtruar të drejtën e tyre të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës.

87. Edhe për sa i përket pretendimit të individëve për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, për shkak se mënyra e paraqitjes së listës ligjëron diskriminimin midis kandidatëve në secilin komponent të listës, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesve, në thelb, lidhen me barazinë ndërmjet kandidatëve ose partive politike dhe në këtë mënyrë nuk ndikojnë në të drejtën e tyre për të zgjedhur. Bazuar në këtë premisë, Gjykata nuk konstaton cenim të parimit të barazisë përpara ligjit për individët, për sa kohë që parashikimet ligjore i drejtohen në mënyrë të njëjtë të gjithë zgjedhësve, duke garantuar mundësinë për të gjithë ata për të ushtruar të drejtën e votës pa dallime mbi bazë shtrese ose përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza, kritere apo kategori të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike.

88. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve se lidhëza *"dhe"* në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të lidhur me nenin 163 të tij cenon të drejtën për të zgjedhur të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit, është i pabazuar.

*b. Për parashikimin e presjes dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor*

89. Gjykata, sikurse evidentoi për subjektet parti politike (*shih supra paragrafin 77 të vendimit)*, konstaton se parashikimi i presjes dhjetore në përcaktimin e numrit të kandidatëve në listën shumemërore në të dy komponentët e saj, nuk cenon parashikimet e nenit 64, pika 3, fjalia e parë, i Kushtetutës, që zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Edhe në këtë rast pretendimet e kërkuesve lidhen me shpërndarjen e mandateve sipas rezultatit të votimit, çka nuk është garantuar në nivel kushtetues (*shih supra paragrafin 67 të vendimit*). Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve se parashikimi i presjes dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor cenon të drejtën për të zgjedhur, është i pabazuar.

90. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronjat "gj", "h" dhe "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

**V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 24.12.2024**

**Shpallur më 04.02.2025**

## MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga disa kërkues (shtatë parti politike, një organizatë dhe katër individë), me objekt shfuqizimin e neneve 67 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, jemi kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Me ligjin nr. 81/2024 Kuvendi ka miratuar disa ndryshime në Kodin Zgjedhor, duke riformuluar tërësisht nenet objekt kundërshtimi, të cilat kanë parashikuar mënyrën e paraqitjes së listës shumemërore nga partitë politike në KQZ dhe shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues. Kërkuesit kanë pretenduar se këto dispozita bien ndesh me nenin 64 të Kushtetutës, i cili parashikon se votimi parapëlqyes garantohet për jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, si dhe të drejtën e votës, parimin e barazisë përpara ligjit (midis kandidatëve dhe midis partive) dhe parimin e sigurisë juridike. Konkretisht, pretendimet e kërkuesve lidhen me përdorimin e lidhëzës "*dhe*", në kuptim të detyrimit të partive politike për të paraqitur listën me renditje të fiksuar dhe listën që i nënshtrohet votimit parapëlqyes në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Sipas kërkuesve, kjo dispozitë e lexuar së bashku me nenin 163 të tij, sipas të cilit mandatet për kandidatët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumemërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe, në rast shterimi të saj, vijohet me kandidatët fitues të listës shumemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes, cenojnë të drejtat dhe parimet kushtetuese. Gjithashtu, parashikimi i presjes dhjetore në mënyrën e llogaritjes së kandidatëve në listë (ata me renditje të fiksuar dhe ata që i nënshtrohen votimit parapëlqyes), të parashikuar në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, bie ndesh me nenin 64 të Kushtetutës.

3. Nuk jemi dakord me qëndrimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se dispozitat e kundërshtuara kanë krijuar iluzionin e ekzistencës së votës parapëlqyese, por jo zbatimin e saj në praktikë. Si të tilla, ato bien ndesh me nenin 64 të Kushtetutës të lidhur me nenin 45 të saj, si dhe parimet themelore të shtetit të së drejtës dhe demokracisë përfaqësuese. Lidhur me këto të fundit, duhet evidentuar se ekziston një lidhje e ngushtë midis parimit të shtetit të së drejtës,

demokracisë dhe të drejtave themelore. Është e vështirë të konceptohet demokracia dhe të drejtat themelore, të paktën në kontekstin e demokracive liberale evropiane, pa shtetin e së drejtës. Pa shtetin e së drejtës nuk ka barazi përpara ligjit ose të drejta themelore efektive. Në të njëjtën kohë, pa demokraci ose të drejta themelore do të viheshin në pikëpyetje elementet kryesore dhe objektivat e shtetit të së drejtës.[9]

4. Kushtetuta në nenin 3 të saj ka garantuar parimin themelor të pluralizmit si element thelbësor të shtetit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Pushteti i përfaqësuesve kufizohet nga kushtetuta dhe mekanizma të tjerë të balancimit dhe kontrollit të pushteteve dhe problemet e përfaqësimit të drejtë janë çështje të shanseve të barabarta që zëri i gjithkujt të dëgjohet ose të jetë i përfaqësuar. Ndërsa në nenin 1, paragrafi 3, Kushtetuta ka sanksionuar *parimin e barazisë së votës,* i cili ka komponentin e tij *aktiv* (e drejta për të votuar) dhe atë *pasiv* (e drejta për t'u votuar/zgjedhur) (*shih vendimin nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Pa mohuar rëndësinë e rolit qendror që luajnë partitë politike në sistemin zgjedhor dhe në formimin e vullnetit politik, për shkak të të cilit Kushtetuta në nenin 9 të saj i ka dedikuar atyre një parim të veçantë themelor, theksojmë se kushtetutëbërësi me ndryshimet kushtetuese të vitit 2020, duke prezantuar votimin parapëlqyes, i ka dhënë vëmendje të veçantë zgjedhësve, si një mënyrë e demokratizimit të vetë partive politike dhe të shoqërisë në tërësi. Shumica, në të kundërt me qëllimin e kushtetutëbërësit, e ka zhvendosur fokusin te partia politike, duke pohuar se të gjithë kandidatët përcaktohen nga partitë politike dhe se, në thelb, subjekti që konkurron në zgjedhjet parlamentare është partia politike (*shih paragrafin 40 të vendimit*). Edhe Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i miratuar nga Komisioni i Venecias nuk ka bërë dallim midis partisë dhe kandidatit, duke parashikuar se shanset e barabarta duhet të garantohen si për partitë, ashtu edhe

[9] M. P. Maduro, *Mutual trust, mutual recognition and the rule of law,* The XXX FIDE Congress in Sofia, 2023 Congress publications, Vol. 1, fq. 2.

për kandidatët (*shih përmbledhjen e opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias për sistemet zgjedhore, datë 18.03.2019*). Në këtë kuptim, jemi të mendimit se edhe ndarja që shumica i ka bërë së drejtës së votës, duke analizuar veçmas për secilin subjekt kërkues dy komponentët e saj, *së drejtës për t'u zgjedhur* dhe *për të zgjedhur* (*shih paragrafët 33, 46 dhe 53 të vendimit*) është artificiale dhe nuk u përgjigjet ndryshimeve kushtetuese dhe as qëndrimeve jurisprudenciale të mëparshme për trajtimin e së drejtës themelore të votës (*shih vendimet nr. 31, datë 04.10.2021; nr. 28, datë 30.06.2021; nr. 11, datë 13.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në vlerësimin tonë, parimi themelor i pluralizmit dhe rëndësia që kanë zgjedhjet për qytetarët janë dy komponentë të rëndësishëm në një shoqëri demokratike, që janë të pandarë nga njëri-tjetri dhe funksionojnë së bashku për të garantuar një shtet të së drejtës që promovon dhe mbron demokracinë dhe të drejtat themelore të qytetarëve, midis të cilave të drejtën e votës në të dy komponentët e saj. Nën këtë optikë, parashtrojmë në vijim argumentet tona për pranimin e kërkesës, që na shtyjnë në qëndrim të kundërt me shumicën.

7. *Së pari*, nuk pajtohemi me interpretimin literal që shumica i ka bërë nenit 64 të Kushtetutës, sipas të cilit ky parashikim kushtetues garanton të drejtën/mundësinë e zgjedhësve për të shprehur, përmes votimit, preferencën e tyre për jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, por jo rezultatin e tij, duke u bazuar kryesisht në fjalinë e tretë të paragrafit të dytë të këtij neni, i cili parashikon se ligji zgjedhor garanton që votimit parapëlqyes "t'i nënshtrohen" jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore (*shih paragrafin 67 të vendimit*). Në vlerësimin tonë, shumica, duke përdorur vetëm metodën e interpretimit të ngushtë gramatikor, në thelb, ka bërë një interpretim mekanik, që injoron kontekstin e zhvillimeve shoqërore dhe politike, në të cilin është miratuar norma kushtetuese, duke iu larguar qëllimit të kushtetutëbërësit. Në terma kushtetues, kuptimi që shumica i ka dhënë përmbajtjes së nenit 64 të Kushtetutës nuk ka mbajtur në konsideratë metodat e interpretimit historik, sistematik dhe teleologjik. Këto metoda interpretimi janë pranuar në jurisprudencën e Gjykatës, e cila asnjëherë nuk i ka parë të shkëputura ato ose të vendosura në rend hierarkik, duke u bazuar thjesht në interpretimin gjuhësor/gramatikor të dispozitave kushtetuese.

8. Në këtë kuptim, për sa i përket interpretimit historik, konstatohet se kushtetutëbërësi në vitin 2020 për herë të parë parashikoi votimin parapëlqyes, në ndryshim nga dispozitat e mëparshme, të cilat sanksiononin vetëm sistemin proporcional me zona zgjedhore shumemërore dhe i delegonin ligjvënësit kriteret dhe rregullat për zbatimin e tij. Ndryshimet kushtetuese u bënë për t'iu përgjigjur nevojës që shoqëria kishte për demokratizimin e sistemit zgjedhor dhe krijimin e një lidhjeje më të afërt midis qytetarit dhe të zgjedhurit, si një hap përpara në forcimin e demokracisë përfaqësuese. Ndryshimet kushtetuese u pasuan nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2020, të cilat parashikuan një mënyrë të re të shpërndarjes së mandateve, bazuar në mekanizmin e herësit, i cili nuk mund të ishte më shumë se 10,000 vota. E vënë në lëvizje nga dy parti politike, Gjykata vendosi shfuqizimin e nenit 163, pika 3, të Kodit Zgjedhor, duke vlerësuar se kushtetutëbërësi, për herë të parë, me ndryshimet e vitit 2020, ka parashikuar votën parapëlqyese duke e përcaktuar atë shprehimisht si e drejtë që gëzohet nga zgjedhësit dhe duke i dhënë kështu një kuptim të ri së drejtës themelore të zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës. Sipas Gjykatës, ndonëse në çështjet e sistemit zgjedhor ligjvënësi, si rregull, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, zbatimi i herësit në praktikë, lidhur me vlerën numerike, ishte një mekanizëm disproporcional, i cili e shndërronte votën parapëlqyese në të drejtë iluzore, duke cenuar thelbin e së drejtës për të zgjedhur (*shih vendimin nr. 28, datë 30.06.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst historik, ligjvënësi miratoi sërish ndryshimet në Kodin Zgjedhor, të cilat ishin objekt i këtij gjykimi kushtetues, ndaj, si rezultat i interpretimit historik, arrijmë në përfundimin se rregullat e reja ligjore nuk mund dhe nuk duhet ta shndërronin votën parapëlqyese në të drejtë iluzore, që cenon thelbin e së drejtës së votës.

9. Për sa i takon interpretimit sistematik, vihet re se neni 64 i Kushtetutës është pozicionuar në pjesën e tretë të saj, kreut I, që rregullon Kuvendin, duke treguar sistemin zgjedhor, përfshirë zgjedhjet dhe afatin e Kuvendit. Kjo do të thotë se qëllimi i dispozitës kushtetuese është të rregullojë mënyrën se si krijohet Kuvendi dhe si e merr ai legjitimitetin demokratik nga qytetarët. Paragrafi 3 i nenit 64 ka parashikuar se zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese dhe se ligji për zgjedhjet garanton që këtij votimi t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, si dhe të sigurohet përfaqësimi gjinor. Ndonëse delegimi për detajimin

e rregullave të zbatimit të sistemit zgjedhor i është dhënë ligjvënësit, pozicioni që rregulli i votës parapëlqyese ka në sistemin e normave kushtetuese tregon se ai mekanizëm përcakton formimin e Kuvendit dhe lidhet me rezultatin e zgjedhjeve, pra për deputetët e zgjedhur nga qytetarët. Një interpretim i ndryshëm nuk do të përmbushte qëllimin e kushtetutëbërësit, pasi nuk do të jepte efekt konkret në të drejtën e zgjedhësve për të ndikuar në përzgjedhjen e kandidatëve të preferuar prej tyre, duke e bërë atë formale dhe thjesht iluzive.

10. Ndërsa në lidhje me interpretimin teleologjik, duke iu referuar raportit për projektligjin e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2020 të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit, vërehet se kushtetutëbërësi ka ndryshuar nenin 64 të Kushtetutës për t'u dhënë mundësinë votuesve për të zgjedhur kandidatët e parapëlqyer nga lista e subjekteve zgjedhore, për të garantuar mekanizmat për rritjen e përgjegjësisë së kandidatëve ndaj votuesve të tij dhe për të ulur rolin e drejtuesve të partive politike për t'iu imponuar kandidatëve të zgjedhur dhe për të favorizuar kandidatët më të kualifikuar duke qenë se përzgjedhja e tyre do të bëhet drejtpërdrejt nga populli. Në këtë pikë, theksojmë se arsyetimi i shumicës se qëllimi i kushtetutëbërësit është garantimi i së drejtës/mundësisë së zgjedhësve për të shprehur, përmes votimit, preferencën e tyre për jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore, ndërsa mënyra e shpërndarjes së mandateve i është lënë në diskrecion ligjvënësit, pasi në thelb është partia ajo që konkurron dhe shtetasit votojnë kandidatët e caktuar nga partia politike (*shih paragrafin 72 të vendimit*), bie ndesh me qëllimin e deklaruar zyrtarisht në dokumentet parlamentare, ndaj ai nuk qëndron.

11. *Së dyti*, interpretimi i shumicës nuk ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e shprehur më parë nga Gjykata lidhur me kuptimin e nenit 64 të Kushtetutës për votimin parapëlqyes (*shih supra paragrafin 8*). Gjykata theksoi se neni 45 i Kushtetutës duhet të interpretohet së bashku me nenin 64 të saj, në të cilin jo vetëm është përcaktuar sistemi zgjedhor, por kushtetutëbërësi për herë të parë, me ndryshimet e vitit 2020, ka parashikuar votën parapëlqyese, duke e përcaktuar atë shprehimisht si e drejtë që gëzohet nga zgjedhësit dhe duke i dhënë kështu një kuptim të ri së drejtës së votës. Dhënia në mënyrë të shprehur e në nivel kushtetues e së drejtës së votës parapëlqyese për zgjedhësit nënkupton se ajo ka marrë një dimension të ri dhe mënyra se si ajo

respektohet nga ligjvënësi i nënshtrohet kontrollit kushtetues. E drejta e votës parapëlqyese e zgjedhësve, e parashikuar në nenin 64, pika 3, të Kushtetutës, nuk mund të interpretohet se vlen vetëm për të shprehur preferencat e tyre, por ndikon duke sjellë një kufizim në shpërndarjen e mandateve (*shih vendimin nr. 28, datë 30.06.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, jemi të mendimit se e drejta e votës parapëlqyese duhet të ketë ndikim në rezultatin e zgjedhjeve në atë masë që të respektojë pragun kushtetues prej dy të tretave të përbërjes së Kuvendit. Kjo do të thotë se ligjvënësi, brenda hapësirës normuese që i ka lejuar delegimi kushtetues, duhet të siguronte mekanizmat e duhur për të garantuar lidhjen kushtetuese midis votimit parapëlqyes dhe përbërjes së Kuvendit, pra rezultatit të zgjedhjeve.

12. Duke iu rikthyer rastit konkret, konstatojmë se ndonëse kemi të bëjmë me të njëjtat parashikime kushtetuese dhe parime themelore, rezultati në të cilin ka arritur shumica është diametralisht i kundërt, duke krijuar në këtë mënyrë iluzionin e ekzistencës së votës parapëlqyese dhe jo zbatimin e saj në praktikë. Në vlerësimin tonë, shumica ka ndryshuar pa asnjë arsye të qenësishme qëndrimin e saj të pranuar më parë, në të cilin ka arritur në përfundimin se votimi parapëlqyes i parashikuar në Kushtetutë ndikonte në shpërndarjen e mandateve, pra në rezultatin e votimit dhe jo në fazën e parë të përgatitjes së listave shumemërore ose të pjesëmarrjes së kandidatëve në listën që i nënshtrohet votimit parapëlqyes.

13. Shumica në vendimin e saj jo vetëm që nuk jep arsyet që justifikojnë ndryshimin e kësaj jurisprudence, por çka është më e rëndësishme, as nuk përmend vendimin e mëparshëm të Gjykatës, duke vënë në dyshim koherencën e jurisprudencës së saj dhe ndikimin që ajo ka në pritshmëritë e ligjshme të qytetarëve. Ky ndryshim i jurisprudencës kushtetuese nuk është në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, i cili imponon rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës dhe ndryshimi i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikonin një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar. Në këtë pikë, theksojmë se çdo ndryshim i precedentëve ose korrigjimi i doktrinës zyrtare kushtetuese mund të bëhet vetëm për arsye të rëndësishme, pasi duke vendosur në kundërshtim me një praktikë të konsoliduar dhe pa dhënë argumente në lidhje me këtë fakt,

Gjykata shmanget nga korniza e rregullave të një procesi të drejtë e të ndershëm (*shih vendimet nr.20, datë 01.06.2011; nr. 30, datë 17.06.2010; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. *Së treti*, nisur nga premisa e mësipërme, vlerësojmë se lidhëza "*dhe*" në paragrafin e parë të nenit 67 të Kodit Zgjedhor ka cenuar garancinë kushtetuese të nenit 64 të Kushtetutës. Nga interpretimi i paragrafit të parë të nenit 67 të kodit konstatohet se partitë politike kanë detyrimin për të depozituar listën shumemërore, e cila përbëhet nga pjesa e listës me kandidatë me renditje të fiksuar dhe ajo me kandidatët që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Ky detyrim, i lexuar në harmoni me nenin 163 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit marrin më parë mandat kandidatët e listës me renditje të fiksuar, nënkupton se pavarësisht numrit të votave që do të marrin kandidatët e listës që i nënshtrohen votimit parapëlqyes mundësia për të fituar një mandat do të jetë pothuajse e pamundur, veçanërisht në zonat e vogla zgjedhore të vendit. Sikurse kërkuesit parashtruan përpara Gjykatës, duke iu referuar rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, nga 12 qarqe, mandatet shpërndahen midis dy partive më të mëdha në vend, me përjashtim të 3 qarqeve në të cilat kanë fituar mandat edhe kandidatë të partive të treta (përkatësisht Tirana-dy parti, kanë fituar 3 mandate, Fieri-1 parti ka fituar 1 mandat dhe Shkodra-2 parti kanë fituar 3 mandate). Kështu, në total, nga 140 mandate, 39 do të fitohen nga kandidatët e listës që i nënshtrohen votimit parapëlqyes, ndërsa 99 mandate nga kandidatët e listës së fiksuar. Po kështu, rezulton se votimi parapëlqyes është i zbatueshëm vetëm për dy partitë më të mëdha, të cilat pasi plotësohet numri i mandateve për listën me renditje të fiksuar mund të shpërndajnë mandate edhe për listën e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Përkundrazi, për partitë e tjera më të vogla kjo mundësi nuk zbatohet në asnjë qark (të paktën nisur nga rezultatet e votimeve të mëparshme), për shkak se numri i mandateve që këto parti politike fitojnë është 1 ose 2, duke u përzgjedhur kandidati i listës me renditje të fiksuar dhe duke mos pasur mundësi që të vijohet me listën e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Ky shembull ilustron se mekanizmi ligjor i shpërndarjes së mandateve largon haptazi parashikimin kushtetues nga zbatimi në praktikë, duke e shndërruar votimin parapëlqyes në të drejtë iluzive.

15. Për sa më sipër, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se dispozitat aktuale nuk përmbushin parashikimet e nenit 64 të Kushtetutës për garantimin e votimit parapëlqyes për dy të

tretat e listës shumemërore, cenojnë të drejtën për të zgjedhur, si dhe parimet themelore të shtetit të së drejtës dhe demokracisë përfaqësuese. Në këtë mënyrë, një sistem ku votuesit mund të zgjedhin kandidatin e tyre të preferuar, por nuk kanë asnjë garanci se preferenca e tyre do të ndikojë në rezultatin final të zgjedhjeve, cenon vetë thelbin e së drejtës së votës. Parashikimi në nivel kushtetues i votimit parapëlqyes kishte qëllim dhënien shtetasve të së drejtës për të kontrolluar personat që i përfaqësojnë, në ndryshim nga sistemi i mëparshëm i listave të mbyllura dhe kandidatëve të paracaktuar.

16. *Së katërti*, edhe pretendimi tjetër se parashikimi i presjes dhjetore në nenin 67 të Kodit Zgjedhor cenon garantimin e parashikimit kushtetues të votimit parapëlqyes, është i bazuar. Pika 2 e nenit 67, ndër të tjera, ka parashikuar se numri i përgjithshëm i kandidatëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjesëtuar për tre. Kur nga ky pjesëtim nuk rezulton numër i plotë mandatesh, atëherë në rast se presja dhjetore, si pasojë e pjesëtimit, është e barabartë ose më e madhe se 0,5, lista përmbyllet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e pjesëtimit rezulton presja dhjetore më e vogël se 0,5, lista shumemërore me renditje të fiksuar e kandidatëve mbyllet me numrin e plotë pararendës. Ndonëse vlerësojmë se rrumbullakosja e numrit të mandateve pas presjes dhjetore përbën një formë praktike të përllogaritjes matematikore të numrit të votave, e cila kërkon detyrimisht një numër të plotë për dhënien e mandatit kandidatit fitues, konstatojmë se ligjvënësi ka parashikuar se kjo përllogaritje në disa raste shkon në favor të kandidatëve të listës me renditje të fiksuar. Për ilustrim, kërkuesit kanë paraqitur rastin e qarkut Shkodër, në të cilin një e treta e numrit 11 (numri i mandateve) është 3,66, ndërsa dy të tretat 7,33. Sipas parashikimit aktual të Kodit Zgjedhor, numri 3,6 (i cili i përket numrit të mandateve të listës me renditje të fiksuar - pra një e treta), do të rrumbullakoset me 4 mandate. Kurse numri 7,33 (që i përket listës së kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes- pra dy e treta), do të rrumbullakoset me 7 mandate, i cili është nën pragun kushtetues "jo më pak se dy e treta" (7 është më e vogël se 7,33).

17. Në vlerësimin tonë, dispozita ligjore nuk mund të shkojë në kundërshtim me atë çka ka parashikuar Kushtetuta, pasi, sikurse ka theksuar Gjykata në jurisprudencën e saj, përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet, duke u dhënë përparësi akteve

juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës dhe se atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji (*shih vendimet nr. 36 datë 04.11.2021; nr. 25, datë 05.12.2008; nr. 29 datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin kur dispozitat ligjore janë në tejkalim të normave kushtetuese, Gjykata ka vlerësuar se është prekur, veç të tjerash, edhe parimi i shtetit të së drejtës, i shprehur me përparësinë e normave të Kushtetutës në raport me normat e tjera ligjore (*shih vendimin nr. 25, datë 05.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në përfundim, mbështetur në argumentet e mësipërme, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se Gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën e kërkuesve dhe të vendoste shfuqizimin e lidhëzës "dhe" në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, parashikimin për rrumbullakosjen e presjes dhjetore në favor të kandidatëve të listës shumemërore me renditje të fiksuar, si dhe paragrafin e tretë të nenit 163 të këtij kodi, sipas arsyetimit të mësipërm.

**Anëtare:Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji**